



AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

## RAPORT I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Programi i Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në:**

**“Shkencat e Lëvizjes”**

**i**

**Institucionit të Arsimit të Lartë**

**“Universiteti i Sporteve të Tiranës”**

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Asoc. Irena SAÇO KOLA**

**Prof.Asoc. Gavrosh KAVAJA**

**Shkurt / 2020**

## PËRMBLEDHJE E VLERËSIMIT TË JASHTËM TË PROGRAMIT

Në kuadrin e akreditimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në “Shkencat e lëvizjes” kërkuar nga Institucioni i Arsimit të Lartë, “Universiteti i Sporteve të Tiranës”, është realizuar procesi respektiv i vlerësimit respektivisht sipas agjendës së miratuar nga dy institucionet. Në këtë raport janë pasqyruar gjetjet që kanë dalë si rezultat i analizës për procesin e vlerësimit të jashtëm. Unversiteti i Sporteve të Tiranës, është institucion i arsimit të lartë me traditë 60 vjecare, i njohur fillimisht me emrin Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi”. Me vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 123 datë 17.02.2010, Akademia e Edukimit Fizik dhe Sporteve “Vojo Kushi” emërtohet Universiteti i Sporteve të Tiranës (UST). Universiteti i Sporteve të Tiranës” ka kaluar procesin e vlerësimit institucional në kuadër të akreditimit, proces i zhvilluar nga ASCAL në bashkëpunim me Agjencinë Britanike të Sigurimit të Cilësisë QAA. Ky vlerësim u finalizua me Vendim të Bordit të Akreditimit Nr.64, date 21.09.2017, me kohëzgjatje 3 vite akadmeike, me afat vlefshmërie deri në 30.09.2020.

Aktualisht Universiteti i Sporteve të Tiranës përbëhet nga 3 (tre) fakultete:

### 1. Fakulteti i Shkencave te Lëvizjes me:

- Departamenti i Mjeksisë Sportive;
- Departamenti i Shkencave Sociale dhe Edukimit;
- Departamenti i Sportit;

### 2. Fakulteti i Veprimtarisë Fizike dhe Rekreacionit me:

- Departamenti i Lëvizjes dhe Shëndetit;
- Departamenti i Organizimit dhe Menaxhimit;
- Departamenti i Veprimtarisë Fizike, Rekreacionit dhe Turizmit;

### 3. Fakulteti i Shkencave të Rehabilitimit me:

- Departamenti i i Disiplinave Biomjekësore dhe Humane;
- Departamenti i Kineziologjisë;
- Departamenti i Rehabilitimit;

Sipas VKM Nr. 515, datë 30.06.2010, hapet programi i studimit i ciklit të parë në: “Shkenca të Lëvizjes” në bazë të riorganizimit të programit të studimit të ciklit të parë në “Edukim fizik dhe sporte”. Në përfundim të studimeve lëshohet Diplomë e Nivelit të Parë (DNP) në “Shkencat e Lëvizjes”, i cili realizohet me 180 kredite dhe kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Ky program studimi synon përgatitjen e specialistëve me njohuri të përgjithshme në fushën e aktivitetit fizik, duke u mbështetur në nevojat e tregut në vendin tonë dhe me gjerë, si dhe për të mundësuar një karrierë të mëtejshme akademike dhe profesionale. Programi i studimit realizohet me 180 kredite (ECTS), në gjuhën shqipe, me kohëzgjatje normale në tre vite akademike, e ndarë në 6 semestra. Formë studimi me kohë të plotë, në përfundim të të cilit lëshohet diplomë Bachelor “Në Shkencat e Lëvizjes”. Ky program studimi krahas formimit specifik profesional në fushën e aktivitetit fizik, ofron edhe formim të përgjithshëm kulturor të studentëve, duke formuar kështu krahas specialistit të aktivitetit fizik edhe qytetarin. Në këtë program studimi, studentët marrin një formim bazë në lidhje me



aspekte akademike e metodologjike, por edhe elemente të kulturës së përgjithshme sipas programit të aprovuar (përmes lëndëve si filozofi, sociologji, ekonomi, gjuhë e huaj, etj). Programi mësimor është ndërtuar në mënyrë të tillë që të japë jo vetëm njohuri teorike, por edhe aftësi praktike. Studentët pas përfundimit të ciklit të parë të studimeve Bachelor, kanë mundësi të vazhdojnë të profilizohen në studime të ciklit të dytë, dhe të zgjedhin midis programeve Master i Shkencave dhe Master Profesional në Mësuesi për 2 vite akademike të ofruar nga fakulteti, ose të mund të zgjedhin të ndjekin studimet në institucione të tjera, brenda dhe jashtë vendit që ofrojnë programe të ngjashme studimi. Gjithashtu ky program studimi u jep mundësi studentëve të punësohen jo vetëm në vendin tonë, por lehtësiht edhe jashtë vendit, për shkak se kjo diplomë është pothuajse e unifikuar me diplomat në disa vende Europiane.

## **PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**


Bordi i Akreditimit dhe Agjencia e Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë, pas kërkesës për akreditim të Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” të Universitetit të Sporteve të Tiranës, ngriti grupin e vlerësuesve të jashtëm të përbërë nga dy ekspertë: Prof Asoc. Irena Saço Kola, dhe Prof.Asoc Gavrosh Kavaja. Gjatë gjithë procedurës ekspertët e vlerësimit të jashtëm janë asistuar nga Kordinatorja Teknike e ASCAL, Znj. Majlinda Demireli. GVJ u njoh me Raportin e Vlerësimit të Brendshëm dhe anekset mbështetëse. GVJ shqyrtoi me vëmendje dhe përgjegjësi të gjithë dokumentacionin shoqëruar të RVB të dorëzuar paraprakisht në ASCAL. Grupi i punës së vlerësimit të brendshëm për hartimin e raportit ka vepruar duke iu referuar detyrimeve ligjore që dalin nga Ligji nr.80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë” dhe aktet nënligjore të dala në bazë të tij. Në punën për hartimin e këtij raporti GVB ka marrë përsipër të kryejë një vlerësim të brendshëm i kërkuar nga UST dhe ASCAL si pjesë e procesit të vlerësimit të jashtëm dhe e aplikimit për akreditimin e programit Bachelor në “ Shkencat e Lëvizjes”. Vlerësimi i jashtëm synon të analizojë cilësinë e programit të studimit, me qëllim që të sjellë përmirësime dhe të shërbejë si një burim për akreditimin. GVJ i shoqëruar nga Kordinatorja e ASCAL në datat 19 dhe 20 dhjetor 2019, zhvilluan vizitën në institucion. Paraprakisht kishim përpiluar planin e punës , për të bërë një sërë takimesh si me dekanin, drejtues departamenti, studentët, stafin pedagogjik, sekretarinë, NJSCB, GVB etj. Më pas bëmë një guid nëpër institucion për të parë nga afër labororet, palestrat, auditoret, zyrat etj.

Universiteti i Sporteve të Tiranës është njohur me Draft-Raportin e Vlerësimit të Jashtëm më datë 17.02.2020, përmes sistemit AMS, si dhe në formë zyrtare me anë të shkresës me Nr. 36/7 Prot, datë 17.02.2020. Universiteti i Sporteve të Tiranës përcjell pranë ASCAL më datë 20.02.2020, nëpërmjet shkresës me Nr.278/3 Prot, datë 19.02.2020, përgjigje në lidhje me Draft Raportin e Vlerësimit të Jashtëm, ku shpreh dakordësinë me përmbajtjen e këtij Draft Raporti. Në këtë mënyrë Draft Raporti merr formën e tij përfundimtare si Raport i Vlerësimit të Jashtëm.

## Vlerësimi i Programit të Studimit të Ciklit të Parë Bachelor në “ Shkencat e Lëvizjes”

### I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

<b>Standardi I.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij e që synojnë ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ofron programe studimi që nuk bien nënesh me interesat kombëtare.	<p>Mbështetur në shqyrtimin e dokumentave pjesë e DVV si <i>Statutit të UST, (Ref. Nr. 3) dhe Planit Strategjik të UST 2016-2020, fq. 4 (Ref. Nr. 4)</i>, GVJ konstaton se Institucioni ka përcaktuar si mision të tij, që të krijojë zhvillojë, e të mbrojë dijet përmes mësimdhënies kërkimit shkencor në fushën e edukimit fizik e sporteve.</p> <p>UST përmes ofrimit të programeve të një niveli të përparuar e bashkëkohor, synon të përgatisë profesionalisht specialistë të lartë në fusha që përmbushin nevojat e individëve dhe punëdhënësve duke i përgatitur të diplomuarit për karriera të shumëllojshme në tregun konkurrues të tregut të punës.</p> <p>Pra, vizioni i UST është ofrimi i programeve të studimit që promovojnë vlerat kombëtare.</p>
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare.	<p>GVJ bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion nga institucioni ,si “<i>Statuti i Universitetit te Sporteve</i>”. Neni 7,( <i>Ref.2</i>) konstatoi se ky program studimi synon të përmbushë misionin e UST-së, dhe ka për qëllim të ofrojë programe studimi të standardeve akademike më të larta bashkëkohore kombëtare dhe ndërkombëtare, si dhe të përkrahë aspiratat arsimore dhe arrijtjet në fushën e shkencave të Lëvizjes.</p>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.	<p>GVJ bazuar në DVV si dhe takimin me stafin akademik konstaton se ky program studimi plotëson misionin dhe qëllimet e institucionit. Programi bachelor “Në <i>Shkencat e Lëvizjes</i>”, i aprovuar nga MAS synon përgatitjen e specialistëve të sportit, të cilët duhet t’u përgjigjen nivelit të zhvillimit shoqëror sportiv, të marrë në kontekst kombëtar dhe ndërkombëtar. UST ka ofruar programe në përputhje me kërkesat e MAS, legjislacionin shqiptar si dhe <i>Planin strategjik UST. Misioni, Pika 2. (Ref.3)</i>, duke siguruar një diplomë më atraktive për tregun e punës. Programi është përgatitur në përputhje me nevojat e kohës dhe është e integruar në strukturat evropiane duke i dhënë rëndësinë që i takon edukimit sportiv.</p>



	Programi i referohet në mënyrë të drejtpërdrejtë “zhvillimit” tonë shoqëror e sportiv për të pasur një shoqëri të së ardhmes vitale e të shëndetshme. Vëzhgimi i statutit, dokumentit strategjik të institucionit dhe rregullores së programit të studimit “Bachelor në Shkencat e Lëvizjes”, tregojnë përputhje me misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë.			
<b>Kriteri 4.</b> Programet e studimeve hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe për të nxitur zhvillimin ekonomik lokal dhe/ose kombëtar.	GVJ gjatë vizitës në institucion dhe shqyrtimit të DVV, konstatoi se programi i studimit është hartuar në përputhje me nevojën e tregut për specialist të “Shkencave të Lëvizjes” U vu re se institucioni bën në mënyrë të vazdushme investigime të tregut të punës dhe nga takimet me studentët që kanë përfunduar studimet me anë të zyrës së karrierës ALUMNI, vërehet se programi mbetet ndër më të kërkuarit në vend si në sektorin shtetëror dhe atë privat.  Nisur nga qëllimi, objektivat formuese dhe tërësia e komponentëve të tjerë të programit të studimit, të cilat janë të shprehura qartë dhe në <i>Planin strategjik UST. Misioni, Pika 3.1, (Ref.3)</i> , rezulton se ky program është hartuar në përputhje me nevojat e tregut të punës jo vetëm fusha mësues i edukimit fizik, por dhe për trainerë. Rritja e nevojave në vend për mësues të kualifikuar në fushën e edukimit fizik dhe sporteve dhe rritja e kërkesës së studentëve të studimeve bachelor në edukim fizik dhe sporte pranë UST ka ardhur në rritje, e cila shprehet qartë dhe në rritjen e numrit të orëve mësimore të edukimit fizik dhe shëndetit në arsimin 9 vjeçar dhe të mesëm me 3 orë në javë të detyrueshme, do të thotë se është rritur me 50% numri i nevojshëm për mësues të edukimit fizik në sistemin arsimor parauniversitar. Kjo reformë ka qenë një shtysë e veçantë për përmirësimin e programit.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përbushet</b>	<b>Përbushet pjesërisht</b>	<b>Përbushet kryesisht</b>	<b>Përbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi I.2</b>	
<b>Programet e studimit janë në përputhje me strategjinë e zhvillimit, statutin dhe aktet e tjera rregullatore të institucionit të arsimit të lartë dhe fushat akademike të tij.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni përcakton qartë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të	Priremi të konfirmojmë se: Institucioni është qartësisht i fokusuar në përgatitjen dhe formimin e mësuesit me profil në edukim fizik. Mbështetur në shqyrtimin e dokumentacionit të

<p>strategjisë për zhvillim të vetë institucionit.</p>	<p>vënë në dispozicion, <i>Planin strategjik UST. Pika f, (Ref 3 ), Planin strategjik FSHL pika 2 paragrafi 2/3(Ref 44 ),</i> rezulton se objektivat e zhvillimit të institucionit përshtaten me objektivat e vetë programit. Objektivat Strategjike të FSHL – së janë të pajisë studentët me dije në përshtatje me aktualitetin dhe kërkesat në rritje për këto shërbime. Programi në fjalë e ushqen mjaftueshmërisht titullin e Diplomës</p>			
<p><b>Kriteri 2.</b> Statuti dhe rregullorja e institucionit përcaktojnë qartë drejtimit prioritar akademike të tij dhe demonstrojnë se programet e studimit hartohen dhe ofrohen në përputhje dhe në zbatim të këtyre të fundit.</p>	<p>Nga konsultimi me DVV si dhe takimet me drejtues të institucionit, stafin akademik, GVJ konstaton se statuti i institucionit përcakton në mënyrë të qartë njësitë kryesore në strukturën përbërëse të institucionit, dhe drejtimit prioritar të diplomave që ofron, ku ndër to renditet përgatitja e specialistëve për aktivitetin fizik, por edhe për fusha të reja specifike në përgjigje të kërkesave e interesave kombëtare. Mbështetur në <i>Statutin e Universitetit te Sporteve. Neni 7,( Ref 2), UST</i> synon që, përmes programeve lëndore teorike dhe praktike të harmonizuara me njëra – tjetrën, të përgatisin profesionalisht specialistë të lartë në fushat e edukimit fizik, në përputhje me kërkesat e nevojat e shoqërisë në ndryshim e zhvillim.</p>			
<p><b>Kriteri 3.</b> Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit ofrohen në përputhje me fushat e drejtimit akademike të institucionit.</p>	<p>GVJ nga konsultimi me DVV si dhe inspektimi në institucion konstatoi se emërtimi, organizimi, si edhe përmbajtja e programit të studimit të ciklit të parë Bsc në “Shkencat e Lëvizjes”, është në përputhje me fushën akademike në të cilën vepron Departamenti i Sporteve. Programi Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” synon krijimin e bazave të mira për përgatitjen dhe formimin e mësuesve me një kuptim të qartë për institucionin shkollor, për vendin dhe shoqërinë e sotme. Ky objektivi gjendet në përputhje me qëllimin e vetë institucionit të shprehur në dokumentat kryesore të politikës dhe drejtimit të tij. Emërtimi, organizimi, struktura dhe përmbajtja e programit rregullohen bazuar në <i>Rregulloren UST neni 36 pika 5.( Ref 5 ).</i> Struktura dhe përmbajtja e programit janë organizuar në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi ku specifikohet edhe ndarja e komponentëve mësimorë sipas kategorive A-E.</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Përbushet plotësisht</p>	<p>Përbushet pjesërisht</p>	<p>Përbushet kryesisht</p>	<p>Përbushet plotësisht</p>
				X

### Standardi I.3

**Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës dhe ofrohen në**

**përputhje me kërkesat e tij.**

**Kriteret**

**Vlerësimi i ekspertëve**

**Kriteri 1.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në këto programe, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit.

Nga shqyrtimi i DVV GVJ, konstatoi se programi i studimit është organizuar në mënyrë të tillë që studenti në përfundim të studimeve të ciklit të parë pajiset me njohuri bazë të formimit të përgjithshëm dhe profesional.

Referuar (*Ref 14 Modeli i Supplementit të Diplomës, Bsc Shkencat e Lëvizjes*), janë të përcaktuara qartë objektivat në drejtim të formimit dhe punësimit pas marrjes së diplomës konkretisht:

- *Objektivat formuese të programit, synojnë:*

Formimin e studentëve me njohuri bazë, aftësim dhe kompetencë profesionale mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aplikimet e drejtpërdrejta të njohurive të marra në fushën e edukimit fizik dhe sporteve;

- *Objektivat e punësimit:*

Mbajtësi i kësaj diplome ka të drejtë për tu punësuar si specialist në fushën e sportit dhe edukimit fizik.

Ka të drejtë për tu punësuar në cdo vend pune në administratë që kërkon një nivel arsimor bachelor të pa specifikuar.

**Kriteri 2.** Institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar dhe zhvillimet e pritshme në sektorin përkatës.

GVJ në takimin me punonjësit e Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni u informua se institucioni kryen studime mbi tregun lokal e ndërkombëtar të punës për programet e studimit që ofron, përpara hapjes së tij, pas daljes së studentëve dhe në mënyrë periodike. Gjithashtu GVJ nga inspektimi i dokumentit referues (*Ref. 45 Studimi i tregut të punës faqe 41*), si dhe informacioni i marrë në institucion konstatoi se është kryer studimi mbi tregun e punës nga anëtarët e projektit "TEAVET" pranë FSHL-së. Po kështu sektori ALUMNI brenda Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni, ka si detyrë të mbajë kontakte me studentët e diplomuar por edhe me punëdhënësit e fushës me të cilët ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi, duke bërë të mundur një urë komunikimi mes palëve të interesuara, referuar dhe projektit: *NEEDS ANALYSIS ON LLL FOR TEACHERS UST TEAVET project(Ref. 46)*

Këto studime duhet të përfshijnë: të dhëna nga komunikimi

	<p>zyrtar me punëdhënësit e fushës, kërkesat dhe nevojat e tyre, mundësitë e punësimit të studentëve, të dhëna mbi punësimin real të studentëve të diplomuar .Pavarësisht se këto studime nuk janë të plota pasi studentët pasi mbarojnë pothuajse shkëpusin marrëdhëniet me Fakultetin.</p> <p><i>GVJ sygjeron bërjen më funksionale të platformës <a href="http://alumni.ust.edu.al/">http://alumni.ust.edu.al/</a> , që do të mundësonte një pasqyrë të mirëfilltë të nevojave të tregut të punës, si dhe gjurmimin e studentëve pas diplomimit.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Objektivat formues, struktura dhe përmbajtja e programeve të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësit, garantojnë përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave që u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve.</p>	<p>GVJ referuar DVV si dhe takimeve të bëra në institucion me dekanin, drejtuesin e departamentit, stafin pedagogjik si dhe me studentët konstatoi se programi i studimit ka të qartë objektivat formuese, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënësit, për të garantuar përfundimin e dijeve, aftësive, shkathtësive e kompetencave të cilat u përgjigjen nevojave të tregut të punës dhe lehtësojnë punësimin e studentëve. Dekanati, si edhe departamenti përgjegjës për programin merr masa që të përditësojë strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit, duke u siguruar që diploma e ofruar të jetë sa më afër nevojave të tregut dhe përshtatur dhe legjislativacionit në fuqi. Kurrikula e programit të studimit u lejon të diplomuarve të thellojnë aftësimin e tyre profesional nëpërmjet diplomave të nivelit të dytë të ofruar nga vetë fakulteti duke ndjekur ciklin e dytë të studimeve të ofruar nga ky Fakultet, Master Shkencor dhe Master profesional, Mësuesi 2 vjeçar, çka përkthehet në mundësi të zgjeruara punësimi e karriere profesionale.</p> <p>Veprimtaritë formuese përcaktohen qartë në tabelën e Shtojces nr 1 të rregullores së UST-së.</p> <p>Objektivat formues dhe kompetencat profesionale.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Objektivat formuese dhe kompetencat profesionale përcaktojnë formimin, njohuritë, aftësitë dhe kompetencat që përfiton studenti deri në përfundim të programit të studimit;</li> <li>- Objektivat formues dhe kompetencat profesionale: I atribuohen komponentëve të veçantë mësimorë, përcaktohen në Kornizën Shqiptare të Kualifikimeve gjatë përshkrimit të kualifikimeve individuale, vlerësohen nëpërmjet procedurave të bazuara në kritere të qarta e transparente;</li> <li>- Objektivat formues dhe kompetencat profesionale ndahen në: përcaktuese, të cilat janë të njëjta për</li> </ul>



	programet e studimit me të njëjtin emërtim, të ofruar nga institucione të ndryshme të arsimit të lartë, specifike, të cilat diferencojnë programet e studimit me të njëjtin emërtim, të ofruara nga IAL të ndryshme. Këto objektiva e kompetenca përcaktohen veçmas nga secili institucion ofruer i programit të studimi. (Pika 2.3 e Rregullores së UST neni 36, pika 5)		
Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
			X

#### Standardi I.4

**Programet e studimit janë në përputhje me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit në institucion.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni demonstroi se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në një fushë të caktuar.</p>	<p>Referuar shqyrtimit të dokumentacionit, GVJ konstatoi se institucioni në tërësi ka përvojën për ofrimin e këtij program studimi, pasi ky program studimi është hartuar dhe ofrohet në përputhje me strategjinë e zhvillimit të UST-së. Programi ofrohet nga Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes për vitin akademik <b>2019-2020</b> ka gjithsej <b>47 pedagogë</b>, nga të cilët <b>41 janë pedagogë efektiv (PAE)</b>, nga ku 7 kanë titullin “Profesorë”, 7 kanë titullin “Profesorë të Asociuar”, 20 kanë gradën Dr., dhe 7 Asistent Lektorë me Msc.</p> <p>Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes ka në përbërjen e tij tre departamente:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Dep i Sportit ka në përbërjen e tij <b>20 PAE</b> nga ku 16 me tituj/grada;</li> <li>- Dep i Shkencave Sociale dhe Edukimit ka në përbërjen e tij <b>13 PAE</b> nga ku 11 me tituj/grada;</li> <li>- Dep i Mjeksisë Sportive ka në përbërjen e tij <b>8 PAE</b> nga ku 7 me tituj/grada;</li> </ul> <p>Stafi akademik efektiv zotëron përvojën e duhur në mësimdhënie për t’u angazhuar në këtë program studimi. Raport i MASR mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të deklaruara nga UST, vërteton se ky institucion ka kapacitete infrastrukurore të mjaftueshme të cilat janë një faktor i rëndësishëm në mbarëvajtjen e këtij program studimi.</p> <p><i>(Model Raport nga MASR mbi verifikimin e kapaciteteve pritëse për pranimet në programet e studimit, sipas kuotave të</i></p>

	<i>deklaruar nga UST)</i> <i>(Apendix Tabela 1, 2; Ref.48)</i>			
<b>Kriteri 2.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.	Referuar shqyrtimit të dokumentacionit GVJ, konstatoi se fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” është tërësisht në përputhje me fushën akademike e kërkimore të Njësisë Kryesore (FSHL). Në këtë program japin mesim akademike me eksperience në fushën perkatese të cilët janë me tituj dhe grada shkencore, po ashtu ky program është në përputhje me fushën akademike e kërkimore përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.  <i>(Apendix Tabela 12.1, 12.2, 12.3; Ref.48)</i>			
<b>Kriteri 3.</b> Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë bazë, përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. Në rastet e programeve ndërdisiplinore, të paktën një nga njësitë bashkëpunuese duhet ta sigurojë këtë përputhje.	Programi Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” ofrohet nga Departamenti i Sportit. Konstatohet një përputhje e plotë midis fushës së përgjithshme dhe specifike në fushën akademike e kërkimore të departamentit që e ofron programin. Fakulteti organizon dhe drejton më së miri punën për hartimin e planit mësimor e rrjedhimisht të programeve mësimore, ku konkretisht fushat e përgjithshme dhe ato specifike të programit mbulohen nga Departamentet të cilat bashkëpunojnë ngushtë me njëra tjetrën dhe sigurojnë përputhshmërinë ndërdisiplinore.  <i>(Apendix Tabela 3 numri i programeve që ofron fakulteti; Ref.48)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

### Standardi I.5

**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në përputhje me fushën dhe specifikën e këtyre të fundit.**


#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë e personelit, marrjes së

GVJ konstatoi nga konsultimi me DVV si dhe vizita në institucion se, institucioni është organizuar në njësi kryesore dhe njësi bazë konform legjislacionit në fuqi. Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive midis njësisë të ndryshme është e rregulluar po kështu me anë të dokumenteve ligjore perkatese në rang universiteti dhe në rang fakulteti, si Statuti i UST-së, Rregullorja e UST-së ku


<p>përgjegjësi respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre.</p>	<p>përcaktohen qartë funksionet e organeve përbërëse të institucionit. (<i>Statuti UST Ref. 2</i>) Departamenti i sportit përgjegjës për programin zhvillon veprimtarinë më të madhe për mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit. Kjo veprimtari kryhet duke respektuar dispozitat e parashikuara në Rregulloren e UST-së për drejtuesin e njësisë bazë dhe përgjegjësin e grupit mësimor-kërkimor brenda kësaj njësie sipas inspektimit edhe të (<i>Rregullores së USTRef. 5</i>).</p> <p>Mbështetur në (<i>Rregulloren e Administratës UST Ref. 89</i>) FSHL- ja bën hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie bashkëpunimi brenda institucionit, si Rektoratin, Degën e Informacionit etj, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësisë përgjegjëse/departamenteve e personelit akademik dhe ndihmës akademik, ku cdo njëri prej këtyre ka përgjegjësi për procesin mësimor. Këto janë të përcaktuara qartë në statut dhe rregulloret përkatëse. Gjithashtu dhe menaxhimi i njësisë mbështetëse janë të paraqitura qartazai dhe në rregulloren e Administratës UST.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ ose të huaj.</p>	<p>Referuar RVB, si dhe takimit me Dekanin e FSHL, UST ka një rrjet bashkëpunëtorësh në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, lokal, biznese, ambasada dhe përfaqësi të huaja, universitete publike dhe private, federata e organizma sportive. Konstatohet bashkëpunim në nivel institucionale institucione e organizma kombëtare në funksion të realizimit të praktikave profesionale. Gjithashtu janë lidhur marrëveshje bashkëpunimi me universitete partnere brenda dhe jashtë vendit, si partnerë strategjikë për ofrimin e programit.</p> <p>Disa nga institucionet që ka marrëveshje:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>Universiteti i Mjekësisë së Tiranës;</li> <li>Universiteti “Aleksandër Xhuvani” Elbasan;</li> <li>Universiteti European i Tiranës;</li> <li>Kolegji Universitar “Pavarësia”-Vlorë;</li> <li>Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”;</li> <li>Universiteti Shtetëror i Tetovës;</li> <li>Universiteti i Malit të Zi;</li> <li>Universiteti i Romës ‘Foro Italico’;</li> <li>Universiteti i Vienës;</li> <li>Universiteti i Lubjanës;</li> <li>Universiteti i Aradit “Aurel Vlaci”;</li> </ul>



	<p>Akademia Kombëtare Sportive “Vassil Levski”, Bullgari;  Universiteti i Trakyas, Turqi;  Universiteti “Mehmet Akif Ersoy”, Turqi;  Universiteti i Edukimit Fizik Budapest, Hungari;  Institucione dhe organizma të tjerë kombëtar me të cilat UST ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi janë:  Kuvendi i Republikës së Shqipërisë;  Komiteti Olimpik Kombëtar Shqiptar;  Drejtoria Arsimore e Qytetit të Tiranës – sot Zyra Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës (FSHL);  Instituti i Shëndetit Publik;  Bashkia e Tiranës, Agjensia e Parqeve dhe Rekreacionit;  Këshilli i Qarkut Tiranë;  Poliklinika Mjekësore Gjermane;  Federata Shqiptare e Basketbollit;  Federata Shqiptare e Rafting;  Shoqata e Rehabilitimit Fizik për Personat me Aftësi të Kufizuara; (FVFR)  Klubi i Futbollit “TIRANA”.  Ballkanike (BUA) etj  <i>(referencë mbi Marrëveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe Ref.13).</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimeve.</p>	<p>Referuar RVB rezulton se UST harton raportin vjetor të analizës së punës, ku pjesë e këtij raporti është edhe analiza vjetore mbi përfitimet nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimit. Edhe Njësia Baze harton raport mbi ecurinë e praktikës pedagogjike me studentet e ciklit të parë në kuadër të marrëveshjes me Zyrën Arsimore Vendore e qytetit të Tiranës. Prej marrëveshjeve të ndërsjellta të bashkëpunimit institucioni përfiton në disa drejtime madhore që i shërbejnë programit të studimit në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë konstatim që GVJ e vuri re edhe nga konsultimi me <i>(Model Marrëveshje Bashkëpunimi me Zyrën Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës për Praktikat Profesionale Ref. 49)</i></p> <p>Institucioni mban regjistrime të sakta të shkëmbimeve të stafit akademik dhe të studentëve dhe i përditëson ato në mënyrë periodike. Fakulteti merr feedback verbal për përfitimet nga marrëveshjet e bashkëpunimit në formën e intervistave me studentët kur dalin para komisionit</p>

	vlerësues të praktikës profesionale.			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni vendos marrëdhënie zyrtare e bashkëpunon me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të natyrës specifike të programeve të studimeve që ofrojnë.	GVJ konstatoi se institucioni disponon dokumentacionet e bashkëpunimit mes fakultetit të shkencave të lëvizjes mes agjencive e institucioneve publike e cila rregullohet përmes marrëveshjeve të bashkëpunimit të lidhura mes palëve. Në paketën që institucioni ka paraqitur, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me: Drejtorinë Arsimore të Qytetit të Tiranës – sot Zyra Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës për kryerjen e praktikës profesionale. Gjithashtu për realizimin e praktikave dimërore dhe verore për autdoret që realizohen në programin mësimor, vendosen marrëdhënie kontraktuale me bizneset përkatëse në përputhje me Ligjin e Prokurimeve. <i>(Praktikat, ski, not me studentet Ref.50)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni ofron trajnime profesionale të mëtejshme për studentët e diplomuar në bashkërendim me punëdhënësit.	GVJ në takimin me drejtuesit e institucionit si dhe në konsulencë me DVV, konstatoi se institucioni nuk ofron trajnime për studentet e diplomuar, sepse nuk kanë hapërirë ligjore për ofrimin e trajnimeve profesionale, por bazuar në <i>(Marreveshjet e bashkëpunimit me institucione homologe Ref.13)</i> , FSHL ofron mundësi trajnimi për studentët referuar bashkëpunimit me federatat sportive.			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>


<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>



## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMIT TË CIKLIT TË PARË BACHELOR

<b>Standardi II.1</b>	
<b>Programet e studimeve organizohen në përputhje me parashikimet ligjore e përcaktimet nënligjore kombëtare në fuqi për këto programe studimi.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module dhe të vlerësuara në kredite, në përputhje me legjislacionin vendës në fuqi dhe sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS).</p>	<p>Programi i studimit është organizuar në përputhje me legjislacionin në fuqi, në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas Sistemit Evropian të Krediteve. Programi ofrohet në 3 vite akademike, 6 semestra, 180 kredite. Programi i studimit është organizuar në përmbajtje të tij nga:</p> <p>Lëndë të formimit bazë (<b>36 kredite</b>);</p> <p>Lëndë të formimit karakterizues (<b>95 kredite</b>);</p> <p>Lëndë të formimit ndërdisiplinor dhe integruese (<b>25 kredite</b>); Lëndë plotësuese (<b>18 kredite</b>);</p> <p>Detyrime Përmbysëse (<b>6 kredite</b>);</p> <p>GVJ konstatoi se këto raporte janë në përputhje me legjislacionin, udhëzimet e MAS, si dhe me vendimet e senatit të UST</p> <p><i>(Vendim Senati Nr.20, datë 16.05.2018 bashkëngjitur Plani Mësimor i Programit të Studimit Apendix Tabela 9 (Ref.35 )</i></p> <p><i>(Rregullore UST, Neni 33 (Ref.5 ).</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.</p>	<p>Gjatë shqyrtimit të DVV, GVJ konstatoi, se Diploma e këtij programi u ofron studentëve, krahas njohurive bazë me karakter të formimit të përgjithshëm, edhe njohuri specifike në fushën e shkencave të aktivitetit fizik, në fushën biomjeksore, në shkencat humane dhe në shkencat e lëvizjes e sportit. Për rrjedhojë edhe sfera profesionale që ofron kjo diplomë është po kaq e gjerë dhe e larmishme. Synimi i këtij programi është ti sigurojë studentëve përvojë teorike dhe praktike pune në mësimdhënie e cila shprehet edhe në <i>(Suplementi i diplomës, pika, 4.2)</i>. Në ciklin e parë të studimeve pranohen kandidatët të cilët kanë mbaruar me sukses Maturën Shtetërore, sipas Udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara nga MASR, si dhe duke kalur testin e vlerësimit motorik të organizuar nga fakultetet e UST. Testet motorike pasi miratohen nga Këshillat e Fakulteteve i percillen për miratim Senatit Akademik. Është ky i fundit që miraton përfundimisht testet e pranimit të studenteve në çdo program studimi të orfuar nga fakultetet e UST-së si dhe peshën specifike të shprehur në % (përqindje)</p>

	<p>për to e shprehur qartë dhe në (<i>Rregulloren e UST, Neni 36 pika 6 Ref.5</i>). Po kështu edhe rishikimi i vazhdueshëm i kurrikulave mësimore sipas legjislacionit në fuqi, përshtatja e saj me kërkesat e tregut të punës në mënyrë që ti drejtoj studentët në fund të studimeve, drejt tregut të punës. Si konkluzion GVJ konstaton se aftësite profesionale dhe sfera profesionale që ofron kjo diplomë është e gjerë dhe e larmishme.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit të ciklit të parë japin njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës.</p>	<p>GVJ referuar DVV, vizitës në institucion konstaton se programi i studimit jep njohuri të përparuara në fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, pasi ky program studimi është i organizuar në disiplina të detyrueshme dhe disiplina me zgjedhje sipas planit mësimor të aprovuar më parë. Disiplinat e detyrueshme që kanë peshën më të madhe specifike të programit parashikojnë veprimtari shkencore të fushës së diplomimit. Disiplinat me zgjedhje përfshijnë veprimtari shkencore të synuara për një specializim më të ngushtë. Detyrimi përmbysës kur realizohet në trajtën e një punimi diplome i jep mundësi studentit të reflektojë në praktikë shkallën e përvetësimit të parimeve shkencore në fushën e diplomimit. Programi siguron përvojë praktike pune në mësimdhënie dhe fushën e sportit. Përmes kurrikulës së ofruar studentët do të pasurojnë aftësitë dhe njohuritë e fituara gjatë studimeve të ciklit të parë duke zhvilluar aftësi të reja metodologjike dhe didaktike në procesin mësimor. Sipas (<i>Rregullores së Universitetit të Sporteve, neni 37 dhe Planit mesimor Ref.35</i>). synimi i këtij programi është ti sigurojë studentëve përvojë teorike dhe praktike pune në mësimdhënie. Në këtë mënyrë studentët do të pasurojnë aftësi të reja në fushën e Edukimit fizik dhe Sportit e cila shprehet qartë edhe në (<i>Suplementin e diplomes, pika, 4.3 dhe 5.2</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit të ciklit të parë zhvillojnë njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse dhe të paparashikueshme në një fushë të specializuar studimi ose profesionale.</p>	<p>GVJ referuar DVV, vizitës në institucion konstatoi, se programi i studimit zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të avancuara në fusha akademike ose profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e problemeve komplekse në një fushë të specializuar studimi ose profesionale. Ky program i pajis studentët me njohuri të thelluara teorike me aftësi praktike, me aftësi për mësimdhënien për orën e edukimit fizik. Kjo shfaqet në përbërësit, komponentët e planit mësimor dhe në përmbajtjen e programeve të lëndëve mësimore, e shprehur edhe në syllabuset e cdo lënde, referuar (<i>Planit mësimor Ref.35</i>).</p>



<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit të ciklit të parë përmbajnë të gjitha elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit të përcaktuara në akte ligjore e nënligjore.</p>	<p>GVJ konstaton se ky program studimi është hartuar në përputhje të plotë me kërkesat e ligjit nr.80/2015 (neni73). Programi ofrohet me 180 ECTS, me kohëzgjatje normale 3 vite akademike të ndarë në 6 semestra me nga 30 kredite cdo semestër. Detyrimi përmbyllës për marrjen e diplomës shlyhet ose me teme diplome ose me provim përfundimtar. Referuar (<i>Planit Mësimor i Programit të Studimit Bachelor. Apendix Tabela 10 Ref. 35</i>), programi është i strukturuar në: Lëndët bazë (A) 15–20% (kredite), Lëndë karakterizuese (B) 50–55% (kredite ), Lëndë Ndërdisciplinore Integruese dhe lëndë me zgjedhje (C) 12–15% (kredite), Lëndë plotësuese (D) 10– 15% (kredite ), Detyrime përmbyllese (E ) 3–5 % (kredite). Referuar RVB, programi i studimit përbëhet nga këto elementë kryesorë të kontrollit të dijeve,(seminaret, ushtrimet (mesimet praktike), punët laboratorike, detyrat e kursit, essetë, praktikat mësimore, objektivat formues, veprimtaritë formuese, planin mësimor programet lëndore, diplomën dhe suplementin. Programi i studimit Bachelor përmban 750 orë leksion, 336 orë seminare, 772 orë ushtrime, 89 orë laboratore dhe 50 orë praktikë mësimore. Po kështu në ciklin e parë të studimeve pranohen kandidatët të cilët kanë mbaruar me sukses Maturën Shtetërore, sipas Udhëzimeve dhe procedurave të përcaktuara nga MASR, si dhe në (<i>Rregulloren UST, Neni 36,pika 6, neni 39 Ref. 5.</i>) e cila përcakton edhe testin e velresimit motorik të organizuar nga fakultetet e UST. Testet motorike pasi miratohen nga Këshillat e Fakulteteve i përcillem për miratim Senatit Akademik. Është ky fundit që miraton përfundimisht testet e pranimit te studenteve në çdo program studimi të orfuar nga fakultetet e UST-së si dhe peshën specifike të shprehur në % (përqindje) për to.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit kanë të përcaktuar qartë veprimtaritë formuese duke grupuar lëndët/ modulet sipas kategoritë të përcaktuara dhe me ngarkesën përkatëse në kredite.</p>	<p>GVJ nga inspektimi i programit mësimor konstatoi se, programi i studimit është i organizuar në lëndë të grupuara në 5 kategori të emërtuara A, B, C, D, E.</p> <p>Veprimtaritë formuese bazë (36 kredite);</p> <p>Lëndë të formimit karakterizues (95 kredite);</p> <p>Lëndë të formimit ndërdisiplinor dhe integruese (25 kredite);</p> <p>Lëndë plotësuese (18 kredite);</p> <p>Detyrime Përmbyllëse (6 kredite);</p> <p>180 ECTS gjithsej</p> <p>Ngarkesa normale është 60 kredite në vit, e ndarë në 30 ECTS për semestër. Studentët që përfundojnë studimet në</p>



	<p>këtë program studimi diplomohen me të paktën 180 ECTS. Kreditet e çdo disipline mësimore dhe veprimtarie formuese përlloga-riten duke mbajtur parasysh ngarkesën në orë mësimore në auditor, si dhe punën individuale që duhet kryer nga studenti për përmbushjen e të gjitha detyrimeve të parashikuara në programin e lëndës. Një kredit është 25 orë mësimore sipas ligjit të Arsimit të Lartë dhe VKM Nr.41 e cila përfshin orët mësimore në auditor 12 orë (leksione, seminare, ushtrime, projekt/detyra, dhe veprimtari të tjera formuese brenda disiplinës), si dhe 13 ore punë individuale të studentit. GVJ konstatoi se shpërndarja e krediteve në lëndë të ndryshme nga A deri E është e drejtë dhe harmonike sipas specifikave të secilës lëndë bazuar në <i>(Planin Mësimor të Programit të Studimit) Apendix Tabela 9 Ref.35) si dhe (VKM 41, date 204.01.2018 Ref.47).</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## Standardi II.2

**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore për këto njësi.**

<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin.	GVJ bazuar në RVB, takimet në institucion si dhe në referencat ( <i>Shkresë Dekanati nr. 267 prot., datë 16.02.2017 "Mbi caktimin e Departamentit përgjegjës për programin e studimit" Ref. 88</i> ), konstatoi se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore për vlerësimin dhe akreditimin. Departamenti i Sportit, përgjegjës për ofrimin e programit të studimit e zhvillon të gjithë aktivitetin në përputhje me legjislacionin në fuqi në përmbushje të gjithë standardeve të cilësisë për mësimdhënie dhe procesin e kërkimit shkencor. Ai bashkëpunon ngushtë me strukturat në nivel fakulteti të cilat hartojnë politika për vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë.
<b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e	GVJ nga takimi me drejtues të institucionit si dhe konsultimi me dokumentin, ( <i>Vendim Dekanati Nr. 55, dt. 09. 10. 2019 "Mbi caktimin e koordinatorëve të programeve të studimit" Ref. 14</i> ) konstatoi se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit. Koordinatori i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.


<p>programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. Koordinator i programit informon vazhdimisht titullarin e njësisë përkatëse.</p>	<p>Rregullorja e Universitetit e ngarkon drejtuesin e njësisë bazë/departamentit me funksionet e hartimit të programeve mësimore dhe të mbikëqyrjes së ecurisë së programit të studimit. Koordinator i programit ngre grupe pune për shqyrtimin e cilësisë së sillabuseve, miraton temat e diplomave dhe tezat e provimeve. Gjithashtu koordinatori i programit ndjek ecurinë e zhvillimit të praktikave profesionale.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB si dhe dokumentin <i>(Të dhëna Tabelore për personelin akademik në programin e studimit/ Kualifikimi dhe Raportet)</i>, konstatoi se njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush, detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike, bazuar kjo dhe në <i>(Vendim Senati Nr. 2, dt. 10.01.2019) Apendix Tabela 1 Ref. 65</i>).</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit akademik.</p>	<p>FSHL – ja përbëhet nga tre Njësi Bazë, për vitin <b>2019 -2020</b> respektivisht:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Dep i Sportit, i cili ka në përbërjen e tij <b>20 PAE</b> nga ku <b>16 me tituj/grada;</b></li> <li>2. Dep i Shkencave Sociale dhe Edukimit, i cili ka në përbërjen e tij <b>13 PAE</b> nga ku <b>11 me tituj/grada;</b></li> <li>3. Dep i Mjeksisë Sportive, i cili ka në përbërjen e tij <b>8 PAE</b> nga ku <b>7 me tituj/grada;</b></li> </ol>
<p><b>Kriteri 5.</b> Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, përmbush detyrimet ligjore dhe nënligjore për organizimin dhe strukturën akademike.</p>	<p>Ndërsa numri i personelit PAK është 20 persona, për vitin 2019. GVJ konstaton se departamenti përmbush detyrimin e parashikuar në kuadrin ligjor për numrin dhe shkallën e kualifikimit të personelit të njësisë bazë si për PAE dhe PAK.</p> <p>Gjatë shqyrtimit të DVV u konstatua se përbërja e Departamentit të Sportit që është përgjegjës për programin e studimit për tre vitet akademike në raportet PAE/PAK është si më poshtë:</p> <p>Për vitin akademik <b>2017-2018, (19 PAE / 5PAK)</b>, nga këta me grada/tituj shkencore <b>16 / 2;</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2018-2019, (20 PAE/ 3 PAK)</b>, nga këta me grada/tituj shkencore <b>16 / 2;</b></p> <p>Për vitin akademik <b>2019-2020, (20 PAE / 4PAK)</b> nga këta me grada/tituj shkencore <b>16 / 3;</b></p>
	<p><b>Përfundimi:</b> për tre vitet e fundit departamenti ka plotësuar kërkesën ligjore për numrin dhe titujt.</p> <p>GVJ konstaton se FSHL-ja përgjegjëse për ofrimin e programit të studimit, posedon një staf akademik me nivel të lartë kualifikimi shkencor, të kategorisë “Profesor”, me grada</p>

	shkencore “Doktor”, si dhe me Master Shkencor.			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi II.3

Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara, informuese, të strukturuar dhe organizuara në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programeve të ciklit të parë.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programet e studimit të ciklit të parë, disponojnë informacionet e nevojshme për organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programeve të studimeve.	GVJ bazuar në <i>(Planin Mësimor i Programit të Studimit) (Apendix Tabela 9 Ref. 35)</i> , konstaton se njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit, disponon informacionet e nevojshme për organizimin e programit, për organizimin e lëndëve/module në semestra dhe vite akademike përkatëse, strukturën e studimeve, si dhe përmbajtjen e programeve të lëndëve/moduleve, elementët e të cilave pasqyrohen në syllabuset e lëndëve/moduleve përkatëse. Dokumentacioni për përmbajtjen e programit të studimit administrohet nga departamenti përgjegjës për programin e studimit, që e arkivon atë. Kopje të dokumenteve mund të depozitohen edhe në dekanat. Organizimi dhe struktura e programit të studimit publikohen në website-n e Universitetit në hapësirën e Fakultetit respektiv, dhe kështu është e aksesueshme nga të gjithë.
<b>Kriteri 2.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë, module, praktikë e aktivitete formuese, në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi.	GVJ konstatoi se program i studimit organizohet në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi, si <i>VKM 41, dt. 25.01.2018; (Apendix Tabela 9 Ref. 47)</i> . Programi i studimit është i organizuar në lëndë, module, praktikë e veprimtari formuese. Te cilat vleresohen me kredite. Kjo pasqyrohet në planin mësimor të programit të studimit sipas <i>(Planit Mësimor i Programit të Studimit) (Ref. 35)</i>
<b>Kriteri 3.</b> Programet e studimit organizohen në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian, të ndara në vite e semestra.	Programi i studimit organizohet në lëndë e module, të vlerësuara me kredite sipas sistemit vendës e evropian. GVJ pasi inspektoi planin mësimor të vën në dispozicion <i>(Planit Mësimor i Programit të Studimit Ref. 35)</i> konstatoi se Plani mësimor i programit të studimit është i organizuar në lëndë e module të cilat vlerësohen me ECTS. Numri maksimal i krediteve të grumbulluara në fund të studimeve Bachelor është 180 ECTS, të shpërndara në mënyrë të barabartë nëpër 6 semestra me 30 ECTS secili.



	<p>Programi i studimit është i organizuar në:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- veprimtaritë formuese bazë (36 kredite);</li> <li>- Lëndë të formimit karakterizues (95 kredite);</li> <li>- Lëndë të formimit ndërdisiplinor dhe integruese (25 kredite);</li> <li>- Lëndë plotësuese (18 kredite);</li> <li>- Detyrime Përmbyllëse (6 kredite);</li> </ul> <p>Veprimtarit formuese grupojnë lëndë/module sipas kategorive të përcaktuara në aktet nënligjor në fuqi.</p> <p>(VKM 41, dt. 25.01.2018)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Programet e studimit përmbajnë planin mësimor, ku përfshihen informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor/jashtë auditorit, frekuentimin/ndjekjen e programit dhe mënyrën e vlerësimit të dijeve etj.</p>	<p>GVJ bazuar ne RVB, dokumentacionet e vëna në dispozicion si dhe takimet në institucion ( zyren e sekretarisë mësimore dhe të kurrikulave) konstatoi se në Planin Mësimor të Programit të Studimit përfshihet i gjithë informacioni i nevojshëm, si emërtimet e lëndëve/moduleve, shoqëruar me orët në auditor si leksion, seminar, ushtrime dhe praktika mësimore, përfshirë edhe totalin e tyre në orë mësimore në auditor, ku secili zë ka vlerësimin me kredite përkatëse sipas (<i>Planit Mësimor i Programit të Studimit Ref. 35</i> )</p> <p>Gjithashtu janë të përcaktuara vitet akademike dhe semestrat kur këto lëndë/module zhvillohen, ngarkesa mësimore ne javë për secilen lëndë/modul. Në Rregulloren e UST referenca përkatëse (<i>Rregullore e UST, Neni 41, 50Ref. 5.</i>), janë të përcaktuara qartë detyrimet mbi frekuentimin e programit të studimit për cdo element përbërës të tij, e cila shprehet qartë në syllabusin e cdo lënde. Forma bazë e kontrollit të dijes është provimi me shkrim. Përveç kësaj për module apo lëndë të veçanta parashikohet edhe vlerësimi në bazë të detyrave të kursit, punëve individuale apo në grupe, esetë apo testet e ndërmjetme si dhe testet praktike për lëndët sportive. Në të dy format bazë të kontrollit të dijeve përdoret sistemi i vlerësimit me 100 pikë.</p> <p>(<i>Model Suplementi Bachelor, tabela e vlerësimit</i>);</p> <p>(<i>Apendix Tabela 13Ref. 8</i> ) ;</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve.</p>	<p>GVJ referuar dokumkentionit (<i>Rregulloren e UST, Kreu III, Neni 84, 85, 86, 87, 88 Ref. 5</i>) dhe RVB, konstatoi se si programet e studimit përmbajnë të gjitha informacionet e nevojshme për studentët që lidhen me kriteret e përgjithshme dhe specifike të pranimit, transferimit dhe ekuivalentimit të studimeve. Kriteret për pranimin e studentëve për programin e studimit Bsc në “Shkencat e Lëvizjes” janë pasqyrim i</p>



	<p>legjislacionit në fuqi dhe specifikave të fakultetit që ofron programin e studimit. Fakulteti i shpall kriteret dhe kuotat e pranimit mjaft kohë para konkursit të pranimit dhe i bën ato publike në website-n e insitucionit në hapësirën Pranimet-Bachelor, informacion i marrë dhe gjatë vizitës dhe takimin me stafin e IT. Kriteret e pranimit janë nota mesatare e maturës shtetërore e cila zë 30% dhe testimi fizik 70%. Ndërsa për ndjekjen e një programi të dytë studimi, procesi i pranimit rregullohet me anë të rregullores së UST-së. Po kështu UST ofron mundësi për transferime sipas kriterëve të përcaktuara paraprakisht nga Senati me anë të vendimeve përkatëse si (<i>Vendim Senati nr. 11, datë 01.03.2019 "Mbi përcaktimit të kuotave të studimit Ref.25</i> ). Procesi i transferimit të studentëve nga IAL të tjera drejt UST dhe anasjelltas dhe ekuivalentimi i një pjese ose i të gjithë programit, shqyrtohen kërkesat e aplikantëve të interesuar për të transferuar studimet dhe institucioni ngre një komisioni <i>ad- hoc</i> dhe pasi komisioni <i>ad- hoc</i> ka shqyrtuar dosjet e aplikantëve shpall kandidatët fitues. Institucioni dispononte dokumentacionet përkatëse për cilësinë e studentëve në hyrje dalje, Vendim Senati për miratimin e testeve praktike;si dhe Procedura e zhvillimit të testeve praktike.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e studimit përmbajnë informacionet e nevojshme për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët apo orët e laboratorit, si dhe të gjithë komponentët formues të programit brenda dhe jashtë auditorit në përputhje me formatet e miratuara.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit përmban informacionin e nevojshëm për programet lëndore (syllabuset e detajuara) për secilën lëndë, për praktikat, seminarët dhe orët e laboratorit. Programet e lëndëve dhe moduleve përbërese të tyre janë hartuar në përputhje me kërkesat ligjore për përmbajtjen dhe formatin e tyre, që janë të pasqyruara edhe në rregulloren e programit të studimit . GVJ konstaton se modeli i syllabuseve është sipas VKM 41/2018. Në cdo syllabus gjendet informacioni në lidhje me objektivat e lëndës, temat e lëndës, format e kontrollit të dijeve dhe mënyra e vlerësimit. Programet e lëndëve janë subjekt rishikimi para çdo viti akademik me qëllim përditësimin e tyre. Drejtuesi i departamentit përgjegjës, njëkohësisht edhe kordinatori i programit ngre grup pune për vlerësimin e cilësisë së programeve të lëndës. Po kështu në në syllabus të lëndës/modulit specifikohen me detaje përshkrimi dhe objektivi i modulit, rezultatet e të nxënit, detyrimet e studentit dhe vlerësimi i tyre bazuar në (<i>Model Programi &amp; Syllabi</i>).<i>Apendix Tabela 14Ref. 10)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit është në</p>	<p>GVJ konstaton se në fund të çdo viti kalendarik, departamenti përgjegjës për programin bën analizën vjetore</p>

<p>përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet eventuale dhe arkivohet dosja e plotë.</p>	<p>të punës për vitin përkatës, ku përfshihen diskutime të personelit akademik në drejtim të zhvillimit të lëndëve të caktuara. Përmbajtja e programeve të studimit është në përmirësim dhe përditësim të vazhdueshëm dhe në fillim të çdo viti akademik miratohen ndryshimet. Ndër çështjet që planifikohen të diskutohen janë propozime të personelit akademik në drejtim të zhvillimit të lëndëve të caktuara. Këto diskutime dokumentohen në një dokument final dhe i përcillen dekanatit të cilat shprehen në <i>(Plani Strategjik FSHL, pika 5 Ref. 44)</i>. Propozimet që gjykohen me vlerë për t'u implementuar mbahen shënim për vitin e ardhshëm akademik. Për këto propozime ngrihet një grup pune me përfaqësues nga dekanati që më pas të çojë për miratim Senatit Akademik ndryshimet deri në masën 20% sipas udhëzimeve nga MAS dhe pasqyrohen në program i cili është i aksesueshëm nga të gjithë. <i>(Model Programi &amp; Syllabi Ref. 10)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përbushet</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IL4</b></p>	
<p><b>Struktura, organizimi dhe përmbajtja e programeve të studimit është në përputhje me objektivat formuese, nivelin e kualifikimit sipas Kuadrit Kombëtar dhe Evropian të Kualifikimeve, rezultateve të të nxënit dhe vazhdimin të studimeve, kompetencave në përputhje me kërkesat e tregut të punës.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi.</p>	<p>GVJ konstaoi se institucioni në vazhdimësi për programin e studimit i përmbahet legjislacionit në fuqi si modelit të Bolonjës. Ngarkesa e programit të studimit është strukturuar në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi. Studimet e ciklit të parë Bachelor në UST, ofrohen me kohë të plotë, dhe me kohëzgjatje normale 3 (tre) vite akademike. Studimet në këtë cikël realizohen me, së paku, 180 kredite, konform legjislacionit në fuqi, mbështetur në IAL 80/2015 “Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në IAL në RSH”, Neni 73. <i>(Ref. 4)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Emërtimi, përmbajtja e veprimtarive, shpërndarja e lëndëve dhe praktikave mundësojnë, njohuri, aftësi dhe/ose punësim</p>	<p>GVJ nga konsultimi me dokumentat e vena në dispozicion si <i>(Plani Mësimor i Programit të Studimit Ref. 35.)</i> dhe RVB, konstaoi se emërtimi i programit të studimit Bsc në Shkencat e Lëvizjes është në përputhje me fushën e studimit të cilën mbulon programi. Disiplinat mësimore dhe veprimtaritë e</p>



të studentëve.	tjera formuese që ofrohen në këtë program studimi janë të organizuara në 5 kategori, nga A – ja te E – ja. Të gjitha lëndët e ofruara në këtë program, synojnë pajisjen e studentëve me njohuri dhe aftësi që i përgatitin për tregun e punës.
<b>Kriteri 3.</b> Lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimi profesional.	GVJ konstaoi se programi mësimor është i organizuar në lëndët/modulet, shpërndarja në vite e semestra, vlerësimi në kredite e orë mësimore mundëson arritjen e objektivave formuese të programit të studimit. Plani mësimor i programit të studimit për secilin vit të studimeve është organizuar të shtrihet përgjatë 2 semestrave me kohëzgjatje normale 15-16 javë. Referuar ( <i>Plani Mësimor i Programit të Studimit Ref. 35</i> ), shpërndarja e ngarkesës mësimore në semestrat e kohëzgjatjes së programit është e balancuar që të mundësojë arritjen e rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimi profesional të studentit, mbi metodat dhe parimet shkencore të përgjithshme si dhe aplikimet e drejtpërdrejta të njohurive të marra në fushën e edukimit fizik dhe sporteve sipas ( <i>Model Programi &amp; Syllabi Ref.10</i> ).
<b>Kriteri 4.</b> Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare.	Struktura e programit, lëndët dhe emërtimi i tyre, ngarkesa në kredite, raporti teori praktikë është në përputhje me profilin e programit bachelor dhe e përafërt me programe të ngjashme ndërkombëtare. Raporti teori-pratikë është tërësisht në përputhje me profilin e programit të studimit duke zbatuar me përpikmëri planin mësimor të aprovuar në senat.  ( <i>Plani Mësimor i Programit të Studimit Ref. 35.</i> )
<b>Kriteri 5.</b> Ndarja sipas veprimtarive formuese dhe raportet midis formimit teorik dhe praktik mundësojnë arritjen e objektivave formues, transferim të studimeve, mobilitet dhe punësim në përfundim të studimeve.	GVJ nga konsultimi i planeve mësimore të vëna në dispozicion, ( <i>Plani Mësimor i Programit të Studimit Ref.35.</i> ) konstaoi se institucioni në mënyrë të vazhdueshme ka ndjekur parimet ndërkombëtare të ndërtimit të programit mësimor, kurrikula e programit garanton mundësinë e transferimit gjatë studimeve ose në përfundim të ciklit të studimeve. Në programin e studimit Bachelor “Në Shkencat e Lëvizjes” raporti midis formimit teorik, që realizohet me lëndët bazë, karakterizuese e ndërsiplinore është i drejtë në raport me lëndët e formimit praktike. Referuar RVB nëpërmjet lëndës praktike, studentët aftësohen të organizojnë veprimtarinë e tyre mësimdhënëse dhe atë jashtëmësimore sportive, të kenë një kuptim të qartë për shkollën, për vështirësitë e detyrës së mësuesit të EF, por edhe të kultivojë ndjenjën që mësuesi veç mësimdhënies, ka një mision të lartë për të kryer edukimin e nxënësve me normat e moralit demokratik e përgatitjen e tyre për të ardhmen.

<p><b>Kriteri 6.</b> Programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB, vizitën në bibliotekën e institucionit si takimet me studentët konstatoi se programet e lëndëve/moduleve përditësohen në mënyrë të vazhdueshme duke u bazuar në literaturë të detyruar dhe ndihmëse të 5 viteve të fundit. Programet e lëndëve rishikohen çdo fillim semestri nga titullari i lëndës, merren në shqyrtim nga grupi i punës i ngarkuar nga Koordinatori i programit dhe miratohen nga ky i fundit. Në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies, kërkohet që kur është e mundur (në varësi të titujve që disponohen në fondin e Bibliotekës së institucionit), literatura bazë dhe e rekomanduar e përfshirë në programin e lëndës, të përfshijë tituj që datojnë jo më herët se 5 (pesë) vitet e fundit dhe që janë botuar nga shtëpia botuese Human Kinetics që boton “leading books”, autoritete në fushën e studimit.</p> <p>(Ref. <a href="http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/">http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/</a>)</p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Përmbajtja e programeve të studimit garanton përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ bazuar në RVB si dhe dokumentat si (<i>Model Suplementi Bachelor Ref. 80</i>) konstatoon se programi, është në përputhje me objektivat për programe studimi të ciklit të parë, ky program synon që të pajisë studentët me njohuri dhe koncepte bazë të fushës së studimit dhe aftësi drejt një profesioni apo licence profesionale; aftësi bazë për punë kërkimore; aftësi të përgjithshme praktike, aplikative, të përshtatshme për programet e studimit të ciklit të parë, dhe në përmbushje të kriterëve hyrëse për thellim e profilizim të mëtejshëm në programet e studimit të ciklit të dytë dhe të tretë, duke garantuar kështu përfundimin e dijeve, aftësive dhe kompetencave të synuara për programet e studimit të ciklit të parë.</p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Përmbajtja e programeve të studimit mundëson vijimin e mëtejshëm të studimeve dhe/ose punësimin e studentëve në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës.</p>	<p>GVJ konstatoi se programi i studimit është i ndërtuar mbi parimin e raportit praktikë/teori në shifrat afërsisht 40% me 60%, që dëshmon teorinë dhe praktikën, çka mundëson përvetësimin e dijeve bashkëkohore, aftësive të përgjithshme praktike sipas (<i>Model Suplementi, pika 5 Ref. 8</i>).</p> <p><i>Në vazhdimësi do të sygjeronim rritjen e raportit të orëve praktike në këtë program studimi 50% me 50%.</i></p> <p>Përfundimi me sukses i ciklit bachelor, u jep mundësinë studentëve për të vazhduar më tej studimet e ciklit të dytë, ose për të punuar si specialistë të edukimit fizik. Në përfundim të këtij cikli studenti mund të pranohet në ciklin e dytë të programit të studimeve që ofrojnë fakultetet e UST-së, si dhe programet ekuivalente dhe të ngjashme brënda dhe jashtë vendit. Mbajtësi i kësaj diplome, ka të drejtë për tu punësuar</p>





	<p>si specialist në fushën e sportit dhe edukimit fizik. Ka të drejtë për tu punësuar në çdo vend pune në administratë që kërkon një nivel arsimor bachelor të pa specifikuar. (NEEDS ANALYSIS ON LLL FOR TEACHERS UST TEAVET project Ref. 46)</p>			
<p><b>Kriteri 9.</b> Për përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit dhe për përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut e punës, strukturat përgjegjëse konsultohen dhe marrin parasysh propozimet e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve nga tregu i punës.</p>	<p>GVJ nga takimi me stafin akademik, drejtusit e institucionit , si dhe dokumentat e vëna në dispozicion, konstatoi përmirësimin e përmbajtjes së programit të studimit në vazhdimësi, përshtatjen sa më mirë me kërkesat e tregut të punës. UST përdor platformën <a href="http://alumni.ust.edu.al/">http://alumni.ust.edu.al/</a> e cila siguron feedback virtual nga partnerët privatë përmes ofertave të punësimit të shpallura prej këtyre të fundit në platformën online.</p> <p><i>Raporti mes kërkesë dhe ofertës për një vend pune siguron feedback të besueshëm, i cili duhet të merret parasysh dhe të reflektohet në përmbajtjen e programit të studimit.</i></p> <p>Takimet mes studentëve e subjekteve bashkëpunuese, të organizuara me mundësimin e Zyrës së Karrierës në nivel insitucioni dhe nivel fakulteti, janë mundësi për përfitim të një feedback-u real në drejtim të kërkesave të tregut të punës të ardhura nga aktorët kryesorë të sektorit Departamenti përgjegjës (Departamenti i Sporteve), konsultohet me strukturat drejtuese te institucionit, me bashkëpunëtorët e tij me synim përmirësimin e përmbajtjes së programeve të studimit për ti përshtatur sa më mirë me kërkesat e tregut e punës. Konstatim i bërë gjatë takimit me përfaqësues të Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				X

<b>Standardi II.5</b>	
<b>Personeli akademik dhe ndihmës-akademik përgjegjës për realizimin e programit të studimit përmbush kërkesat ligjore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik për garantimin e standardeve të mësimdhënies.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat</p>	<p>GVJ nga inspektimi i dosjeve të PAE dhe PAK, si dhe takimit në zyrën e burimeve njerëzore, konstatoi se personeli akademik është me tituj dhe grada shkencore sipas legjislacionit në fuqi duke përmbushur kështu kërkesat ligjore</p>

ligjore në fuqi.

**Kriteri 2.** Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e moduleve mësimore të programit të studimit.

për personelin akademik PAE dhe PAK. Referuar dokumentit (*Apendix Tabelat 6.1, 6.2, dhe 6.3*), të dhënat për stafin e angazhuar në mësimdhënie për këtë program studimi për gjatë tre viteve akademike është si më poshtë:

Për vitin **2019-2020** janë angazhuar **42** pedagogë gjithsej (**37 PAE / 5 PAK**);

- 7 Prof.Dr;
- 6 Prof.As;
- 14 Dr;
- 8 Doc;
- 7 Msc;

Mbulimi i programit në përqindje është **88% PAE**.

Për vitin **2018-2019** janë angazhuar **42** pedagogë gjithsej (**36 PAE / 6 PAK**);

- 8 Prof.Dr;
- 6 Prof.As;
- 12 Dr;
- 7 Doc;
- 9 Msc;

Mbulimi i programit në përqindje është **85% PAE**.


Për vitin **2017-2018** janë angazhuar **42** pedagogë gjithsej (**35 PAE / 7 PAK**);

- 8 Prof.Dr;
- 8 Prof.As;
- 11 Dr;
- 6 Doc;
- 9 Msc;

Mbulimi i programit në përqindje është **83% PAE**.

GVJ në vazhdim edhe të kriterit 1 dhe referuar (*Apendix Tabela 12.1, 12.2, 12.3*), konstaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme, që angazhohen në realizimin e programit të studimit kanë nivelin e duhur të kualifikimit akademik për drejtimin e programit, është i kategorisë “Lektor” dhe As/Lektore. Nga të dhënat rezultojnë se programi i studimit në tre vitet e fundit është mbuluar me **mbi 70% nga PAE**, duke plotësuar kërkesat ligjore. Përgjegjësi i programit ka titullin “Doktor” dhe ka një eksperiencë të gjatë akademike. Personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme që angazhohet në realizimin e programit të studimit, si titullarë të

	lëndëve apo moduleve janë pedagogë me grada e tituj ose janë pedagogë të cilët kanë kualifikim të ciklit pasardhës (MSc.). Po kështu titullarët përgjegjës të lëndëve, ashtu edhe titullarët e modulit zhvillojnë orët në auditor sipas normës përkatëse të lejuar, bazuar në kategoritë që mbartin gjithsecili.
<b>Kriteri 3.</b> Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e përgjithshme dhe specifike e anëtarëve të personelit akademik që mbulon programin e studimit, janë në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe specifikën e moduleve të tij.	GVJ bazuar në RVB, dokumentacionin e vene në dispozicion si dhe vizita në institucion, konkretisht te zyra e burimeve njerëzore, nga inspektimi i dosjeve personale CV së pedagogëve, konstatoi se personeli akademik i angazhuar për zhvillimin e lëndëve/moduleve është me grada e tituj, ose kualifikime të ciklit pasardhës (Msc.). Ndarja e lëndëve është bërë në përputhje me fushën e ekspertizës të secilit prej tyre, specifikën e moduleve. Gjithashtu, stafi akademik, është i përfshirë edhe në projektet e kërkimore kombëtare, që janë në përputhje me programin e studimit dhe ekspertizën e tyre. Niveli i kualifikimit dhe fusha akademike-kërkimore e personelit akademik me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme që mbulon programin e studimit, është tërësisht në përputhje me natyrën dhe specifikën e moduleve dhe lëndëve që ata zhvillojnë. Personeli akademik i Departamentit të Sportit mbulon lëndët me natyrë sportive, personeli akademik i Departamentit të Shkencave Sociale dhe Edukimit mbulon lëndët dhe modulet me natyrë psikosociale, teoriko-metodologjike, dhe personeli akademik i Departamentit të Mjekësisë Sportive mbulon lëndët dhe modulet me natyrë mjekësore.
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në marrëveshje dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit.	GVJ nga konsultimi me DVV, ( <i>Model Marrëveshje DAR/ZARef. 49.) dhe (Marrëveshje bashkëpunimi me organizata sportive Ref.13), konstatoi se institucioni, ka marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, dhe vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, punimin e diplomës dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. Referuar RVB për modulet që kanë praktika mësimore, UST bashkëpunon me Zyrën Arsimore Vendore e Qytetit të Tiranës Cdo fillim viti akademik lektorët me tituj/gradë, paraqesin në departament temat për punimin e diplomës në fushat përkatëse të lëndëve/moduleve që ata angazhohen duke u dhënë kështu mundësinë studentëve të përzgjedhin temën e tyre sipas rregullave të parashturuara në Rregulloren e UST.</i>
<b>Kriteri 5.</b> Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e	GVJ ne konsultim me DVV dhe vizita në institucin, konstatoi se në rang fakulteti numërohen 5 personel ndihmës mësimor,




<p>personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit.</p>	<p>me kualifikimin përkatës. Gjithashtu institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës mësimor shkencor të përshtatshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit si paradite edhe mbasdite për MP, Msc. Angazhimi dhe rekrutimi i personelit ndihmës akademik rregullohet me vendime të rektoratit bazuar dhe në referencat e mëposhtëme: <i>(Vendim Rektorati Nr. 1533 prot., datë 30.10.2018 "Mbi riorganizimi dhe emertimi i laboratoreve mesimor/kerkimor ne UST" Ref.51)</i>. Pranë çdo njësie bazë ka të angazhuar Personel Ndhmës Mësimor, përgjegjës për mirëmbajtjen e ambienteve laboratorike dhe mirëmbajtjen e mjediseve mësimore, auditorët përkatës, mjetet audiovizuale, palestrave etj. Të drejtat dhe përgjegjësit e personelit ndihmës mësimor janë të parashikuara në rregulloren e institucionit.</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës II</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

## MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT

<b>Standardi III.1</b>	
<b>Institucionin ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/ moduleve.	GVJ konstatoi nga takimi që bëri me zyrën e koordinimit dhe marrdhënieve me jashtë, me zyrën e këshillimit të karrierës si dhe dokumentacionin e vënë në dispozicion se institucioni është i hapur ndaj metodave më inovative në mësimdhënie. Kjo gjë ka bërë adoptimin e teknologjisë në fushën e inovacionit. Gjithashtu institucioni në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies dhe për të qenë të përditësuar me metodat më inovative në këtë fushë, është i hapur ndaj zhvillimeve më të fundit dhe është i gatshëm t'i implementojë ato. Përveç kësaj institucioni siguron trajnimin e nevojshëm

	<p>për stafin akademik që t'i ndërthurin ato në veprimtarinë e tyre të mësimdhënies. (<i>Konstatim i bërë gjatë takimit me përfaqësues të Drejtorisë së Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni</i>). Zhvillim domethënës ka qenë kalimi nga regjistrimet në format hard copy në platformën elektronike, hapësirë që përdoret nga stafi akademik dhe nga studentët konstatim i bërë gjatë takimit edhe me studentët si dhe bazuar në dokumentacionin e vënë në dispozicion (<i>Manual i Studentit (Ref.53)</i>). GVJ nga takimi me stafin, studentët, mori informacion se institucioni mundëson takime orientuese ndërmjet stafit dhe ekspertëve IT të platforms, po kështu institucioni zhvillon takime informuese për të orientuar stafin në veprimtarinë e tyre kërkimore-shkencore dhe në lidhje me publikime në revista shkencore me zë në fushën e studimit. Përdorimi i metodave inovative të mësimdhënies, parashtrohet në syllabusin e lëndës/modulit .</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni zotëron një plan strategjik të Zhvillimi, konstatim i bërë gjatë vizitës në institucion si dhe dokumentacionit të vënë në dispozicion nga institucioni si (<i>Plani Strategjik i Zhvillimit UST, pika 3.5 Ref. 3</i> ). GVJ konstatoi se strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse , duke bërë të mundur matjen e treguesve të performancës së personelit akademik në përputhje me Rregulloren e institucionit, zbatimi i programit mësimor është një proces që mbikëqyret në mënyrë periodike përgjatë shtrirjes së vitit akademik nga zëvendësdekani në bashkërendim me drejtuesin e njësisë bazë, përgjigjës/koordinator i programit të studimit. Në fund të çdo semestri, cilësia e mësimdhënies së stafit vlerësohet nëpërmjet metodave si pyetësorët dhe focus grupet, që në çdo rast u garantojnë studentëve ruajtjen e anonimatit. Kjo strategji e monitorimit të mësimdhënies u konstatua dhe nga dokumentat e vëna në dispozicion si (<i>Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 21, 22</i>); (<i>Model Pyetësori i Studentëve Prill 2018</i>).</p> <p><i>Ka vend për përmirësim në këtë drejtim, duke futur si praktikë pune edhe pyetësorët në bazë lënde ose në bazë pedagogu përgjegjës e cila synon përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së mësimdhënies.</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, të vlerësimit të dijeve,</p>	<p>Në takimin e bërë me studentët GVJ konstatoi, se institucioni garanton përfshirjen e studentëve në vlerësimin periodik të formave e metodave të mësimdhënies, vlerësimit dhe ankimimit të tyre. Procesi i vlerësimit të mësimdhënies është</p>



<p>përfshirë mundësinë e trajtimit të ankimeve.</p>	<p>një proces i orientuar me kahje nga studenti. Për këtë arsye studentët janë një faktor i rëndësishëm në vlerësimin e input-it akademik që u transmetohet në auditor. Gjatë intervistave që ruajnë anonimatit e studentëve, ata kanë mundësi të japin vlerësimin e tyre për çështje të lidhura me procesin e mësimdhënies, ky informacion u mor jo vetëm nga takimi me studentët por dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion (<i>Raport i Fokus Grupeve të Studentëve, NJSBC Maj 2019 Ref. 6</i>). Studentët rezultojnë të kënaqur me nivelin e mësimdhënies së lektorit dhe vlerësimit të dijeve nga ana e tyre. Edhe takimet në kuadër të funksionimit të Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve u japin mundësi studentëve të shprehin shqetësimet e tyre në prani të një anëtari Zyrës së Këshillimit dhe koordinatorit të programit ose një përgjegjësi të një grup lëndësh. Po kjo zyrë organizon këshillime individuale që ruajnë anonimatit e studentit mbi ecurinë e studimeve.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me stafin dhe përfaqësues të NJSBC, konstatoi se rezultatet e vlerësimit të Fokus Grupeve të Studentëve, pasi përpunohen nga NJSBC i raportohen Rektorit të Universitetit dhe më pas publikohen online në faqen web të institucionit në hapësirën Rreth Universitetit-Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë Raportet <a href="http://ust.edu.al/raportet/">http://ust.edu.al/raportet/</a>. Raportimet e vlerësimeve (periodike dhe vjetore) të kryera nga NJSBC, përdoren si burim për vlerësime të brendshme, dhe për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së mësimdhënies. Rezultatet nga raportet përfshihen në Analizën Vjetore të Senatit Akademik, ku ftohen të marrin pjesë personeli akademik, ndihmës akademik, administrata dhe studentët. Aktiviteti dhe puna e NJSBC bazohet në (<i>Rregulloren e NJSBC, Neni 7 Ref. 6</i>)</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit dhe inkurajon personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion me përgjegjësin e departamentit dhe takimit me pedagogët e programit të studimit, konstatoi se fakulteti shqyrton me kujdes raportet e përfuara përmes mekanizmave vlerësues dhe merr masa që të bëjë këshillime individuale me personelin akademik, në rast se në raport evidentohen problematika në lidhje me procesin e mësimdhënies. Edhe pas procesit të inspektimit të procesit mësimor, në rast parregullsish jepet këshillim për personelin akademik dhe në rast shkeljesh të përsëritura jepen merren masa ndëshkimore. Nga verifikimi i dokumentacionit dhe takimet e bëra GVJ nuk konstatoi ndonjë rast konkret që ti ishte bërë ndonjë këshillim.</p>
<p><b>Shkalla e përmbushjes së</b></p>	<p>Nuk      Përmbushet      Përmbushet      Përmbushet</p>

standardit	plotësisht	pjesërisht	kryesisht	plotësisht
				X

### Standardi III.2

**Institucioni garanton zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional e shkencor me metodat dhe praktikat më të mira.**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Format e mësimdhënies, mësimnxënies dhe transmetimit të dijeve e njohurive janë leksionet, seminarët, laboratorët, detyra kursit/ esetë, praktikat profesionale e klinike, orët e hapura dhe çdo formë tjetër e miratuar nga institucioni.</p>	<p>GVJ nga verifikimi i programit mësimor konstatoi se ky program përmban informacionin e nevojshëm të formave të mësimdhënies dhe mësim nxënies të cilat janë të shprehura qartë në syllabuset e lëndëve. GVJ konstatoi gjithashtu në dokumentacionin e vënë në dispozicion se elementet e studimeve të parashikuara në rregulloren e institucionit në përputhje me specifikën e programit të studimit, modelin e syllabusit të aprovuar me VKM Nr.41, përfshijnë leksionet, seminarët, ushtrimet, laboratorët, praktikat mësimore e profesionale, provimet e ndërmjetme dhe përfundimtare, detyrat e kursit, esetë etj. Po kështu institucioni merr masa që programet e lëndës të ndërtohen mbi bazën e të gjithë elementeve në rregulloren e UST, (<i>Rregullore e UST, Neni 39Ref.5</i>), dhe procesi mësimor të zhvillohet mbi bazën e tyre. Nga verifikimi i planit mësimor sipas references (<i>Plani Mësimor i Programit të Studimit Bachelor. Apendix Tabela 10 Ref. 35</i>), GVJ konstatoi se Programi përmban:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- leksion                    <b>750</b> orë;</li> <li>- seminare                 <b>336</b> orë;</li> <li>- ushtrime                 <b>772</b> orë;</li> <li>- laboratore                <b>89</b> orë;</li> <li>- praktikë mësimore   <b>50</b> orë;</li> <li>- Gjithsej                   <b>1997</b> orë;</li> </ul>
<p><b>Kriteri 2.</b> Personeli akademik pranon, duhet të respektojë dhe t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies, në përputhje me fushën dhe natyrën e programit të studimit në përgjithësi dhe moduleve e aktiviteteve formuese në veçanti.</p>	<p>Gjatë takimit me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit GVJ, konstatoi se personeli akademik pranon dhe respekton t'u përgjigjet diversitetit dhe nevojave të studentëve, duke ofruar forma, mënyra, metoda e mundësi alternative të mësimdhënies e mësimnxënies. Elementët e studimit të programit të studimit janë të një natyre të shumëllojshme, kjo për shkak të specifikave të arsimit që ofron institucioni. Po kështu institucioni mundëson të adresojë diversitetin e studentëve me anë të organizimit të workshop-eve ku studentët referojnë tema të lidhura me fushën e tyre të ekspertizës, praktikë që ka marrë feedback pozitiv nga studentët. Personeli Akademik i UST-së respekton individualitetet e studentëve, duke e reflektuar jo vetëm në komunikimin korrekt dhe të</p>

	<p>drejtpërdrejtë me ata, por edhe në procesin mësimor, duke ofruar modele dhe metoda të ndryshme të mësimdhënies si, punë me grupe, ese, detyra individuale, seminare për bashkëbisedim, bazuar gjithmonë në <i>(Rregulloren e UST, Neni 29 Ref.5)</i>.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike. Institucioni mundëson përdorimin e metodave të shumëllojshme dhe fleksible pedagogjike, të përshtatshme e në përputhje me rezultatet e pritshme të të nxënit, objektivat formues dhe kërkesat e punëdhënësve.</p>	<p>GVJ nga takimi me stafin akademik u informua se institucioni mbështet personelin e tij akademik në përmirësimin e kompetencave didaktike, duke marrë pjesë në programe shkëmbimi si ERASMUS+, u ofron pedagogëve mundësi mobiliteti drejt IAL-ve brenda BE, ashtu si edhe mirëpret lektorë të huaj po në kuadër të programit të mobilitetit të stafit akademik. Ky shkëmbim i ndërsjelltë eksperiencash akademike çon në përmirësim të metodave pedagogjike kjo u veifikua nga GVJ dhe nga vënia në dispozicion i Raportit të fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. Gjatë 3 viteve të fundit dy Prof. Asoc. Dr. nga PAE e Fakultetit kanë referuar leksione në Universitetin e Aradit dhe institucioni ka pritur 5 lektorë nga ky universitet .Zbatimi i planit të punës në përputhje me rregulloren e programi të studimit për arritjen e synimeve si dhe klima sociale midis stafit evidentojnë nxisin marrëdhënie të frytshme midis tyre. Rëndësi e veçantë i kushtohet infrastrukturës me qëllim mundësimin e përdorimit të metodave të shumëllojshme pedagogjike, përdorimin e laboratorëve për kërkime shkencore cilësore, për t’iu afruar nevojave dhe rezultateve të të nxënit nga studentët, objektiveve dhe kërkesave të programit të studimit, për të përmbushur misionin e institucionit sipas një <i>(Plani Strategjik FSHL, pika 2,5,6 Ref.44)</i>.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik i angazhuar në mësimdhënie është kompetent në shpjegimin e njohurive e koncepteve dhe përdor metoda të ndryshme të mësimdhënies sipas tematikave dhe profilit.</p>	<p>GVJ në inspektimin e dokumentacioneve përse i përket rekrutimit të personelit dhe dosjeve individuale të PAE dhe PAK konstatoi se, Personeli akademik që është ngarkuar me mësimdhënie në programin e studimit ka formimin e duhur arsimor e profesional për fushën, ashtu siç dëshmon se zotëron kompetencën e duhur për transmetimin e njohurive duke përzgjedhur midis formave tradicionale e alternative të mësimdhënies. Po kështu stafi pedagogjik i angazhuar në programin e studimit Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes” përmbush kriteret e kualifikimit shkencor, me tituj akademik e grada shkencore bazuar, edhe në të dhëna tabelore për personelin akademik në programin e studimit/ Cilësia në mësimdhënie. Si dhe referencat <i>(Appendix.Tabela 6.1,Tabela 6.2, Tabela 6.3)</i>. Lektorët përgjegjës të lëndëve/ moduleve që zhvillojnë mësimin janë individë kompetentë në transmetimin</p>



	e njohurive të mësimdhënies dhe koncepteve teorike të fushës së studimit, si dhe në varësi të llojit të lëndës/ modulit dhe temave mësimore, lektori ndërthur metoda të ndryshme mësimdhënieje me qëllim afirmimin e personalitetit e individualiteti të çdo studenti.
<b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik vlerëson dhe përmirëson format e metodat e mësimdhënies në mënyrë periodike, duke përfshirë studentët në këtë proces dhe duke reflektuar mendimet e sugjerimet e tyre.	GVJ nga vizita në institucion si dhe DVV, konstatoi se Departamentet në bashkëpunim me Zyrën e NJSBC-së organizojnë në mënyrë periodike, takime me studentët për të dëgjuar sugjerimet e tyre për sa i përket programeve të lëndëve, veçanërisht ato që janë teorike dhe praktike në disiplina të ndryshme sportive. Marrja e feedback-ut të studentëve në mënyrë periodike përmes focus grupeve dhe takimeve e këshillimeve individuale ose në grup, ndër të tjera bëhet me qëllim përmirësimin e metodave të mësimdhënies në frymën e sugjerimeve e propozimeve të ardhura nga studentët
<b>Kriteri 6.</b> Personeli akademik përdor metoda interaktive dhe diskutimi, duke i bërë tërheqëse orët e mësimit.	Gjatë takimit me stafin akademik, inspektimit të sallave të leksioneve, laboratorëve, GVJ konstatoi se personeli akademik orët e leksioneve i zhvillon në mënyrë interaktive në formën e prezantimeve Power Point. Për këtë qëllim çdo sallë leksionesh është e pajisur me logjistikën e nevojshme. video projector. Po kështu edhe orët e seminareve organizohen në formën e diskutimeve në grup. Orët praktike zhvillohen në ambiente të pajisura me bazën didaktike për zhvillimin e praktikës. Në programin e studimit Bachelor “Në Shkencat e Lëvizjes” janë të parashikuara orë seminari bashkë biseduese me qëllim që, studentët të mund të shkëmbejnë idetë dhe përvojat e tyre me njëri tjetrin, të mësojnë dhe ndërveprojnë midis tyre. Gjithashtu lektori përgjegjës ndërthur edhe metoda të tjera, si puna me grupe, metodë e cila nxit partneritet ndërmjet tyre e procesi mësimor është tërheqës për studentët. Duke parë që fusha e sportit ecën me ritme të shpejta, personeli akademik mundohet që metodat më të reja ti shfrytëzojë për përmirësimin e cilësisë së procesit mësimor. <i>Konstatim i bërë gjatë takimit me përfaqësues të studentëve dhe stfit akademik.</i>
<b>Kriteri 7.</b> Format dhe metodat e mësimdhënies inkurajojnë sensin e autonomisë te studentit, duke siguruar në të njëjtën kohë udhëzimin dhe mbështetjen nga mësimdhënësi dhe ndërtimin e marrëdhënieve të respektit të ndërsjellë mes tyre.	GVJ nga inspektimi i planeve mësimore dhe syllabuseve në vite konstatoi se çdo program lënde përfshin bibliografinë e detyrueshme dhe atë të rekomanduar. Pedagogët i përzgjedhin titujt e librave, aty ku është e mundur, nga fondi i Bibliotekës së institucionit. Kështu studentët kanë mundësi të punojnë në mënyrë të pavarur dhe të marrin pjesë në diskutimet e zhvilluara në orët e seminarit, duke e pasuruar informacionin e marrë gjatë orës së leksionit. Konstatim i bërë nga verifikimi i Syllabuseve të lëndëve të ofruara në vite.

Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.3

Njësitë përgjegjëse garantojnë zhvillimin e mësimdhënies, mësimnxënies dhe aftësimin profesional duke vënë në dispozicion të gjithë infrastrukturën fizike, didaktike e logjistike e nevojshme për realizimin me sukses të aktivitetit mësimor e shkencor.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Procesi mësimor e shkencor realizohet në hapësira të mjaftueshme dhe cilësore, të cilat janë të pastra dhe mirëmbahen rregullisht.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se institucioni disponon infrastrukturën e nevojshme mësimore e shkencore për t'u ofruar studentëve një përvojë arsimore cilësore. Në rang programi studimi institucioni përllëgarit 16932 m<sup>2</sup> sipërfaqe në juridiksionin e tij, që është në përmbushje të plotë të standardit ligjor në fuqi m<sup>2</sup>/student, 37m<sup>2</sup>/student. E gjithë hapësira e dedikuar pastrohet e mirëmbahet nga stafi i punësuar për këtë qëllim. UST ka disa godina me vendndodhje të përhershme brenda territorit të saj me të gjitha mjediset e nevojshme mësimore, kërkimore, administrative dhe të shërbimit. Këto godina janë pronë e MASR dhe në administrim të UST-së. Ambientet ku zhvillohet procesi mësimor kanë hapësirën e mjaftueshme për tu shfrytëzuar nga studentët dhe plotësojnë tërësisht kushtet higjienosanitare. Ky informacion u konstatua dhe nga dokumentat e vëna në dispozicion nga institucioni si të dhëna të plota për infrastrukturën;(Ref. Nr. 60, VKM 418, datë 10.05.2017, Shtojca 1).</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Ambientet e dedikuara për procesin mësimor janë funksionale dhe të pajisura me logjistikën e nevojshme për realizimin me cilësi të procesit mësimor.</p>	<p>Për realizimin e programit të studimit, fakulteti disponon 14 auditore për procesin e mësimin (2 salla leksionesh, 4 seminaresh, 8 laboratore). Sallat e leksionit janë pajisur me logjistikën e nevojshme për realizimin e leksioneve në formën e prezantimeve Power Point si PC e projektorë. Mësimdhënia dhe aktivitetet e tjera të procesit mësimor teorik dhe praktik zhvillohen në godinat në dispozicion të UST. UST ka zyra specifikesht për stafin akademik, bibliotekë, laboratore të ndryshme, sekretari mësimore dhe staf ndihmës administrativ, salla leksionesh dhe seminaresh, zyrat e departamenteve si edhe mjediset sportive, palestra e lojërave, palestra e gjimnastikës, laborator i fitnesit, terrenet për kalceto , për tenis, fusha e futbollit me pistën e atletikës etj, informacion që u konstatua dhe nga inspektimi i DVV si (të dhëna të plota për infrastrukturën; Ref. Nr. 60), (VKM 418, datë 10.05.2017, Shtojca 1, Apendix. Tabela 16).</p> <p>GVJ sygjeron që këto pista, palestra të institucionit të jenë më të</p>

	<p>zgjerruara dhe me infrastrukturë më të mirë, për të shërbyer më mirë orëve praktike të studentëve.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sisteme të ndryshme informatike, infrastrukturë të konsoliduar IT të nevojshme për realizimin e procesit mësimor.</p>	<p>GVJ konstatoi nga vizita në institucion dhe dokumentacioni i vënë në dispozicion se institucioni lehtëson procesin e mësidhënies dhe mësimnxënies përmes infrastrukturës elektronike që disponon. Studentët dhe personeli akademik përdorin për qëllimet e tyre Sistemin për Menaxhimin e Informacionit të Studentëve. Aksesin në këtë sistem realizohet përmes account-it personal të studentit dhe të pedagogut në platformën elektronike online ESSE3. Në llogarinë e tyre personale, studentët informohen për vlerësimin në notë për çdo lëndë, gjejnë transkriptin e vlerësimeve, mesataret e ponderuara të vlerësimeve, prenotojnë provimet që planifikojnë të japin, gjejnë informacionin e nevojshëm në lidhje me orën, vendin e zhvillimit të provimit, si edhe komunikojnë me pedagogët përkatës. Nga ana e tyre pedagogët përmes account-it personal në portal hedhin vlerësimin në notë, vlerësojnë frekuentimin e studentëve, hedhin programet e lëndëve, si edhe mund t'u komunikojnë studentëve informacione të nevojshme. KOHA është një platformë online (open source) që lehtëson shfrytëzimin sa më të mirë të fondit të Bibliotekës, pasi bën të mundur kërkimin e librave në mënyrë elektronike me titullin e tyre duke dhënë edhe një përshkrim të shkurtër të përmbajtjes së çdo kapitulli. Territori i UST-së mbulohet me shërbim interneti free gjatë 24 orëve. FSHL-ja ka personelin ndihmës të përshtatshëm për përdorimin e pajisjeve e teknologjisë mësimore në ndihmë të pedagogëve dhe të studentëve. Ky personel mirëmban gjithë rrjetin e internetit dhe pajisjet kompjuterike në laboratorët e informatikës, biomekanikës, biokimisë dhe psikologjisë. UST ka personel për shërbime të ndryshme. Ata janë plotësisht të angazhuar për të përmbushur objektivat e programit ,bazuar ky informacion edhe në DVV, (referencën Kontratë Shërbimi Interneti Keminet, Apendix Tabela 17Ref.62) si dhe të dhëna për infrastrukturën/Struktura e Teknologjisë së Informacionit; Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të studimit (fizike dhe elektronike), garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme të parashikuara në programin</p>	<p>Nga vëzhgimi i planeve mësimore, GVJ konstatoi se element i çdo programi lëndë është bibliografia e ndarë në literaturë bazë dhe literaturë ndihmëse. Kur këto janë tekste të miratuara mësimore nga Senati Akademik, kopje të tyre u vihen në dispozicion studentëve në Bibliotekën e institucionit. Kur literatura në gjuhën shqipe mungon, pedagogu i lëndës zgjedh tituj në gjuhën angleze që janë autoritet për fushën e studimit dhe që disponohen në fondin e Bibliotekës. Megjithatë, në këtë rast</p>

<p>e studimit.</p> <p><b>Kriteri 5.</b> Biblioteka e institucionit garanton numër të mjaftueshëm botimesh të viteve të fundit, në drejtimet kryesore të programit të studimit dhe hapësira të mjaftueshme dhe komode për përdorim nga studentët gjatë procesit mësimor.</p>	<p>pedagogu përgatit leksionet në gjuhën shqipe bazuar mbi literaturën në gjuhën e huaj dhe ua vë në dispozicion studentëve. Institucioni ka parashikuar një zë në buxhet për të mbuluar shpenzimet e përkthimit të disa teksteve të miratuara për t'u përdorur si tekste mësimore. GVJ nga vizita në institucion vuri re se një vend dhe hapsirë të konsiderueshme zë biblioteka. Biblioteka e institucionit zë një hapësirë prej 258.4 m<sup>2</sup>, ku janë vendosur 48 vende leximi. Orari i punës së Bibliotekës është 8:00-15:00, nga e hëna deri të premten. Fondi i Bibliotekës numëron 1.669 tituj, bazuar edhe në dokumentacionin e DVV dhe referencat mbi bibliotekën e institucionit. Në përputhje me Rregulloren e Brendshme të Administratës, punonjësi i Bibliotekës bën skedën e titujve sipas Standardit Ndërkombëtar të Përshkrimit Bibliografik (ISBD). Gjithashtu për çdo tekst krijohen rekordet bibliografike në katalogun online, i cili aksesohet falas përmes platformës online KOHA. Çdo vit një zë i shpenzimeve i dedikohet pasurimit të fondit të Bibliotekës. Kur literatura në gjuhën shqipe mungon, pedagogu i lëndës zgjedh tituj në gjuhën angleze që janë autoritet për fushën e studimit dhe që disponohen në fondin e Bibliotekës. Në bibliotekë ndodhen aktualisht 3500 kopje nga këta 1740 janë tituj në gjuhë të huaj kryesisht leading books dhe 440 tituj në gjuhën shqipe dhe pritet të shtohet me rreth 98 tituj të rinj të huaj këtë vit akademik. Kjo literaturë është e 5 viteve të fundit dhe studentët kanë mundësi për të mësuar në bibliotekë në mënyrë të pavarur, pasi kjo literaturë si ajo bazë ashtu edhe ajo e rekomanduar gjendet në bibliotekën e UST-së.</p> <p><i>(Lista e teksteve /periodikëve në Bibliotekë (hard copy dhe e-book), të shtuara në vitet e fundit në funksion të programit);</i></p> <p><i>(Rregullore e Brendshme e Administratës, neni 11; Mbi miratimin e propozimit për detajimin e të ardhurave);</i></p> <p><i>(Vendim i Senatit, Nr. 15 datë 01.03.2019);</i></p> <p><i>(Hyrjet e librave ne biblioteke ne 5 vitet e fundit Ref.92)</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Në funksion të mësimdhënies dhe mësimnxënies, personeli akademik dhe studentët aksesojnë libraritë on-line të fushave të ngjashme ose të përafërta me programin e studimit.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se biblioteka e institucionit kishte hapsirën dhe larmin e shumtë të botimeve Në kuadër të Paktit për Universitetin, studentë dhe pedagogë kanë akses falas në Bibliotekën online U-library. Ashtu sic u përmend edhe në kriterin 4, 5, Institucioni merr masa për informimin dhe trajnimin e studentëve dhe pedagogëve për përdorimin e kësaj biblioteke elektronike. Biblioteka e institucionit sic u përmend dhe në rubrikat e tjera ka një hapësirë prej 258.4 m<sup>2</sup> ku janë vendosur 48 vende leximi. Orari i punës së Bibliotekës është 8:00-15:00, nga e hëna - premten. Siç parashikohet në Rregulloren e Brendshme të Administratës, punonjësi i</p>


	<p>Bibliotekës përpilon skedën e titujve sipas Standardit Ndërkombëtar të Përshkrimit Bibliografik (ISBD). Në bibliotekë ndodhen aktualisht 3500 kopje nga këta 1740 janë tituj në gjuhë të huaj kryesisht leading books dhe 440 tituj në gjuhën shqipe dhe pritjet të shtohet me rreth 98 tituj të rinj të huaj këtë vit akademik. Ndër objektivat e fakultetit për vitin 2020-2022 është abonimi në bibliotekën online Pubmed, që të jetë e aksesueshme nga personeli akademik dhe studentë. Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit. Në kuadër të Paktit për Universitetin, studentë dhe pedagogë kanë akses falas në Bibliotekë, ku gjendet një fond i gjerë titujsh e periodikësh shkencorë nga paketat e poshtë renditura:</p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1)Academic Search Complete: databaza kryesore e revistave/periodikeve/librave/etj të dedikuar vetem për arsimin e lartë dhe kërkimin;</li> <li>2)Business Source Complete;</li> <li>3)Regional Business Neës Plus;</li> <li>4)Neëspaper Source Plus;</li> <li>5)MasterFILE Complete;</li> <li>6)Health Source: Academic &amp; Nursing Edition;</li> <li>7)Health Source: Consumer Edition;</li> <li>8)ERIC;</li> <li>9)MEDLINE;</li> <li>10)Rosetta Stone Library Solution Plus;</li> <li>11)eBook Academic Collection;</li> <li>12)EBSCO Discovery Service (EDS) (ëithout OPAC);</li> </ol>
<p><b>Kriteri 7. Infrastruktura laboratorike e nevojshme për realizimin e laboratorëve, detyrave të kursit, diplomave dhe studimeve specifike shfrytëzohet në mënyrë të vazhdueshme nga studentët.</b></p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion se në dispozicion të studentëve kishte 8 laborator me paisje të ndryshme që mund të shfrytëzohen nga studentët për bërjen e detyrave të kursit. Kështu që mund të themi se studentët kanë hapësirën e nevojshme didaktike për përmbushjen e detyrimeve të tyre akademike. Ambientet e Bibliotekës janë të pajisura me PC të lidhur me Internet që mund të shfrytëzohet nga studentët për bërjen e detyrave të kursit. Po kështu, palestra e fitnesit, në orare të caktuara gjatë ditës është e aksesueshme nga studentët me praninë e personelit akademik dhe ndihmës mësimesor. Po kështu janë vënë në dispozicion të studentëve infrastruktura si: laborator i biomekanikës, izokinetik, psikologjisë, anatomisë humane, fiziologjisë së ushtrimit, biokimikës dhe gjenetikës, laborator i informatikës dhe linguistikës, laborator i vlerësimit motorik dhe kordinative, laborator i antropometrisë humane, laborator i fizioterapisë i, ii dhe terapisë sportive, laborator</p>

	<p>rehabilitimi sportiv, laborator i vlerësimit postural, laborator i traumatologjisë dhe ndihmës së parë, laborator i endrokrinologjisë, laborator i informatikës dhe i linguistikës, të cilët përdoren nga stafi akademik dhe studentët për procesin mësimor dhe kërkimin shkencor, për detyra kursi, etj.</p> <p><i>(Shkresë Drejtoria e Financës dhe e Buxhetit UST, Nr.Prot. 1584, dt. 06.11.2018 mbështetur në Shkresën e Rektoratit UST, Nr. Prot. 1533, dt. 30.10.2018 për Inventarin e Ndarjes së Laboratorëve Ref.51)</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line (e-learning) dhe mbështet dhe nxit personelin akademik e studentët për përdorimin e tyre.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion dhe takimi me stafin akademik, studentët konstatoi se në funksion të mësimdhënies, personeli akademik përdor platforma on-line si Research Gate në mbështetje të veprimtarisë së tyre në mësimdhënie dhe punës kërkimore-shkencore. Sallat e leksioneve janë të pajisura me kompjuter dhe videoprojektor si edhe perde për reflektimin e qartë të imazheve, të cilat përdoren në platformat on-line (e-learning) nga pedagogët dhe studentët. Stafi akademik dhe studentët e UST, kanë akses pa limit interneti dhe mundësi përdorimi të sistemit informatik të Bibliotekës, duke lundruar online për të lexuar dhe studiuar nga libraritë online. (<a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a>. PC-të e të gjithë institucionit janë të lidhur mes tyre përmes rrjetit LAN, që mund të përdoret për komunikim të brendshëm institucional. Po kështu nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit ESS3 që siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë personelin akademik dhe studentët, ku përveç vendosjes së frekuentimit të lëndëve, lektori pas zhvillimit të provimit paraqet rezultatet e studentëve, ku nota e provimit të studentëve paraqitet jo vetëm online, por ky rezultat i komunikohet direkt nëpërmjet emailit personal të studentëve. <i>(Konstatim i bërë gjatë takimit me pedagogët e programit)</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Personeli akademik dhe studentët shfrytëzojnë sistemet e komunikimit të brendshëm për akses në dokumentacionin elektronik dhe hapësirën vetjake të dedikuar.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me pedagogët e programit konstatoi se, cdo anëtar i personelit akademik efektiv është i pajisur me PC sic u përmend edhe në kriterin 8. PC-të e të gjithë institucionit janë të lidhur mes tyre përmes rrjetit LAN, që mund të përdoret për komunikim të brendshëm mes punonjësve të institucionit. Gjithashtu edhe PC-të në mjediset e Bibliotekës janë të lidhur në rrjetin LAN, që mund të shfrytëzohet nga pedagogët si mjet komunikimi me studentët, si p.sh. vënia në dispozicion e materialeve didaktike (leksioneve). Adresa e email-it @ust.edu.al është një tjetër mënyrë për komunikimin zyrtar të brendshëm mes punonjësve të institucionit. Gjithashtu GVJ konstatoi se gjithë ky rrjet bashkëpunimi dhe komunikimi ishte i shprehur qartë në <i>(Vendim Senati Nr.38, dt. 09.10.2017 “Mbi një ndryshim në Rregulloren e UST Ref.60); (Udhëzues për përdorimin e</i></p>

	<i>teknologjisë Ref.23).</i>			
	Nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit ESS3 që siguron akses në informacione e dokumente për të gjithë personelin akademik dhe studentët, ku përveç vendosjes së frekuentimit të lëndëve, lektori pas zhvillimit të provimit paraqet rezultatet e studentëve, ku nota e provimit të studentëve paraqitet jo vetëm online, por ky rezultat i komunikohet direkt nëpërmjet emailit personal të studentëve.			
<b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik orienton studentët në përzgjedhjen e temave të diplomave (në rastet kur ato zhvillohen), asiston dhe mbështet në zhvillimin e tyre.	GVJ niur nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga institucioni ( <i>Rregullorja e UST</i> ) si dhe takimi me drejtuesit e institucionit ( <i>dekan, drejtues departamenti</i> ), u konstatua se studentët e programit që plotësojnë kriteret e përcaktuara në Rregulloren e institucionit për mbrojtjen e diplomës, kanë të drejtë të zgjedhin temë diplome për të shlyer detyrimet përmblylëse të studimeve. Procesi i diplomimit është i rregulluar përmes Rregullores së Institucionit dhe Rregullores së Diplomimit. Zyra e këshillimit të karrierës u siguron asistencën e nevojshme studentëve gjatë procesit deri në përzgjedhjen e udhëheqësit. Pas përzgjedhjes së udhëheqësit ai është përgjegjës për cilësinë e punimit si dhe plagjatura etj. Temat afishohen në vende të dukshme në ambientet e institucionit, po kështu dhe emrat e pedagogëve udhëheqës, student zgjedh temën dhe pedagogun udhëheqës. Me zgjedhjen e temës dhe udhëheqësit, përgjegjësia ligjore për asistimin në fund të procesit i kalon udhëheqësit. Gjithë ky process shprehet qartë në DVV të vëna në dispozicion GVJ si ( <i>Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 62, 63; Ref. Nr. 5</i> ) si dhe ( <i>Rregullore e diplomimit</i> )			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi III.4</b>	
<b>Institucioni ngre struktura të posaçme në nivel institucional, të cilat promovojnë rritjen e vetëdijes për përmirësimin e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies në programet e studimit.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni organizon struktura/njësi në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me	Nga takimi me anëtarët e NJSBC GVJ konstatoi, se NJSCB është një strukturë autonome në përbërjen e institucionit bazuar kjo edhe në ( <i>Rregullore e NJSBC, UST Ref.6</i> ). Po kështu institucioni organizon struktura në nivel institucional që promovojnë përmirësimin e vazhdueshëm të mësimdhënies, koordinojnë dhe bashkërendojnë me njësitë kryesore. Me ( <i>Vendim Senati Akademik me nr.16, datë, 27.02.2018</i> ) është

<p>njësiti kryesore/bazë aktivitetet në kuadër të përmirësimit të cilësisë së mësimdhënies.</p>	<p>ngritur NJBSC dhe miratuar nga Bordi i Administrit me (Vendim nr. 9, date, 02.03.2018 "Ngritja dhe funksionimi i Njësise së Sigurimit të Brëndshëm të Cilësisë në UST" Ref. 15). Njësia e Sigurimit të Cilësisë së FSHL-së përbëhet nga pesë anëtarë ku një prej anëtarëve është student, me Vendim Dekanati Nr. 7, dt. 16.01.2017. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së UST-së ka për qëllim të garantojë zbatimin e procedurave të aprovuara nga organet drejtuese nëpërmjet kontrollit dhe vlerësimit të procesit mësimor në aspektin e mësimdhënies.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Njësia kryesore/bazë është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies dhe rritjes së vetëdijes te personeli akademik dhe studentët për cilësinë në programet e studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstatoi se Departamenti është përgjegjës për cilësinë e mësimdhënies në programet e studimit që ai ofron, bazuar në legjislacionin në fuqi si dhe (Rregullore e Universitetit të Sporteve). Departamenti përcakton cdo fillim viti akademik nevojat për personel akademik definitive dhe me kohë të pjesëshme, përcakton kriteret, po kështu përzgjedh personelin akademik që angazhohet në mësimdhënie, si edhe garanton shpërndarjen e ngarkesës mësimore. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion për shpërndarjen e ngarkesës mësimore u konstatua shpërndarja e ngarkesës ishte korrekt dhe të gjithë pedagogët plotësonin ngarkesën mësimore sipas legjislacionit në fuqi, Udhëzimit të Ministrisë së Arsimit Nr. 29, datë 10.09.2018, mbi ngarkesën mësimore të pedagogëve, referuar dhe të dhënave tabelore për ngarkesën e PAE Gjithashtu drejtuesi i departamentit ndjek hartimin e programeve mësimore sipas (Rregullores së UST, Neni 20, pika 4 Ref. 5) si dhe (Statut i UST, Neni 21 Ref. 2). Në bashkërendim me zëvendësekanin, drejtuesi i departamentit si koordinator i programit ndjek zhvillimin e orëve të mësimi nga personeli akademik, si edhe inkurajon studentët të raportojnë për problemet që mund të jenë evidentuar, duke ruajtur anonimat.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Strukturat dhe njësiti përgjegjëse mbështesin eksperimentimin dhe zhvillimin e metodave të reja inovative të mësimdhënies.</p>	<p>GVJ konstatoi se personelit akademik i kërkohet të shfrytëzojë maksimalisht metodat e reja inovative në procesin e mësimdhënies. Është detyrim për stafin akademik që orët e leksionit t'i zhvillojë duke përdorur metodat interaktive të mësimdhënies. Metodatat mësimore dhe format e organizimit të orëve mësimore synojnë të zhvillojnë me efektivitet aspekte të ndryshme të të nxënies si: të nxënies përmes vrojtimit; imitimit; përmes praktikës; bashkëbisedimit; shpjegimit të menduarit ;kritik krijues dhe konkurrencës. Ky konstatim erdhi nga takimi me strukturat drejtuese të institucionit referuar (Plani Strategjik FSHL, pika 3, 4 Ref. 4)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik dhe ai mbështetës</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe drejtuesit e institucionit se institucioni e ka në vëmendje të vazhdueshme</p>





kualifikohen në mënyrë të vazhdueshme në fushën e kërkimit shkencor për të ndihmuar përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies.

**Kriteri 5.** Strukturat dhe njësitë përgjegjëse trajnojnë vazhdimisht personelin akademik për përmirësimin e aftësive të mësimdhënies dhe implementimit të metodave të reja.

**Kriteri 6.** Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve

mbështetjen e stafit në fushën e kërkimit shkencor. Përveç takimeve trajnuese, tashmë është në praktikën e institucionit organizimi i konferencave shkencore ndërkombëtare në rang universiteti dhe në rang njësie kryesore që ofron programin e studimit. Po kështu, Instituti i Kërkimit Shkencor të Sportit organizon konferenca shkencore kombëtare/ndërkombëtare. GVJ konstatoi se ka një angazhim domethënës nga ana e stafit në drejtim të kërkimit shkencor. Në të gjitha këto organizhime stafi akademik efektiv merr pjesë pa asnjë lloj detyrimi financiar. Gjatë vizitës GVJ ju vu në dispozicion dhe ju bë me dije edhe botimet vjetore të Revistës së Universitetit, ku pasqyroheshin punimet shkencore të stafit akademik. Revista është me ISBN dhe me bord drejtues shkencor. GVJ mbështetur edhe në DVV konstatoi se senati me vendimet e tij mbështet aktivitetin shkencor. konstatim i bërë edhe në referencën, (*Vendim Senati Nr. 25, dt. 17.05.2019 mbi "Miratimin e Projekteve Kërkimore Shkencore" Ref. 36*) (Apendix. Tabela 19).

GVJ konstatoi një sërë marrveshje të Bashkëpunimit të institucionit me institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit. Personelit akademik i jepet mundësia të përmirësojë aftësitë e tij në mësimdhënie, kryesisht përmes periudhave të shkëmbimit të eksperiencës në universitete partnere, në kuadër të programeve Erasmus+, si edhe përmes lektorëve të ftuar në kuadër të veprimtarive kualifikuese për stafin. Personeli akademik është përgjegjës për zbatimin e programit të studimit dhe përmirësimin e mësimdhënies. Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik janë përgjegjës për zbatimin e programeve të studimeve. Përgjegjësia fillon që me hartimin e programit të lëndës/sillabusit, duke përfshirë edhe metodat e mësimdhënies të parashikuara për secilën temë. Personeli akademik është përgjegjës për përzgjedhjen e metodave të reja të mësimdhënies. Ndihmësit mësimorë mund të asistojnë pjesëtarë të stafit akademik, kur këta të fundit kanë vështirësi në adoptimin e zhvillimeve teknologjike. Kjo vërehet edhe në marrëdhëniet e bashkëpunimit që ka institucioni me partnerë kombëtarë e ndërkombëtarë për përmirësimin e mësimdhënies. Një nga objektivat strategjike të zhvillimit të UST-së është matja e treguesve të performancës së personelit akademik, zhvillimi i një analize të veprimtarisë së personelit akademik, duke filluar nga njësisia bazë, me analiza të detajuara e konkrete deri tek analizat në nivele të asamblesë së personelit e shprehur në (*Raportin e fundit periodik analitik të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve*).

<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik dhe personeli ndihmës akademik testojnë metoda të reja në mësimdhënie, analizojnë efektet e pritshmëritë dhe raportojnë në mënyrë periodike për rezultatet në strukturat dhe njësitë përgjegjëse.</p>	<p>Gjatë takimit me pedagogët GVJ konstatoi se personelit akademik i garantohet ushtrimi i lirisë akademike në drejtim të testimit të metodave të reja në funksion të mësimdhënies. Për shkak se programi i lëndës është subjekt rishikimi i përvitshëm, duke ju përmbajtur udhëzimeve të ardhura nga Ministria e Arsimit, ndryshim jo më shumë se 20%, është e mundur që të reflektohen përshtatjet dhe ndryshimet e nevojshme, në përputhje me rezultatet e testimit të metodave të reja gjatë procesit të mësimdhënies. GVJ e konstatoi këtë edhe në vëzhgimin e vendimeve për ndryshimet në planin mësimor. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion GVJ konstatoi se diskutimet në mbledhjet e departamentit shfrytëzohen si hapësirë për raportuar rezultatet e një metode të caktuar, me synim që kjo eksperiencë pozitive të ndahet me kolegët dhe të shfrytëzohet edhe prej tyre. Konstatim i bërë gjatë takimit me pedagogët e programit dhe me përgjegjësin e departamentit, si dhe <i>(Planin Strategjik i Zhvillimit UST, pika 3.5 Ref.3)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>0</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>


<p><b>Standardi III.5</b></p>	
<p><b>Institucioni harton rregullore dhe procedura të posaçme të testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale dhe garanton zbatimin e tyre.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Kriteret dhe mënyra e testimit e vlerësimit të njohurive dijeve dhe aftësive profesionale, përcaktohen në rregullore të posaçme, bëhen publike dhe njihen nga studentët.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni disponon Rregulloren për modalitetin e vlerësimit të studentëve. Procesi i vlerësimit përfshin një shumatorë të vlerësimit të vazhdueshëm dhe atij përfundimtar. Pësha specifike e komponentëve të vlerësimit është e përcaktuar qartë në Rregulloren e institucionit. <i>(Vendim Senati Nr. 38, dt. 09.10.2017 mbi Një ndryshim në Rregulloren e UST, Neni 51 Ref. 60 )</i>. GVJ konstatoi se elementet dhe mënyra e vlerësimit pasqyrohen në formatin e programit të lëndës/syllabusit. Studentët mund të përfitojnë edhe nga asistenca e ofruar nga koordinatori i programit dhe Zyra e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve. Format e kontrollit të dijeve realizohen nëpërmjet testeve të ndërmjetme, testeve përfundimtare si me shkrim ashtu edhe testimet praktik në sezonin përkatës të provimeve.</p> <p>Bazuar në Tabelën e sjellë nga UST rezultojnë se:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive: <span style="float: right;">10 %</span></li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Plotësimi i detyrimeve (laboratorëve, detyrat e kursit) 10 %</li> <li>- Provimi i ndërmjetëm 40 %</li> <li>- Provimi përfundimtar 40 %</li> </ul> <p>Kur studenti mungon në testimet e ndërmjetme ai vlerësohet me 0 (zero) pikë, por ruan të drejtën të vazhdojë të frekuentojë modulin/lëndën deri në përfundim të tij. Provimet e ndërmjetme zhvillohen gjatë semestrit, ndërsa provimi përfundimtar zhvillohet në sezonin e provimit. Provimet dhe riprovimet zhvillohen në 3 sezone: sezoni i dimrit; sezoni i verës; sezoni i vjeshtës, provime të mbartura, dhe data të posacme, të cilat administrohen nga titullari i lëndës/modulit dhe një anëtar tjetër në rolin e asistuesit. GVJ e konstatoi këtë edhe në Rregulloren e Universitetit të Sporteve, neni 50, 61; po ashtu dhe gjatë takimit me studentët e programit.</p>								
<p><b>Kriteri 2.</b> Në fillim të çdo lëndë/moduli studentët informohen me metodologjinë e testimit e vlerësimit të njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore të parashikuara në syllabuset e lëndëve/moduleve nga titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstatoi se është praktike pune e rregullt që pedagogu i lëndës të informojë studentët për elementet e programit të lëndës (syllabusin) në orën e parë të seminarit. Po ashtu në Syllabusin e çdo lëndë/moduli pasqyrohen detyrimet e studentit dhe vlerësimi i studentit .U vë në dispozicion studentëve edhe programet në format hard copy ose komunikon me ta përmes platformës ESSE3. (Rregullore UST, Neni 61, pika 8Ref. 5 ); (Apendix Tabela 15, 15/1, 15/2)</p>								
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale e shkencore realizohet në forma dhe mënyra të ndryshme, duke i dhënë mundësi studentit të demonstrojë njohuritë dhe kompetencat e fituara.</p>	<p>GVJ konstatoi nga takimi me stafin dhe me studentët si dhe nga dokumentacionet e vëna në dispozicion se, testimi dhe vlerësimi i njohurive të studentëve për shkak të specifikave të programit, për lëndët që përfshijnë orë praktike rregullorja parashikon testimin me shkrim dhe testimin praktik. Pësha e të dy vlerësimeve në përqindje është po kështu e parashikuar në Rregullore. Pësha e të dy vlerësimeve në përqindje është po kështu e parashikuar në Rregullore.(65% të pikëve provimi praktik dhe 35% të pikëve provimi teorik), studenti është kalues kur merr 45% të pikëve. Pësha e vlerësimit përfundimtar shprehur dhe në syllabus është tregues në një shkallë më të plotë i njohurive dhe kompetencave të fituara (Rregullore UST, Neni 61, 50 Pika 1,2,3; Neni 52 pika 1Ref. 5); (Apendix Tabela 15, 15/1, 15/2) si dhe 9Model Syllabet Ref. 10) .</p>								
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1" style="width: 100%; text-align: center;"> <thead> <tr> <th style="background-color: #cccccc;">Niveli i përmbushjes</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet pjesërisht</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet kryesisht</th> <th style="background-color: #cccccc;">Përmbushet plotësisht</th> </tr> </thead> <tbody> <tr> <td></td> <td></td> <td></td> <td><b>X</b></td> </tr> </tbody> </table>	Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht				<b>X</b>
Niveli i përmbushjes	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht						
			<b>X</b>						

**Standardi III.6****Institucioni garanton vlerësim të drejtë dhe transparent, bazuar në meritën e çdo studenti..**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet gjatë gjithë vitit akademik.</p> <p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në zbatim sisteme elektronike të testimit dhe vlerësimit të cilat eliminojnë forma të ndryshme abuzimi dhe rrisin transparencën.</p>	<p>GVJ në takimin me stafin dhe me studentët konstatoi se vlerësimi i përgatitjes akademike të studentit mbështetet në parimin e kontrollit të vazhdueshëm përgjatë semestrit gjë e cila është e shprehur dhe në programet mësimore, në rregulloren e provimeve si dhe në syllabuse sipas lëndëve. Vlerësimi përfundimtar është rezultat i vlerësimeve të vazhdueshme, të ponderuara sipas peshës specifike që zënë në totalin e vlerësimit. Specifikat e programit të studimit të ndërtuar mbi lëndë teorike dhe praktike në raportin <b>60 /40 (%)</b>, lënë pak vend për sisteme elektronike të testimit. Për shmangien e abuzimeve, njësia kryesore dhe njësia bazë përgjegjëse për programin e studimit merr masa të monitorojë procesin e testimit dhe të rritë transparencën. Publikimi i rezultateve të vlerësimit në platformën ESSE3 dhe transmetimi i tyre në kohë reale te studentët është një aspekt që i kontribuon transparencës.</p> <p><i>(Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 61, pika 7 (Ref. Nr. 5);</i> <i>(Apendix Tabela 15, 15/1, 15/2);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Testimi e vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale realizohet nga komisionet e provimeve me së paku 2 anëtarë ku njëri prej tyre është titullari i lëndës/modulit.</p>	<p>GVJ konstatoi nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga sekretaria mësimore ose modele të tezave, se procedura e ndjekur për procesin e provimit është në përputhje të plotë me udhëzimet ligjore në fuqi. Procesi i provimit administrohet nga komisioni i provimit i përbërë nga së paku 2 pedagogë, i kryesuar nga titullari i lëndës. Ky komision është përgjegjës për zhvillimin korrekt të provimit që nga dhënia e tezës deri në përfundim të tij, hedhjen e të dhënave në system dhe printimi përfundimtar i procesverbalit, dorëzimi i firmosur nga komisioni dhe mbyllja e procesit. Ky konstatim u bë dhe në DVV të vëna në dispozicion.</p> <p><i>(Rregullore UST, Neni 54, pika 2Ref.5);</i> <i>(Komisionet e Provimeve(Ref. 28 );</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Testimi i vlerësimit i njohurive, dijeve me shkrim, zhvillohet në mënyrë anonime me sekretim ose kodifikim dhe institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi.</p>	<p>GVJ në takimin me stafin dhe drejtuesit e departamentit konstatoi se për shmangien e abuzimeve, Rregullorja e institucionit parashikon që testimet me shkrim të bëhen në fletë të sekretuara. Departamenti përgjegjës për programin e studimit merr masa për realizimin e procesit të sekretimit. Po kështu institucioni siguron infrastrukturë të posaçme të monitoruar me personel dhe mjete survejimi ne cdo auditor.</p> <p><i>(Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 54, pika 6; Ref. Nr. 5)</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Vlerësimi i</p>	<p>Në takimin me studentët dhe stafin, GVJ u informua se</p>



<p>njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet me komente/feedback, i cili, nëse është i nevojshëm, lidhet dhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen.</p>	<p>vlerësimi i njohurive, dijeve dhe aftësive profesionale shoqërohet merr feedback pozitiv, pasi lidhet edhe me këshilla mbi procesin e të nxënit për të ndihmuar studentin të përmirësohet në të ardhmen. Pas marrjes në dorëzim dhe shqyrtimit të detyrave të kursit nga pedagogu i lëndës, ky i fundit vlerëson punimin sipas një sistemi pikëzimi, shoqëruar edhe me komentet përkatëse për t'i evidentuar studentit pikat e dobëta dhe si mund t'i përmirësojë ato. Studenti ka mundësi të njihet me vlerësimin e pedagogut, ashtu si edhe me komentet shoqëruese. Kur paraqitja e detyrave të kursit bëhet në formën e prezantimeve orale, pedagogu mban shënime gjatë prezantimit në regjistrin e tij personal dhe ia bën të ditura ato studentit në fund të prezantimit, përfshirë këtu edhe vlerësimin me pikë. Ngjashëm edhe korrigjimi i tezave me shkrim përmban shenjime të dukshme të përgjigjeve të sakta dhe përgjigjeve të gabuara, shoqëruar me vlerësimin përkatës. Studenti edhe në këtë rast ka mundësi të njihet me vlerësimin e pedagogut. Mënyra e të vlerësuarit është e paraqitur dhe në plan programin e studimit si dhe në syllabuset përkatëse</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët e programit (Rregullore e UST, Neni 61, pika 10Ref. 5); (Vendim Senati Nr. 38, dt. 09.10.2017 "Mbi një ndryshim në Rregulloren e UST", Ref. 60).</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Njësitë përgjegjëse dhe personeli akademik shmangin plagjiaturën, kopjimi në provime dhe detyra nuk tolerohen nga personeli akademik.</p>	<p>GVJ në takimin me stafin akademik dhe drejtuesit e institucionit mori informacion se mbarëvajtja e provimit mbikëqyret nga komisioni i provimit dhe nga personeli ndihmës mësimor i departamentit përgjegjës për programin ose nga një departament tjetër. Në auditor nuk lejohet prania e personave të tjerë të paautorizuar. Telefonat celularë duhet të jenë të fikur dhe nuk lejohet përdorimi i tyre për asnjë lloj qëllimi. Kopjimi, komunikimi me studentë të tjerë ndëshkohet me përjashtim nga provimi dhe me vlerësimin si mbetës. Për shmangien e plagjiaturës, pedagogu i lëndës pasi merr në dorëzim esetë/detyrat e kursit edhe në formë elektronike mund të shfrytëzojë sistemet antiplagjiaturë që ofrohet pa pagesë në institucion. Rregullorja e provimeve jep detaje për këtë kriter. <i>(Rregullore e UST, Neni 61, pika 11Ref.5) .</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Rezultatet e kontrollit të dijeve dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën dhe jepen në kohë sipas përcaktimeve në rregulloret përkatëse.</p>	<p>GVJ në takimin me studentët mori informacion jo vetëm për mësimdhënien por dhe mbi procesin e vlerësimit të tyre. Studentët deklaruan se rezultatet e kontrollit të dijeve të tyre dhe aftësive profesionale bazohen mbi meritën e studentëve. Sipas pedagogëve vlerësimi i studentit bëhet me pike të cilat shënohen në fletën e provimit. Pikët ekuivalentohen me notë. Provimi ka vlerësimin në vazhdim 20% (10% ndjekja e lëndës dhe pjesëmarrja aktive + 10% plotësimi i detyrimeve (laboratorëve,</p>


	<p>detyrat e kursit) Provimi i ndërmjetëm 40 % dhe provimi përfundimtar 40%, ky raport ndryshon nga lënda, pasi duhet të përfshihet edhe vlerësimi praktik. Pikët maksimale janë 100 pikë dhe pikët minimale kaluese janë 45 pikë. Dorëzimi i vlerësimeve të provimeve bëhet brenda afateve të përcaktuara në rregullore, ku parashikohen qartë edhe afatet për shqyrtim të vlerësimit nga ana e studentit dhe reklamimit të pakënaqësive në lidhje me të.</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit;</i>  <i>(Ref. Nr. 5.1, Një ndryshim në Rregulloren e Universitetit të Sporteve, Neni 50/1, pika 3)</i></p>				
<p><b>Kriteri 8.</b> Institucioni garanton të drejtat e studentëve për t'u njohur me vlerësimin, kërkesën për rishikim të vlerësimit në përputhje me rregulloret dhe procedurat e vlerësimit.</p>	<p>GVJ nga vizita dhe takimet në institucion konstatoi se institucioni garanton të drejtat e studentëve. Platforma online ESSE3 i mundëson studentit të informohet në kohë reale për rezultatet e vlerësimit. Pas kësaj, studenti ka të drejtën që brenda afatit të përcaktuar në rregullore (48 orë nga komunikimi i rezultatit) të sqarojë çdo paqartësi ose pretendim të mundshëm që ka lidhur me vlerësimin. Pas këtij afati, printohet “Pasqyra e rezultateve”, firmoset nga komisioni i provimit dhe dorëzohet në Sekretarinë Mësimore, dhe kështu përmbyllet procesi i vlerësimit.</p> <p><i>(Rregullore e UST Neni 57, Pika 1,2 Ref.5).</i></p>				
<p><b>Kriteri 9.</b> Çdo kërkesë, ankimim, shqyrtohet nga komisioni i vlerësimit dhe më pas nga komisioni i posaçëm. Procedura e ndjekur dokumentohet dhe arkivohet.</p>	<p>GVJ nga takimi me studentët e këtij program mori një informacion të detajuar mbi procedurën e provimit, vlerësimit, ankimimit dhe rezultatit përfundimtar. Rruga që ndiqet është e sqaruar qartë në rregulloren e institucionit. Studenti pasi ka konsumuar procedurën e sqarimit me pedagogun e lëndës, rregullorja e institucionit parashikon që studenti të përpilojë një ankesë me shkrim në lidhje me vlerësimin, dhe ia paraqet atë drejtuesit të departamentit. Kur drejtuesi i departamentit, në bashkëveprim me komisionin e vlerësimit, e ka të pamundur të zgjidhë ankesën, vë në dijeni dekanin. Pasi ngre komisionin ad-hoc për verifikimin, ky komision vendos për dhënien e një vlerësimi përfundimtar, apo për rizhvillim të provimit. Procesverbalet e vlerësimit firmosen dhe dorëzohen në Sekretarinë Mësimore. Një kopje e praktikës ruhet në arkivën e Dekanatit.</p> <p><i>(Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 57, neni 61, pika 12 g, h, I, Ref. Nr. 5.)</i></p>				
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<table border="1"> <tr> <td data-bbox="555 1890 735 1982">Niveli përmbushet</td> <td data-bbox="735 1890 954 1982">Përmbushet pjesërisht</td> <td data-bbox="954 1890 1173 1982">Përmbushet kryesisht</td> <td data-bbox="1173 1890 1394 1982">Përmbushet plotësisht</td> </tr> </table>	Niveli përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
Niveli përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht		

**Standardi III.7**

**Zhvillimi i programit të studimit garanton rritjen e aftësive krijuese e zbatuese te studentët, duke dhënë njëkohësisht njohuritë e nevojshme dhe kompetencat e duhura profesionale e shkencore.**


Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Programi i studimit zhvillohet në mënyrë të tillë që të garantojë thellimin e njohurive, zhvillon aftësitë profesionale dhe të veçanta të studentëve.</p>	<p>GVJ në konsulencë me dokumentacionin e vendosur në dispozicion konstatoi se programi i studimit është ndërtuar mbi logjikën e ndërthurjes së koncepteve teorike bazë të nevojshme për fushën e studimit, njohuri të karakterit të formimit të përgjithshëm dhe koncepteve praktike të aftësive profesionale të veçanta për specialistët e fushës. Kombinimi i këtyre rubrikave në programin mësimor janë të detajuara edhe në syllabuset e lëndëve.</p> <p><i>(Model Suplementi Diplome Bachelor, pika 4 Ref. 8);</i></p> <p><i>(Plan Mësimor i programit të studimit Bachelor Ref. 35)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Programi i studimit garanton zhvillimin e aftësive të veçanta në fushën e teknologjisë së informacionit, humane sociale, komunikimit dhe ndërveprimit (përfshirë edhe në gjuhë të huaj).</p>	<p>GVJ nga konsulencia me planet mësimore, strategjinë dhe objektivat e institucionit konstatoi se krahas drejtimit madhor akademik, programi i studimit jep mundësinë e një formimi në fusha të veçanta të karakterit social-human, të komunikimit e ndërveprimit. Konstatohet se pjesë e kurrikulës së programit të studimit janë lëndë si: Shkenca Sociale në Aktivitet Fizik, Sport; Gjuhë e Huaj-Anglisht; Statistikë e Aplikuar; dhe Menaxhim-Biznesi. Informacioni për programet e studimit i ofrohet studentëve në formë të shkruar dhe elektronike dhe është i publikuar në faqen zyrtare të internetit të UST. Programi është hartuar duke mbajtur dhe mbështetur në përvojën e programeve evropiane në këtë fushë.</p> <p><i>(Plan Mësimor i programit të studimit Bachelor, Ref. 35)</i></p> <p><i>(Apendiks, tabela 9)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti, të paraqitura në programin e studimit dhe syllabuset e çdo lënde, analizohen e shqyrtohen në përfundim të çdo lënde.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit GVJ mori informacion se, në seminarin e fundit pedagogu bën përmbledhje të koncepteve dhe çështjeve kryesore të zhvilluara, dhe përmes një diskutimi të hapur me studentët merr mendimin e tyre për çfarë mund të përmirësohet në vijim. Esetë/detyrat e kursit janë një tjetër feedback për analizë të mëtejshme nga pedagogu në lidhje me arritjen e</p>

	<p>rezultateve të pritshme të mësimnxënies. Në syllabuset e çdo lënde/moduli përshkruhen përveç të tjerave edhe kompetencat dhe aftësitë që fiton studenti në përfundim të çdo lënde/moduli.</p> <p><i>Konstatim i bërë ky edhe gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik vë në pah çështjet më të rëndësishme dhe orienton studentët për implementimin e tyre.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit u informua se në përfundim të çdo lënde/moduli, personeli akademik thekson çështjet më të rëndësishme si një orientim për provimin përfundimtar, por edhe si lidhen ato me konceptet që do të përthithë studenti në vijim të studimeve. Pedagogu mund të ndalet më gjatë në elementet që kanë rezultuar më të vështirë për t'u përvetësuar nga studentët gjatë semestrit. Gjithashtu pedagogu është në dispozicion të studentëve për konsultime përpara provimit edhe gjatë orëve të takimit zyrtar, sipas grafikut të shpallur në fillim të semestrit dhe të afishuara në vende të dukshme në institucion.</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Personeli akademik realizon orë të hapura dhe seminare mbi zhvillime të reja të shkencës dhe teknologjisë jashtë strukturës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni dhe njësi kryesore që ofron programin e studimit zhvillojnë vazhdimisht leksione të hapura, ku ftohen ekspertë e personalitete të fushave për të ndarë me personelin akademik dhe studentët zhvillimet e fundit në fushën e tyre të eksperitizës; çështje të aktualitetit; dhe zhvillimeve të reja në fushën e shkencës dhe teknologjisë. Këto takime zhvillohen si aktivitete ekstra kurrikulare, të hapura për t'u ndjekur nga të gjithë studentët e interesuar dhe personeli akademik. Njoftimi dhe ftesa për të marrë pjesë vendoset në një ambient të dukshëm të institucionit, referuar dhe kalendarit të aktiviteteve</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit</i></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Mësimdhënia realizohet mbi bazë kompetencash që t'u japë studentëve mundësi të zhvillojnë njohuritë e marra në laboratorë dhe praktikat profesionale.</p>	<p>GVJ duke analizuar DVV, konstatoi se në programin mësimor krahas pjesës teorike (leksione, seminare, detyra kursi) ka të përfshirë edhe orë laboratorit si dhe orë praktike. Nisur nga lloji i programit dhe profesioni që marrin në fund të diplomimit studentët, orët e laboratorit dhe të praktikave profesionale zënë një peshë të mirë në programin e studimit. Orët e leksionit japin informacionin teorik për temat përkatëse, në orën e seminarit zhvillohen si hapësira didaktike mbi bazën kompetencash ku studenti bën ndërthurjen midis orëve të leksionit dhe atyre të kaluara në</p>






	<p>laborator ose në praktikat profesionale. Detyrat që pedagogu u cakton studentëve gjatë orës së seminarit janë forma të mësimdhënies që reflektojnë kompetenca. Këtë mundësi për të lidhur ngushtë teorinë me laboratorin dhe praktikën këta student e realizojnë falë edhe infrastrukturës që ofron institucioni si, palestra, laboratore të shumta që ka ky institucion.</p> <p><i>GVJ sygjeron që praktika profesionale të zërë një peshë më të madhe në program, falë specifikave të kësaj diplome.</i></p> <p><i>(Plan Mësimor i programit të studimit Bachelor, Ref. 35),</i></p> <p><i>(Apendiks, tabela 9)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Personeli akademik mbështet diskutimet dhe punën në grup në interpretimin dhe zgjidhjen e problematikave/çështjeve të caktuara.</p>	<p>Gjatë takimit me studentët e programit dhe pedagogët, GVJ vuri re se, në çdo element të procesit mësimor personeli akademik synon ndërveprimin e studentëve. Gjatë orëve të leksionit, pedagogu sigurohet që studentët të ndihen të lirshëm të diskutojnë për çështjet që trajtohen, madje edhe të shprehin mendimin e tyre kur është e nevojshme. Orët e seminareve konceptohen e zhvillohen si orë diskutimesh, interaktive e pune në grup, ku studentët angazhohen të analizojnë raste specifike e të parashirojnë zgjidhjen e tyre. Gjatë takimit u vu re klima e bashkëpunimit midis stafit nga njëra anë dhe bashkëpunimi me studentët nga ana tjetër, për një qëllim të përbashkët, rritjen e cilësisë së mësimdhënies dhe rritjen e mësimnxënies.</p> <p><i>Konstatim i bërë gjatë takimit me studentët e programit.</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Personeli akademik krijon klimë të përshtatshme për zhvillimin e ideve inovative, studime të avancuara kërkimore e shkencore dhe mbështetje të studentëve.</p>	<p>GVJ konstatoi se personeli akademik informohet për zhvillimet më të fundit në fushën e kërkimit shkencor duke marrë vetë pjesë aktive në hulumtim shkencor. Nga ana tjetër personeli akademik nxit dhe përkrah edhe pjesëmarrjen e studentëve në veprimtari të këtij lloji, duke i bërë studentët pjesë të studimeve të tij ose duke udhëhequr pjesëmarrjen e tyre në sesione poster në takimet shkencore të organizuara nga institucioni. Përfshirja e personelit akademik, por edhe e studentëve në punë shkencore të prezantuar në simpoziume, kongrese, konferenca etj, si dhe botimi i artikujve shkencorë në revista e buletine si dhe realizimi i projekteve shkencore jep ndihmesën në zhvillimin e fushës së edukimit fizik dhe sportit. Gjatë vizitës, GVJ-së ju vu në dispozicion libri i konferencave të institucionit, kalendari i veprimtarive shkencore, revista vjetor e institucionit, aktiviteti shkencor i stafit akademik, ku sishin të pasqyruar punimet shkencore të stafit akademik.</p>



	<p>(Libër Abstrakt Konferenca UST, 2017Ref.5 )</p> <p>(Te dhena tabelore per kualifikimin dhe kerkimin shkencor te stafit akademik., Projektet shkencore 2017-2019)</p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Institucioni mbështet zhvillimin e ideve inovative, studimet e avancuara kërkimore e shkencore dhe i mbështet financiarisht studentët.</p>	<p>GVJ gjatë takimit me studentët dhe pedagogët e programit konstatoi se institucioni ka si pjesë të vizionit të vet përfshirjen e studentëve në kërkim shkencor, përmes pjesëmarrjes në aktivitete kërkimore. Objektivi është që studentët, sidomos ata të ciklit të dytë të studimeve të aktivizohen në projekte shkencore si një praktikë e përvitshme. Në konferencën shkencore ndërkombëtare të oragnizuar nga UST, studentët flohen të marrin pjesë në seksionin dedikuar prezantimeve të studentëve kundrejt asnjë detyrimi financiar. Pjesë nga zëri i grantit për kërkimin shkencor shkon për të mbështetur financiarisht studentët në aktivitete shkencore.</p> <p><i>GVJ sygjeron që këto aktivitete me pjesmarrjen e studentëve të publikohen në stendat e UST, pasi i stimulon studentët e tjerë dhe evidenton më të mirët.</i></p>
<p><b>Kriteri 10.</b> Personeli akademik ndërthur format e mësimdhënies me institucionet bashkëpunuese për të mundur dhe rritur mobilitetin e studentëve.</p>	<p>Nga takimi me drejtuesit e institucionit si dhe nga vizita në zyren e bashkëpunimit dhe kërkimit shkencor dhe të marrdhënieve me jashtë. GVJ konstatoi se ndërveprimi midis institucioneve kombëtare dhe nderkombëtare ishte shumë e gjithëpërfshirëse, bazuar marrveshje bashkëpunimi dhe në referencën: <i>(Marrëveshje e bashkëpunimit me Institucione homologe Ref.13).</i></p> <p>Shkëmbimet e personelit akademik dhe mobiliteti i studnetëve drejt universiteteve partnere perëndimore në kuadër të projekteve Erasmus+, janë dëshmi se institucioni implementon metoda mësimdhënieje të ngjashme me ato të aplikuara në instiucione partnere, qofshin këto edhe nga vendet e Komunitetit Evropian. UST i ofron personelit akademik dhe mësimor-shkencor mundesinë e kualifikimeve të metejshme kombëtare ndërkombetare dhe mobilitetit përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Programi Erasmus + mbi shkëmbim mobilitetesh per student, staf akademik dhe administrative me Universitetin e Romës “<i>Foro Italico</i>”;</li> <li>- Programi Erasmus + mbi shkëmbim mobilitetesh për studentë, staf akademik dhe administrativ me Akademinë Kombëtare Sportive “<i>Vassil Levski</i>”, Sofie – Bullgari;</li> <li>- Programi Erasmus + mbi shkëmbim mobilitetesh për studentë, staf akademik dhe administrativ me Universitetin “<i>Aurel Vlaicu</i>” Arad, Rumani. Programi Mevlana për shkëmbim mobilitetesh për studentë dhe staf</li> </ul>



	akademik me Universitetin e Trakyas, Edirne – Turqi”;			
Shkalla e përmbushjes së standardit		Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

### Standardi III.8

Institucioni ndjek një procedurë të qartë të diplomimit të studentit në programin e studimit dhe e përgatit atë me dokumentacionin e nevojshëm.

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton procedurë të posaçme për provimin final ose mbrojtjen e diplomës para diplomimit të studentëve dhe e bën atë publike.</p>	<p>Nga shqyrtimi i DVV, GVJ konstatoi se, plani mësimor i programit të studimit parashikon mundësinë e provimit përfundimtar ose mbrojtjes së diplomës si alternativa për shlyerjen e detyrimeve përmbyllëse. Kur studenti kualifikohet dhe zgjedh të mbrojë një temë diplome, Rregullorja e Diplomimit është dokumenti zyrtar që rregullon çdo procedurë që ndiqet nga aplikimi dhe miratimi i temës së diplomës, te procesi i udhëheqjes së saj, deri te formati i dorëzimit dhe mbrojtja përpara komisionit. Ky informacion i vihet në dispozicion studentit në hapësirën elektronike didaktike. Data e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, Temat e Diplomës dhe cdo informacion tjetër lidhur me këto të fundit bëhen publike si në ambjentet e dukshme të UST, ashtu edhe në faqen zyrtare të Universitetit dhe Fakultetit.</p> <p><i>(Rregullore UST, Neni 63; Ref. 5);</i></p> <p><i>(Vendim Senati Nr. 38, dt. 09.10.2017 mbi Një ndryshim në Rregulloren e UST”, Neni 62, 62/1Ref. 60) <a href="http://fshl.ust.edu.al/njoftime/">http://fshl.ust.edu.al/njoftime/</a></i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik asistojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materiale të nevojshme në funksion të provimit final dhe mbrojtjes së diplomës.</p>	<p>Nga takimi me drejtuesit e institucionit GVJ konstatoi se departamenti përgjegjës për programin e studimit miraton, temat e diplomës, listën e pedagogëve udhëheqës për temat e diplomës. E gjithë procedura e provimit përfundimtar me temë bazohet në rregulloren e UST. Një muaj nga dita e fillimit të vitit akademik, departamenti u bën të njohur studentëve të vitit të fundit temat e diplomave. Brenda datës 20 dhjetor caktohen temat, udhëheqësit dhe plani i veprimit të punimit të diplomës për çdo student. Po kështu departamenti përgjegjës për administrimin e provimit përfundimtar afishon listën e temave që do të përfshihen në provim në stendën e informimit për studentët. Po kështu merren të gjitha masat e nevojshme për të qenë sa më koherent me informacionet rreth provimit të formimit të përgjithshëm përfundimtar për studentët e këtij cikli studimi dhe programi studimi.</p>

	<p><a href="http://fshl.ust.edu.al/njoftime/">http://fshl.ust.edu.al/njoftime/</a></p> <p>(Rregullore e Universitetit të Sporteve, " neni 63, pika 1a, e, f, g Ref. Nr. 5).</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit final bazohet në testimin e njohuritë e dhëna gjatë tri viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike.</p>	<p>GVJ nga konsultimi me dokumentacionin dhe takimet me drejtuesit e institucionit, GVJ u informua për procedurën e punës për provimin përfundimtar të diplomës. GVJ konstatoi se të gjitha hapat e procedurës rregullohen sipas rregullores së institucionit. Departamenti përcakton komisionin i cili bën hartimin e tezës, komisioni i posaçëm ndërton pyetje rreth çështjeve tashmë të përzgjedhura nga disiplina të kategorisë B të marra përgjatë tre viteve akademike në të gjitha lëndët/modulet e përfshira në këtë program studimi. Komisioni përbëhet nga personel akademik i angazhuar në këtë program studimi, i cili mbikqyr me korrektësi zhvillimin e Provimit, asiston përgjatë tij dhe në përfundim të Provimit, nën mbikqyrjen edhe të Kryetarit dhe Anëtarëve të Komisionit të Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar korrigjon tezat. Salla ku bëhet provimi, ka sistem kamerash vëzhgimi si dhe tezat sekretohet për të ruajtur anonimatit e studentit. Teza e provimit hartohet sipas formatit të miratuar nga dekanit.</p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/njoftime/">http://fshl.ust.edu.al/njoftime/</a></p> <p>(Vendim Dekanati Nr. 31, dt. 01.07.2019 mbi Komisionet e Administrimit dhe Korrigjimit të Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar, Ref. 91);</p> <p>(Model Tezë e Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar)</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Personeli akademik orienton dhe ndihmon studentët për përgatitjen e provimit final apo për përgatitjen e temave të studimit/ diplomave.</p>	<p>GVJ konstaton se në përputhje me rregulloren, punimi i temës së diplomës kalon nëpër tri etapave e parashikuara në rregullore. Udhëheqësi i temës i siguron asistencë studentit përgjatë etapave. Studentët që përgatiten për provimin përfundimtar kanë të drejtë të konsultohen me pedagogët e lëndëve përkatëse në oraret e këshillimit të përcaktuara nga pedagogu dhe sipas një grafiku të miratuar dhe të afishuar në stendën e UST.</p> <p>(Rregullore e UST, neni 62Ref.5).</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni asiston studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave dhe fushës së studimit.</p>	<p>Nga takimi me studentët e këtij programi dhe stafin akademik si dhe vizita në institucion, GVJ konstatoi se institucioni garanton infrastrukturën e nevojshme laboratorike që shfrytëzohet për procesin mësimor. Këto hapësira mund të shfrytëzohen edhe nga studentët për qëllime studimore nën mbikëqyrjen e pedagogut udhëheqës ose ndihmësit mësimor që ka në ngarkim laboratorin.</p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Udhëheqësi i diplomës (kur aplikohet)</p>	<p>GVJ në takim me stafin u informua mbi praktikën e provimit</p>

<p>asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e temës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit.</p>	<p>të diplomës me temë. Udhëheqësi i diplomës asiston studentin në punimin e temës së diplomës. Seancat e konsultimit me pedagogun udhëheqës të punimit të diplomës konsistojnë në diskutimin e aspekteve metodologjike, gjetjen e të dhënave, përpunimin e të dhënave nga pikëpamja statistikore dhe hartimin e punimit të diplomës. Pasi sigurohet që punimi përmbush kriteret e cilësisë në drejtim të përmbajtjes dhe formës, udhëheqësi miraton që punimi të prezantohet para komisionit duke e firmosur.</p> <p><i>(Rregullore e diplomimit, neni 5, pika 3 si dhe Rregullore e UST, Neni 63, pika 3Ref.5)</i></p>
<p><b>Kriteri 7.</b> Në përfundim të provimit ose mbrojtjes së diplomës, studenti vlerësohet me notë.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i DVV, konstatoi se ekziston një rregullore dhe vendim senati, të cilat tregojnë se vlerësimi i provimit të përgjithshëm përfundimtar dhe punimit të diplomës kryhet nga komisionet e posaçme përmes një sistemi pikëzimi, në total 100 pikë, që më pas konvertohet në vlerësim me notë. Mbrojtja e diplomës bëhet para një komisioni të përbërë nga tre pedagogë, ku njëri përcaktohet të jetë oponenti. Komisioni i propozuar nga Drejtuesi i Departamentit miratohet nga Dekani. Kandidati që rrëzohet në mbrojtjen e diplomës, ka të drejtë të riparaqitet për mbrojtje në një datë të caktuar të sezoneve të caktuara, sezon i verës, dimrit dhe vjeshtës.</p> <p><i>(Vendim Senati Nr. 38, dt. 09.10.2017 mbi Një Ndryshim në Rregulloren e UST", Neni 62Ref. 60 );</i></p> <p><i>(Rregullore e diplomimit, Shtojca 4, Shtojca 5);</i></p>
<p><b>Kriteri 8.</b> Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me diplomën dhe suplementin e diplomës, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin.</p>	<p>GVJ nga shqyrtimi i DVV, u informua se studenti qw ka shlyer të gjitha detyrimet e programit, pajiset me diplomën përkatëse: Bachelor në "Shkencat e Lëvizjes". Formatit dhe përmbajtja e Diplomës dhe Suplementit të Diplomës janë të hartuar në përputhje me udhëzimet e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.</p> <p><i>(Urdhri i MAS Nr. 104, datë 09.03.2016 mbi miratimin e formës së diplomës Ref. 8)</i></p>
<p><b>Kriteri 9.</b> Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar.</p>	<p>GVJ konstoi se studentëve të diplomuar u vihet në dispozicion kopja zyrtare e programit të studimit dhe elementëve përbërës të tij. Gjithashtu, studentët pajisen me Suplementin e Diplomës, ku janë të pasqyruar me detaje të dhënat mbi kualifikimin e arritur (në gjuhët shqip dhe anglisht). Ajo nënshkruhet nga Dekani i Njësisë Kryesore dhe Rektori i UST-së. Nënshkrimet shoqërohen me vulën e Institucionit sipas</p> <p><i>(Rregullore UST, Neni 66, 67Ref.5).</i></p>

	<i>(Modeli i Suplementit të Diplomës Ref,8)</i>			
<b>Kriteri 10.</b> Institucioni ruan për një periudhë të pacaktuar kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet/konfirmon, rast pas rasti, informacione për studentin, nëse kërkohen.	Gjatë takimit në Sekretarinë mësimore GVJ konstatoi se në përputhje me politikat e institucionit bëhet arkivimi, ruajtja dhe administrimi i dokumentacionit, për një periudhë pa afat. Përveç dokumentacionit hard copy, institucioni i hedh të dhënat në një databazë të detajuar, dhe i përpunon ato sipas kërkesave të ministrisë përgjegjëse për arsimin, Agjencisë për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, apo nevojave të vet institucionit.  <i>Konstatim i bërë gjatë takimit në Sekretarinë mësimore</i> <i>(Rregullore e UST, Neni 61;pika 12Ref.5)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

<b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III</b>	Nuk përmbushet	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				<b>X</b>

### III. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

<b>Standardi IV.1</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit, vlerësimit dhe përzgjedhjes së personelit përgjegjës për programin e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësmësimor-shkencor dhe administrativ.	GVJ nga vizita në zyrën e burimeve njerëzore konstatoi se institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. <i>(Model Fletë Inventari të Dosjes së Personelit Ref.20)</i> . Pas kërkesës nga GVJ për dokumentacionin përkatës dhe pasi e konsultoi atë, GVJ konstaton se Zyra e Burimeve Njerëzore ruan të dhënat e personelit akademik e administrativ dhe i përditëson ato me ndryshimet përkatëse. Dokumentacioni i depozituar prej çdo personeli akademik efektiv ruhet sipas formatit të Dosjes Personale të Stafit Akademik në zyrën e burimeve njerëzore. <i>(Vendim Senati Nr. 28, datë 19.05.2017 "Mbi ruajtjen dhe administrimin e te dhenave personale Ref. 66 )</i> . GVJ konstatoi se dosjet e stafit akademik te jashtëm ruhen pranë Departamenteve. Çdo dosje e personelit përmban dokumentacionet bazë, si CV, kopje e kartës së identitet,

	<p>librezës së punës, diploma, lista notash të noterizuara, gjuha e huaj e noterizuar, raporti mjeko ligjor, kërkesa për vendin e punës, dëshmia e penaltetit, 2 referenca, kualifikime të ndryshme etj. GVJ konkludon se Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik, të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit bazuar në <i>(Regullore e UST, Neni 61 Ref.50)</i>.</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni harton dhe zbaton procedura për rekrutimin e personelit akademik, në përputhje me bazën ligjore në fuqi dhe aktet e brendshme rregullatore të institucionit.</p>	<p>GVJ konstatoi gjatë vizitës në institucion, konkretisht në zyrën e burimeve njerëzore se e gjithë procedura e rekrutimit të stafit akademik bëhet konform procedurave të hartuara sipas legjislacionit në fuqi, mbështetur edhe mbi politikat e brendshme institucionale. Rekrutimi i PAE bëhet sipas ligjit të Arsimit të Lartë me nr 80/ 2015. Rektorati shpall konkursin dhe dërgohet publikimi i njoftimit “Për shpalljen e vendeve të lira të punës për personel akademik” në Buletinin e Njoftimeve Publike, si dhe në website zyrtar të UST, bashkangjitur formularët e aplikimit. Kriteret e përgjithshme dhe preferenciale që duhet të plotësojnë kandidatët propozohen nga Departamenti përkatës dhe pas verifikimit dhe dakortësisë nga Dekani, i përcjell në Rektorat për miratim dhe ndjekjen e mëtejshme të procedurave për shpalljen e vendeve të lira të punës. Konkursi fillon nga dita e shpalljes në Buletinin e Njoftimeve Publike, Agjensia e Prokurimit Publik dhe përfundon dy javë pune pas këtij njoftimi, aplikimet pranohen në rrugë postare. GVJ vuri re se zbatohet me perpikmëri procedura sipas legjislacionit bazuar në, <i>(Regullore e UST, Neni 25Ref. 5)</i>, <i>(Statut i UST, Kreu VII, Neni 33 Ref. 2)</i>, <i>Relacion për procedurat e rekrutimit të personelit akademik Ref. 22)</i>. Pas dorëzimit të dosjeve Brenda afateve kohore të përcaktuara, ngrihet komisioni Ad Hoc për shqyrtimin e dosjeve të aplikantëve. Komisioni përbëhet nga 3 anëtar (një përfaqesues nga rektorati, dy nga njësia bazë). Pas shqyrtimit të dosjeve nga komisioni përcaktohet data, ora e intervistës gojore ose me shkrim. Kandidatët njoftohen për intervistën nga Zyra e Burimeve Njerëzore me e.mail ose telefon. Kandidatët që nuk fitojnë njoftohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore me email ose telefon, po kështu kandidatët që kualifikohen njoftohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore me email ose telefon e cila harton kontratën e punës, kurse njësia bazë harton akt marrvëshjen. Kandidatët që nuk fitojnë njoftohen nga Zyra e Burimeve Njerëzore me email ose telefon dhe kanë të drejtë të ankimojnë brenda 5 ditëve nga shpallja e rezultateve, ankimimin e dërgon në rektorat dhe ky i fundit ngre komisionin për rishikim të dosjes dhe dhënien e</p>



	përgjigjes përfundimtare, bazuar Rregullores së Zyrës së Burimeve Njerëzore si dhe Relacion mbi Procedurën e Rekrutimit të Personelit Akademik/Administrativ			
<b>Kriteri 3.</b> Institucioni harton procedura e kriteret të posaçme e specifike për rekrutimin e personelit, të cilat janë pjesë e akteve rregullatore dhe i bën ato publike.	GVJ konstatoi nga vizita në Zyrën e Burimeve Njerëzore se procedura e rekrutimit të stafit akademik është e parashikuar në Rregulloren e brendshme të institucionit. Kriteret shpallen publikisht dhe përzgjedhja bëhet me konkurs. Çdo shpallje për vende të lira pune për personel akademik publikohet në Buletinin e Njoftimeve Publike dhe në gazeta, revista ose televizione në varësi të fondeve të universitetit. Po kështu, këto njoftime bëhen publike në faqen zyrtare të universitetit. Procedura sic është shpjeguar edhe më lartë në kritren 2. (Rregullore e Universitetit të Sporteve, neni 25, pika 1,2; Ref. Nr. 5), (Print Screen i njoftimit të publikuar në Buletinin e Njoftimeve Publike, Procedura e konkurimit për rekrutimin e stafit akademik me kohë të pjesshme dhe me kohë të plotë Ref. 21,22).			
<b>Kriteri 4.</b> Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kriteret të përgjithshme dhe specifike të shpallura e që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit.	Nga shqyrtimi i dokumentave të vëna në dispozicion, GVJ konstatoi se Rregullorja e Institucionit përcakton që kriteret e punësimit të personelit akademik të propozohen nga departamenti përkatës, dhe pas shqyrtimit nga Dekani, t'i përcillen Rektoratit për miratim. Vlerësimi i kandidaturave bëhet në bazë të paketës së aplikimit (70%) dhe intervistës (30%). Kriteret e paketës së aplikimit dhe pyetjet e intervistës hartohen në përputhje me specifikat e vendit vakant të shpallur. Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Arkivit në UST kishte të arkivuar të gjithë të dhënat për rekrutimin e personelit dhe të njoftimeve për vende vakante.  (Rregullore e UST, Neni 25; Ref. 5)  (Statut I UST, Kreu VII, Neni 33; Ref. 2)  (Relacion për procedurat e rekrutimit të personelit akademik Ref. 22).			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

#### Standardi IV.2

**Institucioni i arsimit të lartë ka përgjegjësinë primare për cilësinë e personelit që mbulon programin e studimit dhe mbështetjen për kryerjen e detyrave në mënyrë efëcente dhe efektive**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni angazhohet për krijimin e	Gjatë vizitës në institucion dhe takimit me stafin akademik GVJ konstatoi se institucioni ka mjedisie të përshtatshme për




<p>mjedisit dhe mundësive të përshtatshme dhe të barabarta për kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale.</p>	<p>kryerjen e detyrave të personelit në mënyrë profesionale. Këto ambiente ishin plotësuar kryesisht, pas rikonstruksionit të godinës së re. Institucioni ofron mjedise të mjaftueshme e brenda standardeve për zhvillimin e veprimtarisë profesionale të personelit akademik. Kapacitetet infrastrukturore në dispozicion për FSHL, janë prej 8 zyrash stafi akademik efektiv (mestarisht 3 poste pune për çdo zyrë), të pajisura me PC për çdo anëtar të stafit, me sistem kondicionimi e ndriçimi të cilat sigurojnë për stafin mjedis të përshtatshëm pune e mundësish të barabarta për kryerjen e detyrave profesionale. (Vendimi Bordi Administrim nr. 15 datë 01.03.2019 "Për detajimin e të ardhurave" Ref. 670;</p> <p>(Vendimi Bordi Administrim nr.24 datë 18.07.2019" Mbi miratimin shtesë të detajimit të të ardhurave Ref. 68)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe zhvillimin e mëtejshëm profesional të personelit që mbulon dhe administron programin e studimit.</p>	<p>Nga takimi me stafin akademik, GVJ konstatoi se çdo vit në detajimin e grantit, UST parashikon një zë për kërkimin shkencor, qoftë në mënyrë të drejtpërdrejtë (financim i projekteve shkencore, pjesëmarrje në konferenca, publikime shkencore), por edhe në mënyrë të tërthortë përmes investimeve në infrastrukturën laboratorike që mund të shfrytëzohet nga pedagogët për zhvillim të mëtejshëm shkencor e profesional. Ky fond mbulon shpenzimet për pagesën e tarifës së pjesëmarrjes në konferencë dhe shpenzimet e udhëtimit. Gjithashtu insitucioni nuk u bën pedagogëve asnjë ndalesë në pagë për ditët e punës që u merr pjesëmarrja në konferencë. Fondi për botimin e revistës shkencore të UST-së dhe shpenzimet për organizimin e konferencave shkencore kombëtare/ndërkombëtare, që të gjitha mbulohen nga buxheti i UST-së. Marrëveshjet e bashkëpunimit që nënshkruan për shkëmbimin e stafit janë gjithashtu tregues i mbështetjes që institucioni siguron për kualifikimin e stafit, në kuadër të rritjes së cilësisë së mësimdhënies në programin e studimit. Gjithashtu marrëveshjet e bashkëpunimit si dhe mbështetja që institucioni siguron për stafin miratohen sipas rregulloreve , dhe vendimeve të senatit dhe bordit administrative.</p> <p>(Vendim Senati Nr. 23, dt. 17.05.2019; Ref. 23 );</p> <p>(Vendim Senati Nr. 25, dt. 17.05.2019Ref. 36 );</p> <p>(Vendim BA nr. 29 datë 18.07.2019 Ref. 69 );</p> <p>(Vendim BA nr.32 datë 21.10.2019Ref. 70 );</p> <p>(Vendimi BA nr.33 datë 21.10.2019Ref. 71);</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni organizon programe specifike për metodat inovative të mësimdhënies e përdorimit të</p>	<p>GVJ nga takimi me stafin akademik dhe zyrën e IT konstatoi se për rekrutimet e reja në përbërjen e personelit akademik efektiv, institucioni siguron përmes zyrës së IT-së asistencën e nevojshme në formën e trajnimeve për përdorimin e</p>



<p>teknologjive të reja, për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor.</p>	<p>platformave elektronike që ofrom institucioni për programin e studimit. Institucioni merr masa që pedagogë të caktuar dhe personeli ndihmës mësimor të trajnohet për përditësimin me protokollat laboratorike në funksion të procesit të kërkimit shkencor dhe procesit të mësimdhënies. Përmendim bashkëpunimin e UST me ERASMUS, mbi shkëmbim mobilitetesh për student, staf akademik dhe administrative me Universitetin e Romës “Foro Italico”.</p> <p><i>(Të dhënave mbi mobilitet Erasmus+Ref. 40).</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ konstatoi se procedura e rekrutimeve për staf akademik dhe ndihmës akademik përbën logjistikën e mjaftueshme në burime njerëzore, përzgjedhja e tyre sipas kriterëve të përcaktuara ligjore dhe ato specifike për programin e studimit, dhe politika që ndjek njësia kryesore dhe njësia përgjegjëse për programin e studimit në shpërndarjen e ngarkesës mësimore në bazë ekspertize janë disa tregues domethënës të angazhimit optimal të burimeve njerëzore në funksion të përmbushjes së objektivave të programit. Bazuar në DVV, si UST – ja, FSHL – ja me njësitë përgjegjëse respektive për ofrimin e programit të studimit të ciklit të parë Bachelor ka në përbërjen e saj 41 pedagogë personel akademik si dhe 32 punonjës personel ndihmës akademik dhe administrativ, duke ruajtur kështu raportin e duhur, 1 pedagog /35 studentë, raport sipas legjislacionit në fuqi.</p> <p><i>(Apendiks Tabela 1,4)</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Niveli i përmbushjes</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.3</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programeve të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit/ëve të studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimdhënëse teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se institucioni siguron infrastrukturën dhe mjediset e mjaftueshme dhe të përshtatshme mësimore për zhvillimin e veprimtarisë mësimore teorike, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, si dhe në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit bachelor. Ka një mjedis universitar të ndërtuar dhe i rikonstruktuar përgjatë viteve në bazë të</p>




<p>studimit dhe moduleve përkatëse.</p>	<p>specifikave të programeve të studimit që ofron. Sallat e leksioneve, të seminareve, labororet, terrenet sportive, biblioteka, etj, vihen plotësisht në dispozicion të procesit mësimor. Ambjentet janë konform udhëzimeve të MASR përsa u përket numrit të studentëve, grupeve mësimore dhe plotësojnë standartet e kërkuara. Ky informacion u konstatua edhe nga verifikimi i dokumentave të vëna në dispozicion si:</p> <p><i>(Të dhëna për infrastrukturën Ref. 72);</i>  <i>(Apendiks Tabela 16, Tab e inventarizimit të pronave Ref. 73)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies.</p>	<p>GVJ gjate vizitës në institucion për infrastrukturën mësimore konstatoi se hapësirat mësimore janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme didaktike për zhvillimin e leksioneve, seminareve, laboreve dhe orëve praktike. Sallat e leksioneve janë pajisur me PC dhe projektor për prezantimin e leksioneve me Power Point si dhe përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. Laboratori i IT dhe Linguistikës janë pajisur secili me nga 35 poste studimi me PC. Të gjithë kompjuterët janë lidhur në rrjet.</p> <p><i>(Të dhëna për infrastrukturën Ref.72 );</i>  <i>(Apendiks Tabela 16 );</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Laboratorët, studiot, atelietë apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimin teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi.</p>	<p>Gjatë vizitës në terren, GVJ konstaton se labororet e ndryshëm si ai i anatomisë, laborator i fizioterapisë, laborator i rehabilitimit sportiv, laborator i biomekanikës, laborator biokimik, laborator i vlerësimit postural, salla e fitnesit, salla e dansit, palestra e gjimnastikës, etj, janë pajisur me infrastrukturën e nevojshme për zhvillimin e një procesi mësimor që përmbush objektivat formuese të lëndës specifike dhe të programit të studimit në përgjithësi.</p> <p><i>(Të dhëna për infastrukturën, Laboratorët)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit/ eve të studimit që ofron.</p>	<p>GVJ konstatoi se laborator i Informatikës është i pajisur me (36 kompjutera dhe 18 tavolina) kompjuterat janë me parametra teknike të standardeve bashkëkohore, ku janë instaluar të gjithë programet e nevojshme për të mundësuar zbatimin e programeve lëndore. Kjo hapësirë shfrytëzohet edhe për aktivitete trajnuese, si edhe vihet në dispozicion të studentëve për realizimin e detyrave të kursit.</p> <p><i>(Të dhëna për infrastrukturën);</i>  <i>(Apendiks Tabela 16 Ref. 72 );</i></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron dhe/ose në bashkëpunim me</p>	<p>GVJ nga dokumentat e vëna në dispozicion nga institucioni konstatoi se disponon një sërë marrëveshje të bashkëpunimit me institucione kombëtare dhe ndërkombëtare të cilat</p>



<p>institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset të jenë të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të posaçme për zhvillimin e praktikave profesionale dhe veprimtarive të tjera praktike.</p>	<p>shprehen në raportin e fundit periodik analitik i përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimeve. Falë përfitimit nga marrëveshjet e bashkëpunimit është siguruar infrastrukturë për laboratorët e fizioterapisë në formën e akt-dhurimit. Edhe në kuadër të bashkëpunimeve në programet TEMPUS është përfituar bazë materiale për infrastrukturën e laboratorëve si ai i biomekanikës, laborator i lingistikës, etj. Në përputhje me politikat financiare të institucioni çdo vit planifikohen nga granti shpenzime në drejtim të pajisjeve laboratorike. (Vendimi i Bordi Administrimi Nr. 24 datë 18.07.2019 "Për detajimin shtesë nga të ardhurat" për financimin e projektit të pistës dhe rikonstruksionin e palestrës së lojrave. Ref. 68 )</p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Kritikisht</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi IV.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën, mjedise të posaçme të mësimnxënies dhe literaturën e nevojshme në mbështetje të procesit të mësimnxënies për studentët e programit të studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve mjedise mbështetëse të mësimnxënies, bibliotekën mësimore. Biblioteka e UST-së është një hapësirë brenda mjediseve të universitetit. Ka një hapësirë prej 258.4 m<sup>2</sup> me 48 vende leximi sic është përshkruar dhe në kriteret e mesipërme. Përveç se hapësirë leximi, biblioteka shfrytëzohet nga studentët edhe për infrastrukturën kompjuterike përgjatë ditës në funksion të realizimit të detyrimeve të programit të studimit. Gjatë ditës dhe mbase sipas kërkesave të studentëve qëndron punonjësja e bibliotekës e cila vëzhgon dhe kujdeset për bibliotekën. Punonjësja e bibliotekës ka të rregjistruar të gjithë librat, të cilat ju vihen në dispozicion studentëve sipas kërkesave duke ju hapur një kartelë personale të bibliotekës</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të</p>	<p>Gjatë vizitës në bibliotekë GVJ vuri re se biblioteka është e pajisur me literaturë fizike, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhë shqipe dhe të huaja. Fondi i librave të bibliotekës numëron 1.669 tituj librash, që përfshijnë: libra në gjuhën shqipe të miratuara si tekste mësimore nga Senati Akademik; libra të fushës në</p>




<p>mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit.</p>	<p>gjuhë të huaj, kryesisht libra në gjuhën angleze nga shtëpia botuese Human Kinetics, shtëpia botuese lider në fushën e programit të studimit; libra në gjuhë të tjera; revista shkencore; kopje të disertacioneve të të personelit akademik të UST-së. Po ashtu cdo vit ekziston një zë në buxhet për bibliotekën (libra të ndryshëm shkencor), e konstatuar edhe dokumentat e vëna në dispozicion.</p> <p><i>(Vendimi i Bordit të Administrimit Nr. 15 datë 01.03.2019 "Për detajimin e të ardhurave" Ref.67);</i></p> <p><i>(Apendiks Tabela 17);</i></p> <p><i>(Të dhëna për infrastrukturën Ref. 72);</i></p> <p><i>(Lista e librave të shtuar në bibliotekë.pdf)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni duhet të krijojë kushte për akses të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat on-line të fushës së programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se në të gjithë ambientet e Universitetit ishte internet free dhe i aksesueshëm nga student dhe pedagogët e universitetit. Libraria është aktualisht e vetmja platformë online që shfrytëzohet nga studentët dhe pedagogët për të aksesuar, shkarkuar libra mësimore në format pdf, artikuj shkencorë, revista shkencore, etj. Studentët e pedagogët mund ta aksesojnë këtë bibliotekë pa pagesë përmes adresës së emailit të siguruar nga institucioni. Në bibliotekë është instaluar programi KOHA, në bashkëpunim me Universitetin e Arteve falë një projekti të përbashkët ndër-institucional me anë të cilit kemi krijuar Katalogun online nëpërmjet aplikimit të sistemeve me bazë "kod në burim të hapur" (ose si quhen ndryshe open source, me asnjë kosto për përdoruesit), si modul i integruar për menaxhimin e fondit të Bibliotekës Shkencore të UST-së. Ky katalog si dhe manual i Bibliotekës, U-library mund të aksesohet kudo nëpërmjet stilit zyrtar tek Universiteti i Sporteve. Projekti u lançua në Korrik të vitit 2013. Në kuadër të paktit me universitetet . Studentët e pedagogët mund ta aksesojnë këtë bibliotekë pa pagesë përmes adresës së email.it të siguruar nga institucioni.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizime nga ana e të gjithë studentëve.</p>	<p>GVJ gjatë vizitës në institucion konstatoi se biblioteka e UST-së është e pajisur me PC, të lidhur në rrjetin LAN që përdoren nga studentët për të kërkime të mëtejshme në fushën e tyre të studimit, për të marrë materiale didaktike nga pedagogët e tyre, të hedhura në rrjetin e brendshëm. <a href="http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/">http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë e zbatojë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës, përditësimin e fondit ekzistues në mbështetje</p>	<p>GVJ nga dokumentat e vëna në dispozicion, sic ishte plan buxheti konstatoi se fondi i bibliotekës shtohet çdo vit prej buxhetit të institucionit të planifikuar për zërin Libra i cili miratohet nga Bordi i Administrimit, vlera e financimit të literaturës së huaj. Institucioni siguron një plan të detajuar për</p>



të programit.	shtimin e zërave të bibliotekës. <i>(Ref. 67 - Vendimi BA nr. 15 datë 01.03.2019)</i>			
<b>Kriteri 6.</b> Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj.	GVJ konstatoi se biblioteka vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor. Orari i Bibliotekës është 08:00-15:00, gjatë të cilit mund të shfrytëzohet nga studentët e të gjitha cikleve të studimit, pasi përkon me oraret e tyre të mësimi. Ky orar është i shkruar dhe në faqen zyrtare të fakultetit. Biblioteka për nevoja të studentëve në bazë të kërkesave të tyre, mund të shtyj orarin. Studentët kanë akses në revistat shkencore të universitetit që gjenden në web-site <a href="http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/">http://ust.edu.al/informacion-mbi-biblioteken/</a> të UST-së, në <a href="http://ust.edu.al/katalogu-online/">http://ust.edu.al/katalogu-online/</a> dhe <a href="http://ust.edu.al/foto-galeri/">http://ust.edu.al/foto-galeri/</a> .			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Plotësisht përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programet e studimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit.	GVJ nga vizita në sekretarinë mësimore konstatoi se UST administron të gjithë informacionin e studentëve nga regjistrimi deri në diplomim përmes sistemit UMIS, që aksesohet përmes platformës ESSE3, ku edhe ruhen, administrohen e përpunohen të dhënat e studentit dhe rekordet akademike ndër vite nga regjistrimi deri në diplomim në programin e studimit. <i>(Udhëzues për përdorimin e SIMS ,RASH INFORef. 74) .</i>
<b>Kriteri 2.</b> Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmës akademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit.	GVJ në takimin me stafin akademik, ndihmës akademik konstatoi se Sistemi për Menaxhimin e Informacionit është i aksesueshëm edhe nga personeli akademik që e përdor atë për aktivitetin në kuadër të procesit të mësimdhënies; i mundëson studentit të përditësohet në kohë reale me të dhënat që pedagogu hedh në sistem si vlerësime, frekuentim, program/syllabuse dhe komunikime në formë mesazhesh tekst bashkëngjitur dhe Udhëzues për përdorimin e SIMS. Institucioni është në proces të implementimit të një arkive digjitale për administimin e dokumentacionit të të gjitha



	<p>drejtorive të UST-së. Aktualisht drejtoritë funksionojnë përmes krijimit të bazave të të dhënave lokale, në format Word dhe Excel. Sistemi i burimeve njerëzore bazuar në <i>(Marrëveshje Konfidencialiteti me RASHRef.75)</i>, hedh të dhënat e stafit akademik efektiv dhe të jashtëm, personelit ndihmës akademik dhe administrativ.</p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ konstatoi se Sistemi aktual i Menaxhimit të Informacionit ofron funksionalitetet e nevojshme për stafin akademik, administratën (sekretarinë mësimore) dhe studentët për administrimin e të gjithë ciklit akademik të studentit si; regjistrimi i program/syllabus të kurseve, vlerësimet deri në diplomim, gjithashtu transferimet nga njëri universitet në tjetrin bazuar dhe në <i>(Manualin e Rregjistrimi në portal të UST, Studentë, Manual për provimet dhe Librezën Studentore Ref.23)</i></p> <p><i>Funksionalitetet didaktike</i> përfshijnë: strukturën akademike, menaxhimin e karrierës së studentit si dhe administrimin e provimeve dhe diplomimin.</p> <p><i>Funksionalitetet për sekretarinë</i> përfshijnë: pranimin dhe regjistrimin, menaxhimin estudentëve hyrës dhe dalës.</p> <p><i>Funksionalitetet për aspektet financiare</i> të programit të studimit përfshijnë: menaxhimin e tarifave; bursat; periudhat financiare etj. Studentët në hapësirën e tyre online nëpërmjet Sistemit të Menaxhimit ESSE3 kanë akses të kryejnë çdo veprimtari të mundshme, prenotim provimesh, rregjistrim në provime, printime të formularëve të ndryshëm etj.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Sistemi i menaxhimit ka të integruara platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ nga takimi me PAE dhe PAK si dhe studentët mori informacion se një nga funksionet e Sistemit të Menaxhimit të Informacionit është dhe komunikimi dhe shkëmbimi i materialeve didaktike dhe informacionit në formë njoftimesh mes pedagogëve dhe studentëve. <a href="http://ust.edu.al/udhezime/">http://ust.edu.al/udhezime/</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët.</p>	<p>GVJ konstatoi se Sistemi i Menaxhimit të Informacionit siguron monitorimin e mbarëvajtjes së procesit të mësimdhënies, sidomos në lidhje me administrimin e provimeve dhe hedhjes së vlerësimeve. Kjo i kontribuon shmangies së vonesave dhe rritjes së transparencës. Nga ana tjetër, pedagogët mund të përdorin të dhënat e hedhura në sistem për përpunime të mëtejshme statistikore. Po kështu ky sistem kontribuon në dhëna në kohë reale për organet drejtuese dhe titullarët për mësimdhënien, dhe administrimin e provimeve sipas rregullores së universitetit dhe rregullores së provimeve, bazuar ky informacion dhe në Manualin e</p>



	Rregjistrimit në portal të UST, Studentë, Manual për provimet dhe Librezën Studentore.			
<b>Kriteri 6.</b> Informacionet që lidhen me programet e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen e internetit në të paktën dy gjuhë ku të paktën njëra prej tyre është gjuha shqipe.	GVJ konstatoi se institucioni ka në administrim faqen zyrtare <a href="http://www.ust.edu.al">www.ust.edu.al</a> dhe në përputhje me politikat e transparencës dhe politikat e privatësisë të hartuara konform legjislacionit në fuqi, bazuar në <i>(Rregullore për mbrojtjen e të dhënave personale; si dhe Politikat e Privatësisë)</i> . Institucioni ka në administrim faqen zyrtare <a href="http://www.ust.edu.al">www.ust.edu.al</a> dhe përcakton se cilat informacione e dokumente do të bëhen publike përmes faqes sipas <i>(Manual të Formave të Informimit)</i> . Përmbajtja e faqes ofrohet në gjuhën shqipe. Platforma e U-Transparencës është një tjetër hapësirë elektronike ku institucioni shfaq informacione dhe vendime të ndryshme që merr. Llogaritë në rrjetet shoqërore janë gjithashtu mundësi informimi për njoftime të ndryshme.  <i>(Ref. <a href="http://www.ust.edu.al">www.ust.edu.al</a> <a href="http://fshl.ust.edu.al/">http://fshl.ust.edu.al/</a>)</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Niveli i përmbushjes</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi IV.6</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë garanton financimin dhe mbështetjen financiare të nevojshme për realizimin e procesit mësimor-kërkimor, mbarëvajtjen e programit të studimit dhe mbështetjen e studentëve.</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton një raport financiar të kostove të programit të studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programit të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi.	Nga konsultimi i dokumentacionit përkatës, GVJ konstaton se raporti financiar për mbulimin e shpenzimeve në nivel institucional hartohet mbi bazën e kostove dhe financimeve. Granti i akorduar është i plotë dhe siguron financim për të gjithë programin e studimit BA, duke mbuluar kostot deri në përfundim të programit. Shpenzimet për program të dytë studimi mbulohen nga tarifat e shkollimit. Të ardhurat e gjeneruara nga institucioni në formë tarifash shkollimi, donacionesh, sponsorizimesh, etj, shkojnë gjithashtu në mbështetje të programit të studimit. Gjatë ndryshimeve të legjislacionit ka patur dhe rishikim të kësaj tarife shkollimi, zvogëlim të saj sipas <i>(Relacion mbi miratimin e tarifave të shkollimit, konkurimit dhe rregjistrimit për vitin akademik 2019 – 2020, dhe ndryshimin e tarifës së shkollimit; vendimet e miratimit Senat dhe Bord Administrimi Ref. 93)</i> , sipas VKM dhe një pjesë e uljes së tarifës është rimbursuar nga grand shtesë për mësimdhënien nga buxheti. Financimi për programin e



	<p>studimit të ciklit të parë bachelor vjen nga MASR, grandit për mësimdhënien plotëson nevojat për zhvillimin normal të procesit mësimor.</p> <p><i>(Vendim Senati nr 31, datë 05.07.2019 Ref. 76);</i></p> <p><i>(Vendim Bordi Administrimi nr 26, datë 18.07.2019 Ref. 77);</i></p> <p><i>(Vendim Senati nr. 3 datë 11.01.2019 "Mbi miratimin e detajimit të grandit" Ref. 78);</i></p> <p><i>(Vendim BA nr. 3 datë 10.01.2019 "Mbi miratimin e detajimit të grandit" Ref. 79)</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Plani i financimit të një programi studimi duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programit, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat on-line, detyrimet financiare, grantet vendëse apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programit të studimit dhe zëra të tjerë sipas natyrës specifike të tij.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit përkatës, GVJ konstatoi se raporti financiar për mbulimin e shpenzimeve në nivel institucional hartohet mbi bazën e kostove dhe financimeve. Çdo fillim viti financiar Senati Akademik miraton propozimin e Rektoratit për detajimin e grantit të pushtetit qendror për vitin në vazhdim, dhe ia kalon ato më pas Bordit të Administrimit për miratim. Financimi për programin e studimit të ciklit të parë bachelor vjen nga MASR, grandit për mësimdhënien plotëson nevojat për zhvillimin normal të procesit mësimor. Bordi i Administrimit nga ana e tij miraton detajimin e grantit dhe ngarkon Administratorin dhe Drejtorinë e Financës dhe Buxhetit për zbatimin e tij. Ky plan financiar përfshin kostot për realizimin e programit të studimit, financimin për burimet njerëzore shpenzimet për libra dhe publikime shkencore, mjete didaktike, materiale dhe pajisje laboratorike, etj. Me vendim Senati UST miraton detajimin e grantit, i cili përfshin materiale shërbimi, për financimin e programeve të studimit jashtë universitetit, energji etj, libra dhe publikime profesionale, pajisje laboratorike etj., në mbulim të kostove të programit të studimit, si dhe miratimin e të ardhurave për pajisje të ndryshme në funksion të procesit mësimor dhe rikonstrukcion të ambjentëve, etj. Bashkëngjitur referencat që hulumtoi GVJ për planin e financimit të një programi studimi.</p> <p><i>(Ref. 80 – Pasqyrat Financiare, 2016, 2017, 2018);</i></p> <p><i>(Ref. 67 – Vendime Bordi Administrimi nr. 15, date 01.03.2019 për të ardhura);</i></p> <p><i>(Ref. 68 – Vendime Bordi Administrimi nr. 24, date 18.07.2019 për të ardhura);</i></p> <p><i>(Ref. 81 – Vendime Senati Nr. 29, date 05.07.2019 UST të ardhura);</i></p> <p><i>(Ref. 82 – Vendime Senati Nr. 15, date 01.03.2019 UST të ardhura);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni kryen auditim të përvitshëm, vlerëson</p>	<p>GVJ konstatoi se institucioni harton pasqyra financiare të hollësishme brenda afateve të parashikuara për deklarimin e</p>

<p>dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. Raporti financiar përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare.</p>	<p>dorëzimin e pasqyrave financiare. Në Raportin e veprimtarisë mesimore, shkencore dhe financiare specifikohen objektivat përkatëse financiare të miratuara në fillim të vitit nga Senati dhe Bordi Administrimi në UST dhe realizimin e të ardhurave të krijuara nga tarifat e shkollimit. Këto i dërgohen për miratim ministrisë përgjegjëse për arsimin. i gjithë aktiviteti financiar i institucionit, përfshirë edhe pasqyrat financiare, është subjekt auditimi nga ministria përgjegjëse për arsimin. Misioni i auditimit konsiston në auditimin e zbatimit të rekomandimeve të mëparshme, auditimin e organizimit dhe mbajtjes së kontabilitetit, auditimin e krijimit dhe menaxhimit të të ardhurave, etj. GVJ konstaton se institucioni me marrjen e raportit të auditit merr masa për hartimin e një plan veprimi me qëllim implementimin e rekomandimeve dhe sugjerimeve të grupit të auditit. Raporti i auditit i përcillet edhe Bordit të Administrimit. Ky raport dokumentohet dhe referohet në analizën vjetore institucionale.</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike dhe planifikon ndërhyrjet e posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programit për të garantuar ecurinë dhe mbarëvajtjen normale të tij.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatoi se në mbyllje të çdo cikli të plotë studimi, institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike përmbushje të detyrimeve ligjore, po kështu institucioni dorëzon në mënyrë periodike pasqyrat financiare në nivel institucional, ende jo në nivel programi. Plani financiar i hartuar parashikon diversifikimin e planit të financimit me qëllim që të garantojë vazhdimësinë e ofrimit të programeve të studimit. Si rregull, në mes dhe në fund të një programi studimi, institucioni rishikon koston e një programi studimi, që mund të rezultojë në një ndryshim eventual të financimit. Edhe përballë situatave të paparashikuara, përmes ndërhyrjeve të posaçme, institucioni dëshmon aftësi për garantimin e ecurisë së një programi studimi. Si shembull të kësaj, vërejmë reduktimin e tarifës së shkollimit gjatë vitit akademik. Raporti financiar i konstatuar nga GVJ mbështetet në dokumentacionin e mëposhtëm.</p>

*(Të dhëna nga Raporti financiar vjetor institucional; Ref. 87);*

*(Vendim Bordi Administrimi Nr. 1, dt. 11.01.2019 mbi Miratimin e Objektivave Financiare të vitit 2019 Ref. 83 );*

*(Vendimi i Senatit Nr.1 datë 2019 “Për miratimin e objektivave për vitin 2019” Ref. 84);*

*(Dërgim Raporti Auditimi nga Drejtorja e Auditimit të Brendshëm, MASR, me Nr. Prot. 6040/3, dt. 31.08.2018Ref. 85);*

*(Ref. 2 – Statut i UST, Neni 11);*

*(Ref. 5 – Rregullore e UST, Neni 15);*

*(Ref. 83 – Vendim Bordi Administrimi Nr. 1, dt. 11.01.2019 mbi*



	<p><i>Miratimin e Objektivave Financiare të vitit 2019);</i>  <i>(Ref. 84- Vendimi i Senatit Nr. 1 datë 10.01.2019 "Për miratimin e objektivave për vitin 2019);</i>  <i>(Ref. 86 - Vendim Senati nr. 45 datë 24.12.2019);</i>  <i>(Ref. 87 - Vendim BA nr. 36 datë 24.12.2019" Raporti vjetor");</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të dëshmojë se garanton qëndrueshmërinë financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.</p>	<p>Të dhënat financiare të vëna në dispozicion të GVJ, dëshmojnë aftësinë e institucionit për të garantuar qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit, sikurse dhe dëshmon kapacitete për gjenerimin e të ardhurave në të ardhmen. UST si dhe çdo program studimi financohet kryesisht nga të ardhurat e krijuara nga çdo program studimi. Gjatë viteve të fundit buxheti i UST ka qenë i mjaftueshëm dhe ka garantuar ecurinë dhe mbarvajtjen me sukses të programit të studimit. Bashkëngjitur referenca e pasqyrës financiare.</p> <p><i>(Ref. 80 - Pasqyrat financiare 2016,2017,2018);</i>  <i>(Apendix Tabela 18);</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plotësisht përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV</b></p>	<p><b>Plotësisht përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

#### IV. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

<p><b>Standardi V.1</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore.</p>	<p>Nga konsultimi i dokumentacionit përkatës, GVJ konstatoi se institucioni, harton dhe zbaton politika, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Institucioni ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik në bazë të akteve ligjore e nënligjore në fuqi, si dhe rregullores e statutit të institucionit, rregullores së fakultetit dhe rregullores së programit të studimit, të hartuara e të përditësuara vazhdimisht në përputhje të këtij legjislacioni. Institucioni ,njësia kryesore dhe njësia bazë për ofrimin e programit</p>




	<p>kujdeset që të ndjekë ecurinë e studentit gjatë gjithë procesit, duke hartuar dhe zbatuar politika dhe procedura përkatëse. Numri i studentëve si dhe shpërndarja e tyre bëhet sipas zërave në tabelën e percaktimit të kuotave të pranimit (studentë për program të dytë studimi, transferime, të huaj, statusin e jetimit, romë dhe balkano egjiptjan si dhe studentë nga trojet) për këtë program studimi. GVJ bazuar në referencat e mëposhtëme konstaton se institucioni harton dhe zbaton politika, në përputhje me legjislacionin në fuqi.</p> <p><i>(Ref. 4 - Ligji Nr. 80/2015, Neni 74);</i></p> <p><i>(Ref. 24 – Vendim Senati Nr. 19, dt 06.04.2018 për kriteret e pranimit për vitin akademik 2019-2020);</i></p> <p><i>(Ref. 25 – Vendim Senatit Nr. 11, dt. 01.10.2019 “Mbi miratimin e kuotave të pranimit të studentëve me kohë të plotë të programeve të studimit per vitin akademik 2019-2020.”);</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje, garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga konsultimi i dokumentacionit përkatës, konstaton se Institucioni garanton barazinë dhe të drejtat e njëjta për të gjithë kandidatët për student, duke bërë transparente kriteret dhe procedurat e pranimit që nga momenti i hyrjes deri në dalje. Procedurat e pranimit në programin e studimit Bachelor “Ne shkencat e Lëvizjes”, mbështeten në kriteret e miratuara me Vendim Senati, dhe u bëhen të ditura studentëve paraprakisht në formë on.line. Detyrimet përmbyllëse të programit të ciklit të parë të studimeve Bachelor janë të përcaktuara në zbatim të VKM nr. 41 si dhe me Vendim Senati.</p> <p><i>(VKM Nr. 41 dt. 24.01.2018, pika gj,v Ref. 47 );</i></p> <p><i>(Vendim Senati Nr. 19, dt 06.04.2018 për kriteret e pranimit për vitin akademik 2019-2020 Ref. 24);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Kriteret, procedurat e pranimit e përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së studimeve të mëparshme ose të pjeshme, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku.</p>	<p>GVJ nga konsultimi i dokumentacionit përkatës rezulton se kriteret dhe procedurat përkatëse për ofrimin e programit të studimit janë hartuar në mënyrë që të jenë të kuptueshme, dhe njëkohësisht dhe të aksesueshme nga publiku.. Nga informacioni i grumbulluar në sekretarinë mësimore ,GVJ konstatoi se kriteret dhe procedurat janë të aksesueshme online se dhe i bëhen të ditura të interesuarve në zyrën e sekretarisë mësimore në oraret e përcaktuara për sqarime dhe shërbime dhe gjatë këshillimit e orientimit të ofruar nga zyra përgjegjëse për informimin e studentëve në rang fakulteti e institucioni. Në fillim të cdo viti akademik Departamenti i Sportit në bashkëpunim me Dekanatin e FSHL organizon takime informuese me studentet e rinj për t’i informuar rreth procedurës së vlerësimit të dijeve si dhe për procedurat e diplomimit mbështetur në Rregulloren e UST si dhe i pasqyron</p>

	<p>ato ne faqen e webit.</p> <p>(Ref. <a href="https://ust.edu.al/bachelor/">https://ust.edu.al/bachelor/</a>);</p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/pranime/">http://fshl.ust.edu.al/pranime/</a></p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/bachelor/">http://fshl.ust.edu.al/bachelor/</a></p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/njoftime/">http://fshl.ust.edu.al/njoftime/</a></p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/udhezues">http://fshl.ust.edu.al/udhezues</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, për t'u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>GVJ konstatoi se përpara çdo viti akademik Institucioni harton, miraton dhe publikon kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve në ciklin e parë të studimeve Bachelor në “Shkencat e Lëvizjes”. Institucioni në rregulloren e tij si dhe me vendim senati ka përpiluar mënyrën e rekrutimit të studentëve në vitin e parë (<i>Vendim Senati Nr. 19, dt 06.04.2018 për kriteret e pranimit për vitin akademik 2019-2020 Ref. 24</i>). Sipas rregullores së UST Matura shtetërore zë 30 % të vlerësimit dhe 70 % e testimi praktik në institucion. Testet praktike miratohen me Vendim Senati si dhe Procedura e zhvillimit të testeve praktike. Vlerësojmë se kriteret dhe procedura e konkursit si dhe pranimit bëhen publike dhe janë lehtësisht të aksesueshme në faqen web dhe në mjetet e tjera të informimit si shtypi i përditshëm dhe llogaritë në rrjetet sociale, etj.</p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Kriteret e përgjithshme dhe ato specifike hartohen dhe zbatohen në përputhje me aktet nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin, si dhe në maturën shtetërore. Kriteret parashikojnë edhe regjistrimin e studentëve të huaj.</p>	<p>GVJ nga dokumentacioni i vënë në dispozicion si dhe takimit me drejtuesit e institucionit si dhe takimi në sekretarinë mësimore konstatoi se pranimi i studentëve në programin e studimit bëhet në bazë të kriterëve të përgjithshme në përputhje me ligjin e arsimit të lartë, akteve nënligjore dhe procedurave që ndiqen në maturën shtetërore, si edhe në bazë të kriterëve specifike për programin e studimit. Pranimi i studentëve në programin Bachelor në Shkencat e Levizjes është rregulluar nëpërmjet Vendimeve të Këshillit të Ministrave si dhe akteve nënligjore të ministrisë përgjegjëse për arsimin si dhe akteve të brendshme rregullatore. Në dokumentet rregullatore, të institucionit, parashikohen kuota për studentët e trojeve. Institucioni ofron kapacitete pritëse për studentët e huaj në kuadër të mobilitetit ERASMUS + bazuar në marrëveshjet përkatëse por deri tani nuk rezulton ndonjë rast i regjistruar. Institucioni ka parashikuar një kuotë modeste për ndjekjen e studimeve nga studentë të huaj. GVJ ndoqi një praktikë të rkrutimit të një studenti në vitin e parë e cila ishte regjistruar sipas rankimit të maturës shtetërore.</p> <p>(<i>Vendim Senati Nr. 19, dt 06.04.2018 për kriteret e pranimit për vitin akademik 2019-2020(Ref. 24 )</i>);</p> <p>(<i>Vendim Senati Nr. 11, mbi miratim e kuotave te pranimit Ref. 25 )</i>);</p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/pranime/">http://fshl.ust.edu.al/pranime/</a></p>
<p><b>Kriteri 6.</b> Përpara fillimit të</p>	<p>GVJ konstatoi nga vlerësimi i dokumentacionin përkatës se</p>



<p>çdo viti akademik, institucioni udhëzon publikun dhe të interesuarit në lidhje me kërkesat e kriteret e përgjithshme e të veçanta të programit të studimit.</p>	<p>përpara fillimit të çdo viti akademik institucioni merr pjesë në fushatat e informimit të organizuara nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë; merr pjesë në aktivitete për promovimin e programit të studimit si dhe proceduara që nga aplikimi deri te konkursi e pranimi i studentëve bëhet publike në faqen zyrtare të institucionit. Institucioni bashkëpunon me DAR/ZA, Shkollat e Mesme të Përgjithshme dhe Profesionale Sportive për informimin e maturantëve me programet e studimit që Fakulteti ofron. Në kuadër të kësaj fushate publikohen fletëpalosje të aprovuara me vendim Rektorati.</p> <p><i>(Fletëpalosje FSHLRef. 52);</i></p> <p><i>(Vendim Rektorati nr. 15 mbi organizimin e ditëve te informimit të maturantëve Ref.38);</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Nuk përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.2</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit, informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin.</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni mbështetës GVJ konstatoi se Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. Informacioni i plotë dhe i hollësishëm gjendet në rregulloren e brendshme të institucionit. Gjithashtu studentet kanë qasje mbi ecurinë akademike përmes account-it në platformën ESSE3, ku ruhen rekordet akademike ndër vite. Studentet informohen në kohe reale në posten e tyre elektronike nëpërmjet sistemit ESSE3 për vlerësimin e tyre nga stafi akademik dhe ofron mundësi të komunikimit të drejtpërdrejtë të tyre.</p> <p><a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p> <p><i>(Rregullore UST, Neni 60, pika 1 Ref.) 5</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni mbështetës rezultoi se kriteret dhe procedurat e njohjes dhe ekuivalentimit të kualifikimeve të mëparshme ose studimeve të pjesshme i bëhen të ditura studentëve dhe janë pjesë e dokumenteve rregullatore. Ai njihet të drejtën e çdo kandidati të</p>



<p>pjesshme.</p>	<p>aplikojë në këtë program studimi mbështetur në aktet ligjore dhe udhëzimet në fuqi bazuar në <i>(Rregullore UST, Neni 60, pika 1 Ref.5)</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës dhe takimeve me studentë konstaton se Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive në programin e studimit. Rregullorja e institucionit parashikon elementet përbërës të vlerësimit të cilat janë të reflektuara në programet/syllabet e lëndëve. Gjithashtu në fillim të vitit akademik, studentëve u vihet në dispozicion programi/syllabusi i çdo lënde të programit të studimit. Kriteret dhe procedurat e testimit përfundimtar të lëndëve/moduleve përcaktohen në Rregulloren e UST.</p> <p><i>(Rregullore UST, Neni 54, 61 Ref. 5)</i></p> <p><a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit.</p>	<p>GVJ nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstatoi se institucioni informon rregullisht studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit të diplomës dhe diplomimit në programin e studimit. Njësia bazë që mbulon programin e studimit në bashkërendim me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve informon studentët për modalitetet e temës së diplomës dhe Provimit të Përgjithshëm Përfundimtar. Rregullorja e për punimin e diplomës, përcakton në mënyrë të detajuar procesin e diplomimit, që nga momenti i aplikimit për temë diplome, miratimin e temës dhe pedagogut udhëheqës, etapat e shkrimit të tezës, e deri te formati final për dorëzim dhe mbrojtje. Gjithë rruga nga përzgjedhja e temës deri në mbrojtjen para komisionit mbështetet në rregulloren e diplomimit. Departamenti përgjegjës (departamenti i Sporteve) publikon brenda muajit nëntor temat e ofruara nga pedagogët e fakultetit për studentë të cilët zgjedhin të mbyllin programin e studimit me temë diplome.</p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/njoftime/">http://fshl.ust.edu.al/njoftime/</a> <a href="http://fshl.ust.edu.al/ep-content/uploads/2018/05/Kerkesa-dhe-Platforma-mikrotezave.pdf">http://fshl.ust.edu.al/ep-content/uploads/2018/05/Kerkesa-dhe-Platforma-mikrotezave.pdf</a></p>
<p><b>Kriteri 5.</b> Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve dhe studentëve të ardhshëm mbi programin e</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni mbështetës rezulton se Institucioni merr pjesë në fushatat e informimit dhe panairove të organizuara me iniciativën e ministrisë përgjegjëse, ashtu si edhe në panairove ndërkombëtare për të promovuar programet e studimit. Gjithashtu UST mban disa “ditë të hapura” ku maturantët mund të vizitojnë nga afër institucionin e të ndjekin edhe orë të caktuara mësimi. Përgjatë ditëve të regjistrimit, njësia kryesore vë në dispozicion të</p>

studimit.	<p>kandidatëve fitues për të vazhduar studimet e larta edhe Manualin e Studentëve, (<i>Fletëpalosje FSHL Ref. 52</i>); si edhe organizon grupe pedagogësh të japin edhe sqarime të mëtejshme në lidhje me organizimin e programit të studimeve, kohëzgjatjen, rregulloren, mundësitë e punësimit dhe mundësitë e transferimit të studimeve në UST.</p> <p>(<i>Guida e UST Ref.26</i>);</p> <p>(<i>Vendim Rektorati Nr. 15 mbi organizimin e ditëve te informimit të maturantëve Ref. 38</i>);</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.3</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve.	<p>Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni mbështetës GVJ konstaton se studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. Institucioni sigurohet që të vërë në dispozicion të studentëve informacionin e nevojshëm rreth strukturës, organizimit dhe kohëzgjatjës së programit të studimit. Informimi bëhet në mënyrë të hollësishme përmes këshillimit me stafin akademik në momentin që interesohen për programet e studimit, kontakteve me Zyrën e Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të Studentëve, dhe vënies së rregullores së brendshme dhe rregullores së programit të studimit në dispozicion të studentëve si dhe takimeve informues e orientues për të gjithë studentët për aspektet e programit të studimit. Cdo informacion është i aksesueshëm në faqen zyrtare të universitetit.</p> <p>(<i>Ref. <a href="http://fshl.ust.edu.al/bachelor/">http://fshl.ust.edu.al/bachelor/</a></i>)</p>
<b>Kriteri 2.</b> Institucioni vë në dispozicion të studentëve të programeve të studimit informacion dhe dokumentacion/udhëzues të posaçëm për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese.	<p>Nga vizita në Institucion dhe dokumentacioni mbështetës GVJ konstaton se në faqen zyrtare Web bëhen publike informacione për modulet, lëndët, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese si struktura e vitit akademik, informacion për lëndët, veprimtaritë formuese etj. Në llogarinë e tyre, në hapsirën didaktike të sistemit ESSE3 studentët aksesojnë strukturën e çdo programi studimi që ofrohet me elementet përbërës në lëndë e module dhe kreditet</p>






	<p>Funksionalitet për aspekte financiare të programit të studimit përfshijnë: menaxhimi i tarifave; bursat; periudha financiare etj. Te dhenat studentore jane dhe ne sistemin ESSE3, i cili është Sistemi i Menaxhimit të Studentëve.</p> <p>(Manual i Studentit Ref. 53);</p> <p>(Apendix Tabela 16, 17)</p>			
<p><b>Kriteri 5</b> Informacioni në lidhje me programin e studimit mundësohet permes sistemit të menaxhimit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jetë lehtësisht i arritshëm nga studentët edhe në distance.</p>	<p>GVJ mbas shqyrtimit të dokumentacionit të vënë në dispozicion mbi informacionin në lidhje me menaxhimin e brendshëm të informacionit konstatoi se sapo regjistrohen si student të programit të studimeve, këta të fundit pajisen nga zyra e TIK me një llogari personal në platformën ESSE3, nga ku aksesojnë Sistemin e Menaxhimit të Informacionit. Edhe në distancë, përmes platformës studentët mund të aksesojnë të dhënat në lidhje me programin e studimit, si edhe të komunikojnë me mesazhe në formë teksti me padagogët e lëndëve.</p> <p><a href="http://fshl.ust.edu.al/udhezues/">http://fshl.ust.edu.al/udhezues/</a></p> <p><a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Plot përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Standardi V.4</b></p> <p><b>Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre përmes një sistemi menaxhimi informatik të brendshëm</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi.</p>	<p>GVJ mbas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës si dhe vizita në sekretarinë mësimore për këtë kriter konstatoi se Institucioni disponon dhe mban statistika vjetore për numrin e studentëve e të diplomuarve për çdo program studimi. Për secilin program studimi, institucioni disponon dhe mban statistika të lidhura me numrin e studentëve të diplomuar dhe cilësinë në dalje.</p> <p>( Rregullore UST, Neni 24, 24/1);</p> <p>(Apendix Tabela 21, 21/1Ref. 5 );</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatoam se Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para</p>


<p>të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve.</p>	<p>përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Këto të dhëna i disponon sekretaria mesimore përmes Sistemit të Menaxhimit të Studentëve ESSE3 si dhe regjistrave hard-copy. Paketa softëare ESSE 3 mundeson një database të dhenash mbi studentet për cikël studimi dhe gjini. Referuar dokumentit (<i>Apendiks Tabela,21</i>), numri i studentëve për këtë program studimi për tre vite akademike është si më poshtë:</p> <p>viti akademik 2017-2018 <b>156 studentë</b>, (6 të transferuar);</p> <p>viti akademik 2018-2019 <b>153 studentë</b>, (3 të transferuar);</p> <p>viti akademik 2019-2020 <b>152 studentë</b>, (2 të transferuar);</p> <p>Nota mesatare në hyrje varion <b>7.41 në 2017, në 7.49 në 2019.</b></p> <p>(<i>Ref.5 Rregullore UST, Neni 24</i>),</p> <p><a href="https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre.</p>	<p>GVJ Nga vizita në Institucion (sekretarinë mësimore) dhe vlerësimi i dokumentacionit mbështetës rezultojnë se Institucioni disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi deri në diplomimin e tyre. Çdo student ka dosjen e tij, ku përmbahen të gjitha të dhënat; nga momenti i regjistrimit e deri në diplomim. Rekordet e studentit ruhen në sistemin elektronik dhe në regjistrat që plotësohen me shkrim. Dega e Informacionit Studentor dhe Regjistrimit është përgjegjëse për ruajtjen dhe administrimin e të dhënave të studentit.</p> <p>(<i>Rregullore UST, Neni 24, 24/1; Ref. 5</i>)</p> <p>(<i>Apendix Tabela 21, 21/1</i>)</p> <p><a href="https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurt dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar.</p>	<p>Nga vizita në Institucion dhe vlerësimi i dokumentacionit mbështetës rezultojnë se të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit UMIS (pjesë e të cilit është dhe ESSE3), ku mundësohet edhe siguria e të dhënave si dhe aksesit nga personat e autorizuar Sistemi i Menaxhimit të Informacionit të Universitetit (UMIS) është një sistem informatik funksional dhe efektiv, i cili ruan, administron dhe përpunon të gjitha të dhënat e studentit, atyre akademike, prodhimin e raporteve statistikore si dhe disa aspekte të tjera në funksion të programit të studimit si financat studentore. Përmbajtja e informacioneve/njoftimeve që lidhen me UMIS administrohen nga sektori i TIK, pranë Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse. Cdo student dhe personel</p>

	<p>akademik ka aksesin të shohë të dhënat, nëpërmjet e.maileve të tyre personale.</p> <p>(Manual i Studentit Ref.53);</p> <p><a href="https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://ëëë.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni duhet të hartojë raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve.</p>	<p>GVJ mbas shqyrtimit të dokumentacionit mbështetës për këtë kriter konstaton se Institucioni harton raporte analitike periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallës së cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. Në fund të vitit kalendarik departamenti përgjegjës për programin e studimit analizon dhe harton një raport analitik mbi arritjen e objektivave formuese të programeve të studimit dhe rezultateve të pritshme të të nxëniet dhe aftësimit profesional, me qëllim për të identifikuar nevojat për përmirësime në të ardhmen. Një kopje e raportit të kësaj analize i përcillet dekanatit, që nga ana e vet i përpunon këto edhe mbi bazën e raporteve të ardhura nga departamentet e tjera, për të hartuar një raport analitik në nivel njësie kryesore. Ky raport shërben si bazë për hartimin e objektivave për vitin pasues. Mbi këtë bazë konkludojmë se kriteri përmbushet plotësisht</p> <p>(Analizë Vjetore e Departamentit);</p> <p>(Apendix Tabela 21, 21/1 Ref. 17);</p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Në përmbushje</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.5</b>	
<b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programeve të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë IAL-ve.</p>	<p>GVJ nga vlerësimi i dokementacionit përkatës konstaton se Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të UST-së. Studentët përfshihen në vendimmarrjen e universitetit, përmes përfaqësimit të tyre në organet drejtuese të institucionit dhe në strukturat mësimore-kërkimore. Më kryesoret përmendim:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Këshilli i Studentëve në rang njësie kryesore dhe</li> </ul>




	<p>univeristeti;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>▪ Senati Akademi;</li> <li>▪ Këshilli Etikës;</li> <li>▪ NJSBC;</li> </ul> <p>Pjesmarrja e studentëve në vendim marrje përcaktohet nga ligji i arsimit të lartë 80/2015, rregullore e institucionit si dhe me vendim senati sipas referencave të mëposhtëme.</p> <p><i>(Ref. 54 – Vendim Senati Nr. 30, dt. 10.11.2016 per Ngritjen e Grupit te Punës për hartimin e Rregullores se Funkcionimit të UST)</i>  <i>(Ref. 55 – Vendim Senati Nr. 33, dt. 10.11.2016 për Ngritjen e grupit te punes per hartimin e Statutit te UST);</i>  <i>(Ref. 56 – Vendim Senati Nr. 34, dt. 10.11.2016 per Ngritjen e grupit te punes per hartimin e dokumentacionit e plote te hapjes se Fakultetit të Tretë të UST);</i>  <i>(Ref. 57 – Vendim Senati Nr. 32, dt. 10.11.2016 per Ngritjen e grupit te punes per hartimin e Rregullores se Etikes të UST);</i>  <i>(Ref. 58 - Shkrese Nr. 48, date 08.01.2019 per perzgjedhjen e librave së huaj për përkthim nga MASR);</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni duhet të garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës GVJ konstatoi se UST garanton se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik është reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. Përpara përfundimit të semestrit studentët bëjnë vlerësimin të programit të studimit në bazë lënde, përmes pyetësorit që plotësojnë, i cili garanton anonimatin e studentëve. Instrumenta të tjerë janë dhe “Focus Group-et” dhe intervistatet gjysmë të strukturuar, me grupe studentësh të programeve përkatëse, për të trajtuar shqetësimet dhe pritshmëritë e tyre. Departamenti përgjegjës për programin e studimit merr masa që një anëtar student të bëjë pjesë në grupin e punës për rishikimin e programeve/syllabeve të lëndëve. Të dhënat e mbledhura nga këto instrumente, janë pjesë e diskutimeve në nivel drejtues të institucionit, me qëllim evidentimin e situatës dhe marrjen e masave për përmirësim të vazhdueshëm. Një student i programit është pjesë e GVB-së të ngritur në kuadër të hartimit të këtij raporti. Gjithashtu një student është pjesë e NJSBC.</p> <p><i>Sugjerojmë realizimin e anketimeve të posacme për cdo lëndë apo pedagog me qëllim evidentimin më të hollësishëm e problematikave pasi aktualisht pyetësorët nuk ofrohen për cdo lëndë apo cdo pedagog.</i></p> <p>Studentët konsiderohet një vlerë e shtuar dhe aset i vyer për vendimmarrjet nga organet drejtuese të Universitetit dhe Fakultetit bazuar në referencat e mëposhtme.</p>




	<p><i>(Ref. 54 – Vendim Senati Nr. 30, dt. 10.11.2016 per Ngritjen e Grupit te Punës për hartimin e Rregullores se Funksionimit të UST)</i></p> <p><i>(Ref. 55 – Vendim Senati Nr. 33, dt. 10.11.2016 për Ngritjen e grupit te punes per hartimin e Statutit te UST);</i></p> <p><i>(Ref. 56 – Vendim Senati Nr. 34, dt. 10.11.2016 per Ngritjen e grupit te punes per hartimin e dokumentacionit e plote te hapjes se Fakultetit të Tretë të UST);</i></p> <p><i>(Ref. 57 – Vendim Senati Nr. 32, dt. 10.11.2016 per Ngritjen e grupit te punes per hartimin e Rregullores se Etikes të UST);</i></p> <p><i>(Ref. 58 - Shkrese Nr. 48, date 08.01.2019 per perzgjedhjen e librave së huaj për përkthim nga MASR.);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në hartimin dhe përmirësimin e programeve të studimit, institucioni duhet të mbajë parasysh ngarkesën akademike të studentëve në programin e studimit dhe parashikimin e procedurave joburokratike të përparimit të studentëve përgjatë programit, përfshirë njohjen e studimeve të plota apo të pjesshme të mëparshme.</p>	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin si dhe takimet me studentët GVJ konstatoi se programi i studimit i nënshtrohet në mënyrë periodike rishikimit në kuadër të përmirësimit të vazhdueshëm, bazuar në parashikimet ligjore në fuqi. Shpërndarja e lëndëve nëpër semestra dhe ngarkesës së shprehur në kredite bëhet mbi parimin e një shpërndarje të balancuar në semestra. Kriteret dhe procedurat që ndiqen për studentët që duan të transferojnë studimet e tyre në UST janë të parashikuara në dokumentet rregullatorë të institucionit. Ngarkesa mësimore e personelit akademik parashikohet në përputhje me numrin e grupeve të studentëve, si për leksionet ashtu edhe për seminarët.</p> <p><i>(Ref. 57 – Vendim Senati Nr. 32, dt. 10.11.2016 per Ngritjen e grupit te punes per hartimin e Rregullores se Etikes të UST)</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to.</p>	<p>GVJ nga konsultimi me dokumentacionin si dhe takimet me studentët konstaton se UST garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit mbi baza të rregullta dhe të reflektojë sugjerimet e kontributin e tyre në to. Përfshirja e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programeve të studimit realizohet përmes Pyetësorit me studentët, fokus grupeve. Pyetësori organizohet dy herë në vit, në përfundim të çdo semestri, për të gjitha programet e studimit. Ndër elementët që vlerësohet është edhe silabusi i lëndës. Takimet këshilluese të studentëve me përfaqësues të Zyrës së Këshillimit, Informimit dhe Orientimit të studentëve, në disa raste edhe në praninë e koordinatorit të programit. Gjetjet e tyre, bëhen pjesë e diskutimeve, raporteve analitike semestrale e vjetore, dhe mund të shoqërohen me ndryshime në programin e studimit. Sugjerimet e tyre janë reflektuar në programin e ri ku studentet kanë shprehur dhe miratuar riorganizimin e këtij program studimi.</p> <p><i>(Ref. 63 – Vendim Senati Nr. 20, dt. 16.05.2018 “Mbi miratimin e</i></p>

	<i>Planit mësimor të ciklit të parë të studimeve Bachelor”)</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës.	<p>Nga konsultimi me dokumentacionin si dhe takimet me studentët GVJ konstatoi se studentëve u mundësohet të japin mendim mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit e kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. Mënyra e kontrollit dhe vlerësimit të dijeve është një proces transparent, i cili shprehet në rregulloret e brendshme dhe pasqyrohet në programin/silabusin e secilës lëndë. Tezat e sekretuara, shpjegimet e pedagogut për vlerësimin, rishikimi i tezës dhe çelësit të përgjigjeve, dhe mundësia për rivlerësim nga një komision i posaçëm, janë tregues të transparencës dhe barazisë së procesit të vlerësimit. Studentët kanë mundësi të parashhtrojnë kërkesat e tyre duke ndjekur procedurat e parashikuara në rregulloren e institucionit. Përgjegjësi i departamentit kur e gjen të pamundur zgjidhjen e ankesës, vë në dijeni Dekanin, i cili brenda 48 orësh pas ankesës nga përgjegjësi i departamentit, ngre një komision <i>ad-hoc</i> i cili bën verifikimin e pretendimeve të studentit. Me miratim të Dekanit, komisioni përcakton vlerësimin përfundimtar të provimit ose mund të marrë vendim për rihvillim të provimit. Po kështu departamenti ben realizimin e anketimeve të posacme për cdo lëndë apo pedagog me qëllim evidentimin e problematikave.</p> <p><i>(Ref. 5 – Rregullore UST, Neni 56, 57)</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Përmbyshet plotësisht</b>	<b>Përmbyshet pjesërisht</b>	<b>Përmbyshet kryesisht</b>	<b>Përmbyshet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi V.6</b>	
<b>Institucioni ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimeve e problematikave, të cilat operojnë në mënyrë permanente e janë lehtësisht të arritshme e të përdorshme nga studentët</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të	GVJ nga konsultimi me dokumentacionin përkatës rezulton se Insitucioni siguron informim, këshillim e orientim për studentët e të gjithë programeve dhe të gjithë cikleve të studimit, si në nivel institucional dhe në nivel njësie kryesore. Gjithashtu institucioni përdor për komunikimin e brendshëm e-mail zyrtare. Çdo anëtar i intitucionit ka adresën zyrtare të



IAL-ve.	<p>e-mailit (...@ust.edu.al).</p> <p>(Ref. <a href="http://www.ust.edu.al">www.ust.edu.al</a> Email)</p> <p><a href="mailto:contact@ust.edu.al">contact@ust.edu.al</a></p> <p>(facebook: Fakulteti i Shkencave të Lëvizjes)</p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se Institucioni ka të ngritur dhe funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe asistimin e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. Rezulton se Koordinimi i aktivitetit të zyrave të këshillimit në rang fakulteti me aktivitetin e zyrës në nivel institucioni për asistencës së vazhdueshme ndaj studentëve, madje edhe pas përfundimit të studimeve janë në një nivel të kënaqshëm. Me ane të komunikimit direkt (ESSE3 softëra) studentin, stafi akademik mban lidhje për procesin mësimor, mungesat apo vlerësimin teorik apo praktik.</p> <p><a href="https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do">https://www.ust.esse3.u-gov.rash.al/Home.do</a></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës.</p>	<p>GVJ nga konsultimi me dokumentacionin si dhe takimet me studentët konstatojmë se studentëve u ofrohet shërbim i vazhdueshëm i këshillimit të karrierës. Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni si dhe zyra e këshillimit të fakultetit është në shërbim të studentëve duke ofruar informacion në lidhje me mundësi punësimi, apo aktivitete studentore që zhvillohen brenda ose jashtë vendit, duke ofruar njëkohësisht asistencë për kryerjen e aplikimeve apo këshillimin e nevojshëm. Studentet informohen rregullisht në funksion të zhvillimit të praktikave profesionale/intershipeve të studentëve pranë këtyre institucioneve, por edhe në kuadër të punësimit të ardhshëm të studentëve në këto kompani e organizatae.</p> <p>(Ref. 43 – Orari i pritjes studenteve FSHL);</p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e autoriteteve drejtuese përkatëse.</p>	<p>GVJ nga konsultimi me dokumentacionin si dhe takimet përkatëse konstatojmë se Drejtoria e Koordinimit, Marrëdhënieve me Jashtë, Këshillimit të Karrierës, Alumni mban kontakte me studentët e diplomuar dhe është duke krijuar një bazë të dhënash në lidhje me punësimin e tyre apo vazhdimin e studimeve në UST, pjesëmarrje në trajnime pasuniversitare, apo edhe oferta arsimimi në institucione të tjera brenda dhe jashtë vendit përmes platformës <a href="http://alumni.ust.edu.al/">http://alumni.ust.edu.al/</a>.</p> <p>Sugjerojmë që Institucioni duhet të marrë masa më konkrete për ta bërë me efektive përdorimin e platformës <a href="http://alumni.ust.edu.al/">http://alumni.ust.edu.al/</a></p>






Shkalla e përmbushjes së standardit	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X

Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V	Përmbushet plotësisht	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht
				X


## VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMEVE TË STUDIMIT BACHELOR

**Standardi VI.1**  
**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programeve të studimit në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisët**

Kriteret	Vlerësimi i ekspertëve
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë, në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale.</p>	<p>Nga vlerësimi i dokumentave të vëna në dispozicion nga UST konstaton se Institucioni i kushton vëmendje të veçantë sigurimit të brendshëm të cilësisë, për të garantuar që veprimtaria e tij jo vetëm është në përputhje me dispozitat e legjislacionit në fuqi, të Statutit dhe të akteve të tjera të brendshme rregullatore, duke përdorur mekanizma të sigurimit të cilësisë në disa aspekte. Kjo njësi është organizuar për të kryer detyrat që i jep ligji Nr.80/2015 për Arsimin e Lartë në RSH dhe udhëzimet përkatëse nga MASR.</p> <p><i>(Ref. 15 - Vendim nr.16 dt 27.02.2018 të Senatit Akademik për ngritjen e NJSBC);</i></p> <p><i>(Ref. 6- Rregullore për Organizimin dhe punën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UST, Neni 1.);</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni ka të ngritur dhe funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm.</p>	<p>GVJ vlerëson se Institucioni ka të ngritur dhe e ka bërë funksional Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë si dhe zbaton një strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen edhe studentët dhe si dhe ka angazhuar bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. Në përbërje të NJSBC janë 3 pedagogë dhe 2 studentë, si dhe janë angazhuar 2 eksperte. Në grupet e punës për Sigurimin e Cilësisë në njësinë bazë rezulton se janë të angazhuar edhe studentë. Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC), e ka nisur punën që me krijimin e institucionit, fillimisht në formën e grupeve dhe komisioneve. <i>Ad hoc</i>, dhe që nga mars 2018 në formën e një njësie të përhershme në strukturën organizative të institucionit. Njësia vlerëson periodikisht efikasitetin dhe produktivitetin e</p>




	<p>veprimtarive mësimore e kërkimore shkencore të UST-së NJSBC ka akses në të gjitha të dhënat e institucionit dhe kryen kontrole në bazë të strategjisë së UST-së 2017-2020 dhe Planit të Veprimit të Senatit Akademik. Ngritja e organeve drejtuese, sikurse dhe angazhimi në NJSBC i ekspertëve të jashtëm, i përgjigjet gjithashtu nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorë të jashtëm. Për të mbështetur objektivat e sigurimit të cilësisë pranë Departamentit është ngritur grupi i punës për sigurimin e cilësisë së programit të studimit në të cilën përfshihen 3 pedagogë dhe një student, ky i fundit i propozuar nga Këshilli Studentor. Njësia bashkëpunon me njësitë kryesore, Administratoren e UST dhe zëvendës Rektorët të cilët mbështesin kërkesat dhe veprimtarinë e saj.</p> <p><i>(Ref. 6- Rregullore për Organizimin dhe punën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UST);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë, Sigurimi i Jashtëm i Cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë.</p>	<p>GVJ nga vlerësimi i dokumentave të vëna në dispozicion nga UST dhe vizita në Institucion konstatojmë se Sigurimi i cilësisë realizohet përmes:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Monitorimit nga ana e strukturave drejtuese;</li> <li>- Tërheqjes së mendimit të studentëve me metoda të drejtpërdrejta dhe të tërthorta;</li> <li>- bashkëpunimit me partnered;</li> <li>- bashkëpunimin me subjekte të Tregut të Punës;</li> <li>- bashkëpunimit me ASCAL-in dhe struktura të tjera shtetërore e duke ju nënshtruar në mënyrë periodike vlerësimeve të jashtme;</li> <li>- zbatimit të rekomandimeve të lidhura me akreditimin e pare institucional;</li> <li>- auditimeve të ushtruara nga MASR, auditimet periodike nga MASR mbi punën mësimore shkencore dhe financiare;</li> <li>- vizitave periodike monitoruese të MASR mbi kapacitetet akademike dhe infrastrukturore në funksion të miratimit të kuotave për çdo vit akademik.</li> </ul> <p>Vlerësimet e brendshme, analitike apo krahasuese kryhen në mënyrë periodike nga NJSBC, departamentet dhe dekanati siç janë analizat vjetore të cilat kryhen për të përmirësuar cilësinë.</p> <p><i>(Ref. 6 - Rregullore për Organizimin dhe punën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UST, Neni 4,5. Ref. 17)</i></p> <p><i>(Analiza vjetore);</i></p>



<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron, në kuadër të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Ato synojnë krijimin e kulturës së cilësisë në rang institucional, të njësive përbërëse dhe të gjithë aktorëve të brendshëm të institucionit.</p>	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës GVJ konstatoi se institucioni ka hartuar një politikë të qartë dhe ndjek procedura periodike për sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së programeve të studimeve që ofron përmes analizave vjetore, si dhe relacionet periodike, të cilat tregojnë për një bashkërendim të punëve midis personelit dhe përfshirjes së studentëve. Punonjësit realizojnë detyrat në përputhje me legjislacionin në fuqi si dhe rregulloret e brendshme të UST, FSHL si dhe rregulloren e programit të studimit duke garantuar rigorozitet në evidentimin e problemeve dhe efikasitet në zgjidhjen e tyre. Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plani kalendarik të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me gjetjet përkatëse dhe rregullores së kësaj njësie.</p> <p><i>(Raporti i fokus grupeve të studentëve i NJSBC Ref. 61)</i>  <i>(Raportet e Analizës së pyetësorëve të studentëve e NJSBC Ref. 16 );</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p>	<p><b>Përbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VL2</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë monitoron dhe vlerëson përmes njësive të posaçme e në mënyrë periodike programet e studimit, për të garantuar arritjen e objektivave formuese dhe rezultateve të synuara të të nxënit.</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni ngre njësi të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ mbas konsultimit me domentacionin përkatës dhe vizitës në Institucion arriti në përfundimin se UST ka të ngritur struktura funksionale të posaçme për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve të studimit të ciklit të parë. Po listojmë si me poshtë vijon:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë e NJSBC-ja, e cila vepron në nivel institucional dhe është përgjegjëse për monitorimin e cilësisë në të gjithë programet e studimit;</li> <li>- Njësia bazë ,ku përgjegjësit e lëndëve/modulit, koordinatori i programit si dhe grupet e punës që ngrihen për monitorimin, shqyrtimin, mbikëqyrjen, rishikimin e programeve luajnë një rol shumë të rëndësishëm në këtë drejtim. Njësia bazë merr masa për zbatimin e detyrave sipas përcaktimeve në Statut dhe detajimeve në dokumentat e tjera rregullatorë;</li> </ul>



	<p>- Takimet me përfaqësues nga tregu i punës kanë gjithashtu një kontribut të rëndësishëm pasi reflektojnë dinamikën dhe kërkesat që vijnë nga tregu (që merren gjatë zbatimit të praktikës profesionale dhe programeve “out doors” dhe ëorkshop-eve);</p> <p>- Në takime me student bëhen diskutime të hapura mbi aspekte që lidhen me monitorimin dhe rishikimin e programit bachelor;</p> <p>Rekomandimet nga aktorët e përfshirë shërbejnë si bazë për ndryshime në kurrikula në funksion të përshtatjes sa më mirë me këto kërkesa. “Departamenti i Sportit” në FSHL ka përcaktuar koordinatoren dhe grupin e punës për të ndjekur mbrëvajtjen e programit të studimit duke organizuar takime e degjese me student, grup studentesh dhe keshillin studentor.</p> <p><i>(Ref. 14 - Vendim i Dekanit për emerimin e koordinorit të programit të studimit);</i></p> <p><i>(Ref. 15 - Vendim Senatit Akademik Nr.16 dt 27.02.2018 të për ngritjen e NJSBC);</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përdor mekanizma e procese formale e të dokumentuara, për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve të ciklit të parë.</p>	<p>GVJ mbas konsultimit me domentacionin përkatës konstatoi se UST përgatit dhe shpërmdan në formën e një analize vjetore vlerësimet periodike mbi shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e programeve të studimit, i cili u vihet në dispozicion strukturave drejtuese, por edhe pedagogëve, sikurse dhe aktorëve të tjerë të interesuar. Janë kryer takime me fokus grupe me studentë të ciklit bachelor. Pyetësorët dhe anketimet e kryera analizohen dhe pasqyrohen në raportet periodike të NJSBC të cilat me pas shqyrtohen nga instancat përkatëse për të reflektuar në përmirësimin e programit dhe të infrastrukturës mësimore. Përveç pyetësorëve të NJSBC grupi i punës i departamentit përgjegjës për programin e studimit ka organizuar takime me fokus grupe studentësh të këtij cikli për të dëgjuar sugjerimet dhe mendimet e tyre me synim reflektimin në përmirësimin e vazhdueshëm të programeve. Këto raporte janë pjesë e diskutimit/prezantimit në nivel departamenti, diskutimit/prezantimit në nivel fakulteti dhe në nivel rektorati.</p> <p><i>(Ref. 6- Rregullore për Organizimin dhe punën e Njesisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë në UST, Neni 4.);</i></p> <p><i>(Ref. 18 - Model pyetësori i NJSBC për studentët);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programeve të</p>	<p>GVJ vlerëson se Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë dhe mbarëvajtjen e programit të studimit. Raportet mbi aktivitetet me karakter kontrollues, monitorues dhe vlerësues që</p>



studimeve.	<p>organizohen nga Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë (NJSBC) në nivel universiteti dhe grupi i punës i Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë së Programit Bachelor “Në Shkencat e Lëvizjes”, grupi i punës për Ndryshimet në Kurrikulën e programit, raporton pranë departamentit dhe dekanatit. Mbi këtë bazë njësia bazë dhe njësia kryesore organizojnë mbledhje të posacme për të diskutuar mbi rekomandimet dhe gjetjet e raporteve. Zbatimi i detyrave që lidhen me garantimin e cilësisë së programit të studimit ndiqen nga ana e strukturave drejtuese.</p> <p><i>(Ref. 16 - Raport i analizës së pyetësorit të NJSBC për studentët.);</i>  <i>(Ref. 17 – Analiza vjetore të departamentit);</i></p>			
<b>Kriteri 4.</b> Rezultatet e këtyre vlerësimeve dokumentohen dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse dhe vendimmarrëse për programin e studimit.	<p>GVJ konstatoi se rezultatet e vlerësimit të cilësisë së programeve të studimit hartohen në formë raporti dhe u bëhen të njohura autoriteteve përgjegjëse, përgjegjësit të departamentit, stafit akademik, etj.</p> <p><i>(Analiza vjetore e FSHL dhe UST i grupit të punës për sigurimin e cilësisë në programin e studimit, datë 22.10.2019)</i></p>			
<b>Kriteri 5.</b> Raportet e vlerësimit duhet të përfshijnë rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe masat e marra për adresimin e mangësive dhe përmirësimin në vijim të cilësisë.	<p>Nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës rezulton se raportet e vlerësimit evidentojnë përputhshmërinë e aktiviteteve me aktet rregullatore dhe standardet e cilësisë. NJSBC, grupi i sigurimit të cilësisë në programin e studimit Bachelor “Në Shkencat e Lëvizjes”, Zyra e Kurrikulës si dhe strukturat e tjera të përfshira në sigurimin e brendshëm të cilësisë monitorojnë procesin e marrjes së masave në kuadër të adresimit të problematikave apo mangësive.</p> <p><i>(Ref. 16 - Raport i analizës së pyetësorit të NJSBC për studentët);</i>  <i>(Ref. 17 – Analiza vjetore të departamentit);</i></p>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	Në përmbushje	Përmbushet pjesërisht	Përmbushet kryesisht	Përmbushet plotësisht <b>X</b>

### Standardi VI.3

**Institucioni përdor procedura e metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për hapjen, zhvillimin dhe ecurinë e programeve të studimit, diplomimin dhe daljen në tregun e punës apo studimeve të mëtejshme të studentëve**


#### Kriteret

#### Vlerësimi i ekspertëve

**Kriteri 1.** Vlerësimi i brendshëm i programit të studimit kryhet në mënyrë periodike nga njësia e brendshme e cilësisë që lidhet

GVJ nga shqyrtimi i dokumentacionit përkatës përkates rezulton se vlerësimi nga NJSBC bëhet në nivel institucional (3 anëtarë nga stafi akademik dhe 2 studentë) dhe s i i tillë shtrihet në të gjithë programet e studimit dhe

<p>me këtë program studimi. Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional në kuadër të akreditimit apo të vetëvlerësimeve të brendshme periodike.</p>	<p>nuk hartohen relacione specifike në bazë programi, por nga analiza e përgjithshme, departamenti përgjegjës për ofrimin e programit të studimit evidenton elementët që lidhen me programin. Në vijim të raporteve dhe rekomandimeve të NJSBC realizohen dhe relacione nga grupi i punës në nivel departamenti për sigurimin e brendshëm të cilësise të programit të studimit, si dhe realizohen analiza periodike të punës mesimore dhe kërkimore shkencore duke siguruar informacione të vlefshme për vetëvlerësimin në kuadër të akreditimit institucional dhe programit të studimit. Të gjithë pyetësorët përpunohen dhe mendimet e shprehura i paraqiten me shkrim rektorit. Rezultatet e tyre bëhen pjesë e diskutimeve në Senat, në analizat vjetore apo semestrale te departamentit dhe fakultetit..</p> <p><i>(Ref. 16 - Raport i analizës së pyetësorit të NJSBC për studentët);</i> <i>(Ref. 17 – Analiza vjetore të departamentit);</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Për kryerjen e vlerësimit, institucioni përdor metoda e instrumente të ndryshme, të posaçme e të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës akademike të programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga konsultimi dhe vlerësimi i dokumentacionit vihet re se UST për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta dhe të drejtpërdrejta duke përdorur instrumente efikase dhe të përshtatshme në përputhje me natyrën dhe specifikën e fushës së “Shkencave të Lëvizjes”. me synim plotësimin e objektivave të programit të studimit. Disa prej metodave që UST përdor për kryerjen e vlerësimeve përfshijnë: monitorimi dhe kontrollin e elementëve të lidhur me proceset akademike të mësimdhënies/mësimnxënies si:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- mbarëvajtja e provimeve, program/syllabus-et,</li> <li>- literature e përdorur,</li> <li>- infrastruktura TIK,</li> <li>- ambientet sportive etj.</li> </ul> <p>Instrumentet të tjera që përdoren për përfshirjen e studentëve janë përmes pyetësorëve, fokus grupet, prezantimet orientuese/diskutimet me studentët, mbledhjet e hapura mbi aspekte të caktuara të programit të studimitetj.</p> <p><i>Sugjerojmë që krahas anketimeve aktuale të realizohen edhe sondazheve në mënyrë më të personalizuar për secilin lëndë/modul, vlerësimeve dhe vetëvlerësimeve për secilin pedagog dhe anëtar të stafit administrative.</i></p> <p><i>Strukturat drejtuese të UST-së duhet të ndërmarrin iniciativa për ndërgjegjësimin e stafit dhe studentëve me synim realizimin e një procesi vlerësimi më të detajuar e</i></p>



	<i>transparent por që respekton të drejtat dhe konfidencialitetin e palëve.</i>
<p><b>Kriteri 3.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës, testimet lokale apo të standardizuara, rezultatet e arritura në testimet ndërinstitucionale apo kombëtare si provimi i shtetit për profesionet e rregulluara dhe të tjera.</p>	<p>GVJ nga konsultimi dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstaton se UST, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda të drejtpërdrejta, si vlerësim i cilësisë së mësimdhënies, vlerësim të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit, vlerësime paralele të provimeve apo detyrave të studentëve, vëzhgime në auditor gjatë kryerjes së ushtrimeve/ praktikës. UST, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit, përdor metoda të drejtpërdrejta, si:</p> <p>Teste të standardizuara Teorike</p> <p>Teste të standardizuara Praktike</p> <p>Dëgjime në auditor;</p> <p>Vlerësimi me pikë;</p> <p>Testimete ndërmjetëm dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;</p> <p>Vlerësimi i punëve në grup/detyrave/projekteve të kryera nga studentët;</p> <p>Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës</p> <p>Nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstatohet se për stafin akademik të kategorisë Lektor dhe Asistent Lektor zhvillohen dhe vizita nga eprori (Përgjegjësi Njësisë bazë/Dekani) gjatë zhvillimit të një ore mësimi. Ky proces përfundon me këshillime individuale me Përgjegjësin e Departamentit dhe mund të diskutohet në mbledhje të posaçme duke respektuar të drejtat dhe etikën akademike në varësi të problematikës. Këto vlerësime identifikojnë kryesisht kalueshmërinë dhe notën mesatare të cilat në vetevete mund të nxjerrin në pah dhe efikasitetin e mësimdhënies dhe nxënies në secilën prej lëndëve që zhvillohen në programin e studimit.</p> <p><i>(Ref. 17 – Analiza vjetore të departamentit);</i></p> <p><i>(Ref. 10 - Programet lëndore, mënyra e vlerësimit të studentëve);</i></p>
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit përdor metoda e instrumente të tërthorta vlerësimi si sondazhe e intervista</p>	<p>GVJ nga vizita në Institucion dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstaton se, në kuadër të vlerësimit të realizimit, mbarëvajtjes e cilësisë së programit të studimit UST përdor metoda e instrumente të tërthorta. Metodatat dhe Instrumente të tërthorta që përdoren kryesisht</p>

<p>të studentëve, të atyre të diplomuara (alumni), të personelit akademik, ndihmësakademik e administrativ, punëdhënësit e institucionet që bashkëpunojnë në realizimin e programit të studimit dhe palëve të tjera që përfshihen në realizimin apo që shërbejnë për vlerësimin e dijeve e kompetencave të përftuara nga ky program.</p>	<p>përfshijnë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Sondazhe/Anketime:të studentëve që ndjekin programet e studimeve,</li> <li>- Fokus Grupe me Studentë</li> <li>- Intervista Inviduale/ në Grup</li> <li>- Diskutime të hapura</li> <li>- Pyetje konceptuale;</li> <li>- Intervista</li> <li>- Takime dhe tërheqje mendimi nga studentët alumni</li> <li>- Takime dhe tërheqje mendimi nga përfaqësues të Tregut të Punës</li> <li>- Studime Kombëtare dhe analiza për Tregun e Punës</li> </ul> <p>Rezultatet e vlerësimeve të studentëve i vihen në dispozicion të drejtuesve të institucionit, atyre të fakulteteve si dhe reflektohen në analizën e punës mësimore shkencore vjetore në përfundim të vitit akademik. Mbi këtë bazë konkludojme se UST kryen në mënyrë të rregullt vlerësimin e veprimtarisë akademike dhe administrative përmes metodash të tërthorta, kryesisht në formën e sondazheve me të gjithë studentët, që ndjekin programin e studimeve.</p> <p><i>(Ref. 18 - Model pyetësori i NJSBC për studentët);</i>  <i>(Ref. 16 - Raport i analizës së pyetësorit të NJSBC për studentët);</i>  <i>(Ref. 61 - Model anketimi me fokus grupet e studenteve);</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p><b>Në përmbushet</b></p>	<p><b>Përmbushet pjesërisht</b></p>	<p><b>Përmbushet kryesisht</b></p>	<p><b>Përmbushet plotësisht</b></p> <p style="text-align: center;"><b>X</b></p>

<p><b>Standardi VI.4</b></p>	
<p><b>Institucioni i arsimit të lartë përfshin njësitë akademike, personelin e studentët në proceset e SBC-së të programeve të studimit dhe informon palët e interesuara në lidhje me rezultatet dhe masat e marra në vijim të tyre</b></p>	
<p><b>Kriteret</b></p>	<p><b>Vlerësimi i ekspertëve</b></p>
<p><b>Kriteri 1.</b> Institucioni duhet të parashikojë dhe garantojë në politikat dhe procedurat e brendshme të cilësisë përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të</p>	<p>GVJ nga vizita në Institucion dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstaton se Institucioni ka hartuar dhe zbatuar politika dhe procedurat e brendshme të cilësisë për përfshirjen e aktorëve të brendshëm dhe të jashtëm të interesuar për sigurimin dhe përmirësimin e vazhduar të cilësisë së programit të studimit. Përmendim si më poshtë vijon:</p>






<p>cilësisë së programit të studimit.</p>	<ul style="list-style-type: none"> <li>- Marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucione Partnere</li> <li>- Marrëveshjet e bashkëpunimit nga fushës së biznesit</li> <li>- Marrëveshjet e bashkëpunimit me Institucione shtetërore që operojnë në sektor</li> <li>- Angazhimi në NJSBC ekspertëve të jashtëm</li> </ul> <p>Të gjithë këta faktore i përgjigjen gjithashtu nevojës së institucionit për t'u konsultuar me aktorë të brendshëm e jashtëm. Konkludojme se aspektet pozitive të përfshirjes me aktorë të brendshëm e jashtëmbazohen në shkëmbimin e përvojave, njohjen me qasje novatore, trajnimet dhe vizitat studimore, sikurse dhe me rishikimin e akteve rregullore, metodologjisë dhe instrumenteve për monitorimin dhe vlerësimin e proceseve në funksion të sigurimit të brendshëm të cilësisë.</p> <p><i>(Ref. Vendimet për ngritjen e grupeve të vlerësimit të sigurimit të cilësisë);</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave.</p>	<p>Nga vizita në Institucion takimi me stafin, studentët si dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës GVJ konstatoi se institucioni përcakton përgjegjësi dhe detyra konkrete për njësitë, individët, studentët dhe palë të tjera të angazhuara në sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit dhe garanton ushtrimin me përgjegjësi të këtyre detyrave, përgjegjësitë janë të përcaktuara në aktet rregullore të institucionit të përmendura në kritere të mësipërme.</p> <p><i>(Ref. Vendime të dekanatit për ngritjen e grupeve të vlerësimit);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Në vlerësimin dhe sigurimin e cilësisë së programit të studimit duhet të garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarët e personelit akademik, ndihmësakademik e administrative dhe studentët e programit të studimit.</p> <p><b>Kriteri 4.</b> Përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit duhet të respektojnë integritetin akademik dhe të shmangë çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe studentëve.</p>	<p>GVJ nga vizita në Institucion dhe takimi me stafin , studentët si dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstatoi se në planin e veprimit të Senatit Akademik për sigurimin e brendshëm të cilësisë garantohet përfshirja e njësisë bazë dhe kryesore, përgjegjëse për programin e studimit, anëtarëve të personelit akademik, ndihmës akademik e administrative dhe studentët e programit të studimit. Në përbërjen e NJSBC (në nivelin Institucional) janë 3 anëtarë të stafit akademik dhe 2 studentë. Në strukturën e grupit të punës për sigurimin e brendshëm të cilësisë së programit të studimit, të ngritur pranë njësisë bazë, që mbulon programin e studimit bëjnë pjesë 3 pedagogë dhe një përfaqësues i studentëve, i propozuar nga Këshilli i Studentëve. GVJ konstatoi se përfshirja dhe aktivizimi i aktorëve të brendshëm në proceset ciklike të vlerësimit respekton integritetin akademik dhe se Institucioni ka marrë masa për të shmangur çdo lloj diskriminimi apo pabarazie kundrejt personelit dhe</p>

	studentëve. <i>(Ref. 14 - Vendim Dekanati për emerimin e koordinatorit të programit të studimit);</i>			
<b>Kriteri 5.</b> Pjesë aktive e proceseve të vlerësimit dhe sigurimit të brendshëm të cilësisë duhet të bëhen edhe bashkëpunëtorë dhe/ose ekspertë të jashtëm që kanë lidhje me programin e studimit apo mund të japin ekspertizë e mendime ekspertize të vyera në lidhje me cilësinë e programit dhe përmirësimin e saj.	Nga konsultimi i dokumentacionit përkatës mbi këtë kriter rezultoi se - Angazhimi i ekspertëve të jashtëm në strukturën e NJSBC-së - Takimet me përfaqësues nga Tregu i Punës/ Institucione shtetërore - Pjesëmarrja në projekte shkencore që synojnë përmirësimin e cilësisë - Shkëmbimi i eksperiencës me partnerët ndërkombëtare janë tregues të angazhimit të aktorëve të jashtëm në proceset e lidhura me sigurimin e brendshëm të cilësisë. Institucioni bën marrëveshje me institucione të tjera të ngjashme dhe fton bashkëpunëtorë dhe pedagogë nga këto institucione si psh. Universiteti i Elbasanit dhe Shkodrës etj. <i>(Ref. 13 - Marrëveshje ndër-institucionale);</i>			
<b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b>	<b>Nuk përmbushet</b>	<b>Përmbushet pjesërisht</b>	<b>Përmbushet kryesisht</b>	<b>Përmbushet plotësisht</b>
				<b>X</b>

<b>Standardi VI.5</b>	
<b>Politikat, proceset dhe veprimtaritë për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, duhet të jenë publike, transparente dhe efektive, dhe të synojnë krijimin e Kulturës së Brendshme të Cilësisë</b>	
<b>Kriteret</b>	<b>Vlerësimi i ekspertëve</b>
<b>Kriteri 1.</b> Politika, strategjia, organizimi dhe veprimtaritë në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit.	GVJ nga vizita si dhe vlerësimi i dokumentacionit përkatës konstatoi se UST ka hartuar dhe ndjekur politika, strategji, dhe veprimtari në kuadër të sistemit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë për programin e studimit, të cilat janë transparente dhe bëhen publike për studentët dhe të gjithë të interesuarit. Veprimtarinë e saj NJSBC-ja e zhvillon të organizuar sipas një plan i të përvitshëm, në të cilin programohen monitorimet në sektorët apo proceset që i nënshtrohen vlerësimit e që shoqërohen me raportet me rezultatet përkatëse. Po ashtu në faqen web të UST dhe në monitorët e brendshëm shfaqen dhe bëhen transparente dhe publike për studentët për aktivitet e ndryshme në kuadër të

	<p>përmirësimit dhe sigurimit të cilësisë.</p> <p><i>(Ref. 2 - Statuti i UST, Ref.Mbledhja e hapur vjetore e Rektoratit);</i></p>
<p><b>Kriteri 2.</b> Institucioni publikon rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit, duke respektuar lirinë dhe etikën akademike, si dhe legjislacionin për të dhënat personale.</p>	<p>GVJ nga vlerësimi i dokumentacionit përkatës rezultojnë se raportet e NJSBC-së, Analizat periodike, Raportet/Analizat e punës mësimore dhe kërkimore shkencore dhe financiare në tërësi shprehin drejtuesve dhe në njesite baze diskutohen vetëm ato pjesë të raporteve që lidhen në mënyrë të drejtpërdrejtë me atë njësi. Në çdo rast nga të dhënat e vëna në dispozicion rezultojnë se publikimet mbi rezultatet e vlerësimeve të programit të studimit monitorohen nga përfaqësuesi i Komisionerit për të dhënat personale.</p> <p>Megjithëse NJSBC ka planifikuar pilotimin e pyetësorëve edhe në mënyrë të personalizuar dhe më të detajuar për secilin lëndë/modul/pedagog për vitin akademik aktual por ende nuk është realizuar një nismë e tillë <i>sugjerohet realizimin e një anketimi të tillë; për të siguruar një proces transparent por që njëkohësisht respekton konfidencialitetin si dhe garanton të drejtat e palëve.</i> Rezultatet e vlerësimeve periodike diskutohen gjithashtu dhe në takimet informuese dhe dëgjuesat që zhvillohen me studentët.</p> <p><i>(Ref. Mledhje e hapur vjetore e Rektoratit);</i></p> <p><i>(Ref. Takime me studente të ciklit bachelor);</i></p>
<p><b>Kriteri 3.</b> Rezultatet e vlerësimit duhet të shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara.</p>	<p>GVJ nga konsultimi me dokumentacionin përkatës dhe takimet në Institucion vërehet se rezultatet e vlerësimit shoqërohen me një plan masash, që adresojnë dhe synojnë përmirësimin e mangësive e dobësive të evidentuara. GVJ vlerëson se të dhënat e përftuara nga vetëvlerësimet periodike kanë shërbyer jo vetëm për analizimin e situatës por edhe për identifikimin e problematikave me synim marrjen e masave për përmirësimin dhe garantimin e cilësisë së brendshme. Në bazë të natyrës së problematikave të evidentuara nëpërmjet analizave, janë marrë masa, të cilat variojnë nga zhvillimi i seminareve orientuese/trajnuese dhe deri tek masat konkrete për zgjidhjen e problematikave të evidentuara. Megjithëse NJSBC ka planifikuar pilotimin e pyetësorëve edhe në mënyrë më të personalizuar dhe më të detajuar për secilin lëndë/modul/pedagog për vitin akademik aktual por ende nuk është realizuar një nismë e tillë <i>sugjerohet realizimin e një anketimi të tillë krahas pyetësorëve aktualë.</i> Plani i punës dhe raportet mujore e semestrale të NJSBC po ashtu japin rekomandime të cilat i paraqiten Rektoratit të UST i cili më pas ndërmerret hapa për të trajtuar dhe zgjidhur</p>



	<p>problematikat.</p> <p><i>(Ref. Plan pune dhe raportet e NJSBC);</i></p>			
<p><b>Kriteri 4.</b> Institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të monitorimit e vlerësimit të cilësisë, në përmirësimin në vijim të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ vlerëson se të gjithë dokumentet e vëna në dispozicion, procedurat dhe instrumentet e përmendura në kriteret e mësipërme dëshmojnë faktin se institucioni vlerëson dhe siguron efektivitetin dhe impaktin e veprimtarive në kuadër të sigurimit të brendshëm të cilësisë. Gjithashtu, institucioni monitoron dhe mbështet financiarisht dhe me infrastrukturën e nevojshme grupet e vlerësimit të brendshëm dhe kërkesat që ata parashtrajnë për të përmirësuar cilësinë e programit të studimit.</p> <p><i>(Ref. Analiza vjetore e Universitetit);</i></p> <p><i>(Ref. Takim me stafin e cdo njësie bazë dhe me studentët për transparencën financiare, Shkresa Nr. Prot.605, dt.5.4.2019);</i></p> <p><i>(Ref. Vendim Bordi Administrimi për Ngritjen e NJSBC);</i></p>			
<p><b>Kriteri 5.</b> Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit.</p>	<p>GVJ nga konsultimi me dokumentacionin përkatës dhe takimet në Institucion konstaton se Institucioni organizon veprimtari periodike me personelin dhe studentët për informimin dhe ndërgjegjësimin e tyre për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Zbatimi i planit të punës në përputhje me rregulloren e programi të studimit Bachelor “Në Shkencat e Lëvizjes”, rregullores, planit vjetor të FSHL-së, dhe planit të veprimit të NJSBC për arritjen e synimeve si dhe klima bashkëpunuese midis stafit akademik dhe studenteve evidentojne e nxisin marrëdhënie të frytshme midis tyre. Ne analizen vjetore të departamenteve dhe fakultetit paraqitet dhe informacioni përkatës si dhe planin e masave për sigurimin dhe përmirësimin afatgjatë të cilësisë së programit të studimit. Ky informacion paraqitet në analizën vjetore të Rektoratit e cila është e hapur për personelin dhe studentët.</p> <p><i>(Ref. 61 - Takimet e NJSBC me fokus grupet e studentëve);</i></p> <p><i>(Ref. Analiza vjetore e Universitetit);</i></p> <p><i>(Ref. Takim me stafin e cdo njësie bazë dhe me studentët për transparencën financiare, Shkresa Nr. Prot.605, dt.5.4.2019);</i></p>			
<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardit</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
				<p><b>X</b></p>

<p><b>Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës VI</b></p>	<p>Nuk përmbushet</p>	<p>Përmbushet pjesërisht</p>	<p>Përmbushet kryesisht</p>	<p>Përmbushet plotësisht</p>
---	-----------------------	------------------------------	-----------------------------	------------------------------

				X
--	--	--	--	---

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit të ciklit të parë Bachelor në:  
“Shkencat e Lëvizjes” të Institucionit të Arsimit të Lartë “Universiteti i Sporteve të  
Tiranës”**

**a. Pikat e forta dhe afirmime:**

1. Procedura e rekrutimit të personelit akademik e cila mbështetet mbi eksperiencën në mësimdhënien universitare, grada/titulli i kandidatit për pedagog dhe aktiviteti kërkimor shkencor në përputhshmëri me legjislacionin në fuqi;
2. Staf i akademik i brendshëm që mbulon programin, gëzon titujt dhe gradat akademike në përmbushje të detyrimeve ligjore;
3. Cilësia e përzgjedhjes së kandidatëve më të mirë për të vazhduar studimet në ciklin e parë të studimeve, nëpërmjet disa testesh konkurimi praktik, që synon evidentimin e aftësive bazë psikomotore si dhe duke marrë në konsideratë notën mesatare të maturës shtetërore sipas përcaktimeve ligjore;
4. Marrëdhënie bashkëpunuese me tregun e punës me subjekte publike dhe jopublike, që janë të lidhura drejtpërdrejtë me fushën e programit të studimit e që i kontribuojnë cilësisë së praktikave profesionale të studentëve;
5. Promovimi i institucionit dhe sidomos i diplomës Bachelor në Shkencat e Lëvizjes për maturantët në të gjithë Shqipërinë;
6. Unifikimi i programit mësimor të fakultetit me fakultete të tjera në Europë, e më gjerë, gjë që bën të mundur punësimin e studentëve pas mbarimit të studimeve jo vetëm brenda vendit por edhe jashtë tij;
7. Infrastrukturë e përshtatshme në funksion të programit, terrenet sportive, TIK, hapësirat didaktike (auditore, laboratore, biblioteka, laboratore) të cilat kanë impakt të drejtpërdrejtë pozitiv në drejtim të arritjeve të objektivave të mësimdhënies e mësimnxënies të programit të studimit;
8. Kualifikime të vazhdueshme mësimore dhe shkencore të stafit akademik dhe ndihmës akademik, si edhe të studentëve me pjesëmarrje në konferenca kombëtare dhe ndërkombëtare si dhe projekte shkencore;
9. Institucioni ofron mundësinë studentëve për vazhdimësinë e mëtejshme të studimeve në ciklin e dytë në fushën e edukimit fizik e shëndetsor;

**b. Pika të dobëta:**

1. Mosgjurmimi i studentëve të punësuar pas mbarimit të studimeve, i cili mundësohej vetëm përmes kontakteve që institucioni mbante me subjektet bashkëpunuese dhe vetëdeklarimet e studentëve;

2. Mos realizimi i pyetsorëve për cdo lëndë/modul apo pedagog, ndikon në mos evidentimin e problematikave të ndryshme, në mësimdhënie. duke cënuar ruajtjen e cilësisë;

### **Rekomandime:**

1. GVJ rekomandon të pasurohet dhe përditësohet gjurmimi i studentëve duke marrë informacion sa më të plotë nga të diplomuarit e punësuar;
2. GVJ rekomandon që NJSBC të bëjë realizimin e një anketimi ku të planifikojë hartimin e pyetësorëve në mënyrë më të detajuar për secilën lëndë/ modul/ pedagog, duke siguruar një proces transparent, por që njëkohësisht respekton konfidencialitetin si dhe garantimin e cilësisë;
3. GVJ sugjeron që Instucioni duhet të marrë masa më konkrete për ta bërë me efektive përdorimin e platformës s <http://alumni.ust.edu.al>;
4. GVJ sygjeron që pistat, palestrat e institucionit të funksionojnë sipas një grafiku dhe me orare më të zgjeruara nën vëzhgim të stafit akademik, për tu shërbyer më mirë orëve praktike të studentëve;
5. GVJ sygjeron që aktivitete me pjesmarrjen e studentëve të publikohen në stendat e UST, pasi i stimulon studentët e tjerë, dhe evidenton më të mirët;
6. GVJ sygjeron ofrimin e disa lëndëve në gjuhën angleze në mënyrë që të rritet mundësia e bashkëpunimit me projekte si ato të ERASMUS+ etj;

### **Conclusions of the Evaluation of the first Bachelor study program in: "Movement Sciences"**

#### **a. Strengths and affirmations:**

1. The recruitment procedure for academic staff based on experience in undergraduate teaching, the degree / title of candidate for teaching and research activity in accordance with the legislation in force;
2. The internal academic staff that covers the program enjoys academic degrees and degrees in fulfillment of legal obligations;
3. Quality of selection of the best candidates for further studies in the first cycle of studies through some practical tests aimed at identifying basic psychomotor skills as well as taking into consideration the average grade of the high school according to the legal requirements;
4. Collaborative relationships with the labor market with public and non-public subjects that are directly related to the field of study program that contribute to the quality of students' professional practices;
5. Promotion of the institution and especially of the Bachelor's degree in Movement Sciences for high school graduates throughout Albania;
6. Unification of the curriculum of the faculty with other faculties in Europe and beyond, which enables the employment of students after graduation not only in Albania but also abroad;



7. Appropriate program infrastructure, playgrounds, ICTs, didactic spaces (auditoriums, laboratories, libraries, laboratories) which have a direct positive impact on the achievement of the teaching and learning objectives of the study program;
8. Continuous teaching and scientific qualifications of academic staff and academic support, as well as of students participating in national and international conferences and scientific projects;
9. The institution offers students the opportunity to pursue further studies in the second cycle in the field of physical and health education;

**b. Weaknesses:**

1. Non-enrollment of students employed after graduation, which was only possible through contacts the institution maintained with cooperative subjects and student self-statements;
2. Failure to complete the questionnaires for each subject / module or lecturer affects the non-identification of different problems in teaching. affecting the preservation of quality;

**Recommendations:**

1. The External Evaluation Group (EEG) recommends enriching and updating student tracking by getting the most complete information from employed graduates;
2. The EEG recommends that the IQAU conducts a survey to plan the design of questionnaires in more detail for each subject / module / lecturer, ensuring a transparent process, while respecting confidentiality and quality assurance;
3. The EEG suggests that the Institution should take more concrete measures to make the use of the platform more effective <http://alumni.ust.edu.al>;
4. The EEG recommends that the institution's runways and gyms operate on a schedule and with extended hours under the supervision of academic staff, to better serve student practical hours;
5. The EEG suggests that student participation activities be published on UST stands, as it stimulates other students, and identifies the best; etc.
6. The EEG suggests offering some courses in English in order to increase the possibility of collaborating with projects like ERASMUS +, etc.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

FUSHAT E VLERËSIMIT	SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS			
	Asnjë përmbushje	Përmbushen pjesërisht	Përmbushen kryesisht	Përmbushen plotësisht
<b>I. OFRIMI, ORGANIZIMI DHE DREJTIMI I PROGRAMIT/EVE TË</b>				<b>X</b>

<b>STUDIMIT</b>				
<b>II. STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E PROGRAMIT/EVE TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT</b>				<b>X</b>
<b>IV. BURIMET PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT</b>				<b>X</b>
<b>V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE</b>				<b>X</b>
<b>VI. SIGURIMI I CILËSISË SË PROGRAMIT/EVE</b>				<b>X</b>
<b>VLERËSIMI TËRËSOR</b>				<b>X</b>

**Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:**

**Prof.Asoc. Irena SAÇO KOLA**

**Prof.Asoc. Gavrosh KAVAJA**